

VËRTETËSIA

BOTIM I XHEMATIT MUSLIMAN AHMEDIA TË SHQIPËRISË

VJESHTË 2021

WWW.ALISLAM.AL

NR. 13

KATËR GRADA SHPIRTËRORE DHE LAIKE



Mesih i Premtuar

✧ IMAM MEHDI

Hazret Mirza Ghulam Ahmedi **, Mesih i Premtuar dhe Imam Mehdi lindi në vitin 1835 në një familje fisnike në Kadijan të Indisë. Që në moshë të re, ai shfaqti interes të veçantë për fenë dhe ushqe dashurinë për Profetin Muhammed ***. Ai dallohej për fisnikërinë, dashamirësinë dhe vendosmërinë e tij. Me kalimin e kohës, njohuria dhe botëkuptimi i tij për besimin dhe zbatimin e tij në shoqëri u thelluan. Duke qenë një musliman i devotshëm, ai besonte fuqimisht se të gjitha fetë janë të vërteta për sa i përket origjinës së tyre, megjithatë përgjatë rrjedhës kohore ato u janë shmangur mësimëve burimore. Ai mbrojti dinjitetin e besimit dhe vërtetoi se ai është bashkëkohor dhe se u përgjigjet sfidave të kohës.

Përpjekjet e tij në përkrahje të besimit u shpërblyen prej Allahut, i cili e dalloi atë si shërbëtor të përkryer të Islamit, të Kuranit dhe të Profetit Muhammed ***, duke i dhuruar bekimin e shpalljes nën shërbim të Profetit ***.

Misioni i tij ishte të shquante të vërtetat që përmban çdo fe, si dhe të rigjallëronte mësimet e Islamit. Përmes këtij misioni, ai hodhi themelet për t'i bashkuar njerëzit dhe për të vendosur paqe e harmoni të përhershme.

Më 1889, sipas urdhrit hyjnor, Hazret Mirza Ghulam Ahmedi ** themeloi Xhematin Musliman Ahmedia. Kjo bashkësi që tashmë është shumëfishuar në numër e në shtirje, është angazhuar fuqimisht për të përçar mesazhin e Islamit deri në skajet e botës.

Gjatë periudhës në të cilën jetoi ai, Islami ishte nën shënjestër

I Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} kishte paralajmëruar se Mesihu i Premtuar do të zbresë pranë një minareje të bardhë, në lindje të Damaskut. Kjo profeci u përbush me ardhjen e Hazret Mirza Ghulam Ahmedit ** në Kadijan të Indisë, një qytezë që ndodhet pikërisht në lindje të Damaskut.



të sulmeve armiqësore nga të gjitha anët dhe muslimanët në përgjithësi ishin në rënie të skajshme shpirtërore, me një besim të dyshimtë dhe krejtësisht sipërfaqësor. Ai ndërmoi një fushatë të jashtëzakonshme për t'i rregulluar botës fytyrën e bukur dhe të vërtetë të fesë islame. Ndër përpjekjet e tij të çmuara e madhore, mund të përmendim: mbi tetëdhjetë libra, të cilët janë përkthyer në më shumë se 60 gjuhë të botës si “Filozofia e mësimëve të Islamit”, “Brahin-e-Ahmedia” etj., qindra ligjërata me njohuri të thella të mistikës e debate të shumta fetare, të cilat argumentojnë më së miri se feja islame është një fe e gjallë, nëpërmjet së cilës njeriu mund të lidhë kontakt me Krijuesin dhe arrin të komunikojë me Të.

Shumica e veprave të tij janë shkruar në gjuhën urdu, disa në gjuhën arabe e disa të tjera edhe në gjuhën perse. Ai gjithashtu provoi se mësimet e Kuranit Famëlartë dhe ligji i fesë islame kanë fuqinë të ngrënë e të përsosin nivelin moral, intelektual dhe shpirtëror të njeriut. Ai deklaroi se Zoti i Madhërishtëm e ka caktuar atë si Mesih dhe Imam Mehdi, siç ishte përmendur në profecitë e Biblës, të Kuranit Famëlartë dhe të haditheve të Hazret Profetit Muhammed ***.

Nga 1889 deri 1908 kur ai ndërroi jetë, mijëra njerëz iu bindën atij dhe lidhën besëlidhje me të. Ky bekim vazhdon të përhapet përmes Kalifëve (zëvendësve) të tij.

Aktualisht, Hazret Mirza Masrur Ahmedi (Allahu e ndihmoftë fuqimisht) është udhëheqësi botëror i Xhematit Musliman Ahmedia dhe Kalifi i Pestë i Mesihut të Premtuar **. Ky Xhemat sot është përhapur në më shumë se 205 vende të botës dhe përbëhet nga miliona anëtarë.

FETË E BOTËS

Shpifje, thashetheme dhe përgojime



O ju që besuat, ruhuni shumë nga paragjykimet! Pa dyshim, disa paragjykime janë mëkat. Mos spiunoni dhe mos përgojoni njëri-tjetrin. A do të pëlqente ndokush prej jush që të hajë mishin e vëllait të tij të vdekur?! Ju patjetër që e urreni këtë. Kini druajtje ndaj Allahut. Pa dyshim, Allahu është Pendimpranues, shumë Mëshirëbërës.

ISLAMI, KURANI FAMËLARTË, 49:13.



I Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} tha: “Besimtari nuk merret me shpifje dhe nuk e mallkon askënd. Ai nuk është as i pamoralshëm dhe as i paturpshëm”.

ISLAMI, PROFETI MUHAMMED ^{s.a.v.s.} XHAMI ET-TIRMIDHI, KITAB: “EL-BIRRU VES-SILETU ARR-RESÜLILLÄHI S.A.V.S.”, BAB: “MA XHÂ'E FIL-LA'NETI”, HADITHI NR. 1977.



Paragjykimi është një sëmundje e një ves i tillë që e verbën njeriun dhe e shtyn atë në humnerën e errët të rrënimt. Në të vërtetë, paragjykimi ishte ai që e nxiti atë për të adhuruar një njeri të vdekur. Është po ky paragjykim

që i shtyn njerëzit për të privuar Zotin e Plotfuqishëm nga atributet e Tij të krjimit, mëshirës, furnizimit etj. dhe duke e zvogëluar atë në një qenie të panevojshme dhe të padobishme. Prandaj, nuk do jetë teprim nëse them se pjesa më e madhe e xhehenemit, madje tërësia e tij ai do të mbushet për shkak të paragjykimit.

ISLAMI, MESIHU I PREMTUAR **, MELFUZAT, VËLL. I, F. 62.



Nuk do të shkosh e të sillesh duke shpifur nëpër popullin tënd, as do të mbash qëndrim kundër jetës të të afërmit tënd. Unë jam Zoti.

JUDAIZMI, DHJATA E VJETËR, LEVITIKU 19:16



Kështu edhe gjuha është një gjymtyrë e vogël, por mund të mburret për gjëra të mëdha. Ja, një zjarr i vogël se ç'pyll të madh mund të djegë! Po, edhe gjuha është zjarr! Një botë e tërë padrejtësie është gjuha mes gjymtyrëve tona, ajo që e fëlliq

të gjithë trupin dhe, e ndezur nga ferri, e bën shkrumb të tërë jetën. E njëmend, të gjitha llojet e egërsirave, të shpendëve, të zvarranikëve dhe të kafshëve të detit mund të zbuten, dhe njerëzit i kanë vënë nën sundim, kurse gjuhën – e keqe e paqetësueshme, plot vrrer që sjell vdekjen – asnjë njeri nuk mund ta mbizotërojë. Me të lavdërojmë Zotin edhe Atin, por me të edhe mallkojmë njerëzit e krijuar në përngjasimin e Hyjit:

KRISHTËRIMI, DHJATA E RE, JAKOBI 3:5-9.



Mos i flisni askujt me ashpërsi sepse ata që drejtohen në këtë mënyrë, do t'ju replikojnë në të njëjtën monedhë. Vërtet, replika hakmarrëse është më e dhimbshme dhe goditjet e kundërpërgjigjes mund t'ju lënë të mavijosur.

BUDIZMI, DHAMMAPADA, KAPITULL 10, DANDAVAGGA (SHKOPI I NDËSHKIMIT) 133

VËRTETËSIA

10 Katër grada shpirtërore dhe laike

Një shpjegim i thellë i Kuranit Famëllartë, i cili sqaron gradat shpirtërore

HAZRET MIRZA GHULAM AHMED ^{A.S.}
MESIH I PREMTUAR DHE IMAM MEHDI

18 Zoti e krijoi njeriun vetëm për të mëshiruar

– Emrat e Allahut dhe komentim i tyre

HAZRET MIRZA GHULAM AHMED ^{A.S.}
MESIH I PREMTUAR DHE IMAM MEHDI

20 Cilat janë mjetet për të arritur dijen dhe njohjen ndaj Zotit?

HAZRET MIRZA GHULAM AHMED ^{A.S.}
MESIH I PREMTUAR DHE IMAM MEHDI

26 Suksesi - Çfarë është suksesi për vendin tonë?

Ato që ne i kemi quajtur sukses, dhe që i kemi bërë edhe synime të jetës sonë, realisht janë pengesa në rrugën tonë drejt suksesit.

HAZRET MIRZA BASHIRUDDIN MAHMUD AHMED ^{R.A.}
KALIFI I DYTË I MESIHUT TË PREMTUAR

30 Studimi më i madh mbi konsumimin e alkoolit

Një tjetër ajet i Kuranit u vërtetua nga shkencat. The Global Burden of Disease, në revistën Lancet jep rezultatet e studimit mbi konsumimin e alkoolit.

TAHIR NASER

34 Identiteti dhe imazhi i një muslimani

Fjalim i mbajtur në Xhelsa Salanën e Gjermanisë

AHMAD KAMAL

46 Kurani dhe jeta jashtëtokësore

Alienët ose jashtëtokësorët ekzistojnë. Kjo zbulesë e Kuranit u bë në një kohë kur kozmologjia si shkencë nuk kishte lindur akoma.

HAZRET MIRZA TAHIR AHMED ^{R.A.}
KALIFI I KATËRT I MESIHUT TË PREMTUAR

52 Pse mbajnë shaminë gratë muslimane?

Sipas Islamit, një grua e devotshme duhet të shfaqet në publik me vlerat e larta morale ...

HADAYATULLAH HÜBSCH

60 Roli i Kalifatit në vendosjen e paqes botërore

Fjalimi i mbajtur në Xhelsa

Salanën e Kosovës
ABDULLAH UWE WAGISHAUSER

70 Metoda e leximit dhe e studimit të Kuranit të Shenjtë

Vërtetësia ju sjell kuptime të thella që përmbajnë atributet e Allahut

HAZRET HAKIM MAULVI NURUDIN ^{R.A.}
KALIFI I PARË I MESIHUT TË PREMTUAR

76 Emrat e Allahut

Vërtetësia ju sjell kuptime të thella që përmbajnë atributet e Allahut

86 Çlirimi i Aleksandrisë dhe shkatërrimi i bibliotekës

Një fragment nga historia e Islamit

HAZRET MIRZA MASRUR AHMED ^{A.B.A.}
KALIFI I PESTË I MESIHUT TË PREMTUAR,

94 Lajme nga Kosova dhe Gjermania

Një përmbledhje aktivitetesh nga Xhemati Musliman Ahmedia dhe "Humanity First"





Lexoni online:

<https://www.ahmadiyya-islam.org/al/librat/>

ose blini këtu:

<https://www.ahmadiyya-islam.org/al/kontaktoni/>

Eseja e titulluar “*Filozofia e mësimeve të Islamit*” është shkruar në gjuhën urdu nga Hazret Mirza Ghulam Ahmed a.s., Mesihu i Premtuar dhe Imam Mehdiu, si përgjigje ndaj ftesës së Z. Svami Sad’hu Shogan Çander, i cili organizoi Mbledhjen e Madhe të Feve, në Town Hall të qytetit Lahor në datat 26 – 29 dhjetor të vitit 1896. Dijetarët muslimanë, të krishterë, arjë dhe të feve të tjera ishin ftuar për të përfaqësuar fenë e tyre përkatëse. Atyre u ishte caktuar të ligjëronin rreth pesë pyetjeve të kërkuara në bazë të Librit që ata besonin si Hyjnor:

1. Gjendjet trupore, morale dhe shpirtërore të njeriut
2. Cila është gjendja e njeriut pas kësaj jete, pra në botën vijuese?
3. Cili është qëllimi i vërtetë i qenies së njeriut në këtë botë dhe si mund të përmbushet ai qëllim?
4. Si ndikojnë veprat te njeriu në këtë botë dhe në botën vijuese?
5. Cilat janë mjetet për të arritur dijen dhe njohjen Hyjnore?

VËRTETËSIA

KRYEREDAKTOR

Samad Ahmed Ghori

BORDI EDITORIAL

Jinahuddin Saif, Bujar Ramaj, Shahid Butt

FAQOSJA

Shahid Butt

MENAXHER

Idriz Ramadani

Email: idriz.xhamajl@gmail.com

PËR ABONIM KONTAKTONI:

SHQIPËRI

Sali Beja

Email: salibeja@gmail.com

KOSOVË

Shkëlqim Bytyçi

Email: shkelqimbytyci@gmail.com

SHTYPUR NË SHTYPSHKRONJËN

RanaPoster.de Druckerei

Robert-Perthel-Str. 15

50739 Köln-Bilderstöckchen, Deutschland

Email: masood313@aol.com

ADRESA POSTARE

NË SHQIPËRI:

Xhemati Musliman Ahmedia i Shqipërisë,

pranë Vodafonit,

Rr. “Pavarësia” Km. 1, Mëzez,

Kutia Postare 8176, Tiranë, Shqipëri

vertetesia@gmail.com

NË KOSOVË:

Xhemati Musliman Ahmedia i Kosovës Rr.

“Elbasani”, nr. 9,

Lagjja e Spitalit,

Kutia Postare 43,

Prishtinë 10000, Kosovë

Email: amj.kosovo@gmail.com

NË GJERMANI:

Albanian Desk

Barendorfer Bruch 15,

58640, Iserlohn, Deutschland

Email: albanian.desk@gmail.com

KONTAKT REDAKSI:

M +355 67 216 8054

+355 69 464 4888

+383 44 817 813

EMAIL

vertetesia@gmail.com

WEBSITE

www.alislam.al

Kurani Famëlartë

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

Sigurisht, fituan besimtarët;

ata që janë të përlurur në namazin e tyre,

ata që i shmangen kotësisë,

ata që japin zekatin,

ata që ruajnë organet e tyre intime; përveçse me bashkëshortet e tyre

ose me ato që i kanë në zotërim.

Sigurisht, ata nuk do të qortohen,

ata që kërkojnë përtej kësaj, pa dyshim janë shkelës;

dhe (fituan) ata që i ruajnë amanetet dhe zotimet e tyre,

ata që u rijnë roje namazeve të tyre.

Pikërisht këta janë trashëguesit, të cilët, do të trashëgojnë Firdeusin.

Në të do të jetojnë përgjithmonë.

Kurani Famëlartë 42:52



Hadithi

حَدَّثَنَا أَبُو نُعَيْمٍ، حَدَّثَنَا زَكَرِيَّا، قَالَ سَمِعْتُ عَامِرًا، يَقُولُ سَمِعْتُ التَّعْمَانَ بْنَ بَشِيرٍ - رَضِيَ اللَّهُ عَنْهَا - عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ ” مَقَلَّ الْقَاتِمُ عَلَى حُدُودِ اللَّهِ وَالْوَاقِعُ فِيهَا كَمَثَلِ قَوْمٍ اسْتَهَمُوا عَلَى سَفِينَةٍ، فَأَصَابَ بَعْضُهُمْ أَعْلَاهَا وَبَعْضُهُمْ أَسْفَلَهَا، فَكَانَ الَّذِينَ فِي أَسْفَلِهَا إِذَا اسْتَقْتَوْا مِنَ الْمَاءِ مَرُّوا عَلَى مَنْ فَوْقَهُمْ فَقَالُوا لَوْ أَنَّا خَرَقْنَا فِي نَصِيبِنَا خَرْقًا، وَلَمْ نُؤْذِ مَنْ فَوْقَنَا. فَإِنْ يَتْرَكُوهُمْ وَمَا ارَّادُوا هَلَكُوا جَمِيعًا، وَإِنْ أَخَذُوا عَلَى أَيْدِيهِمْ نَجَّوْا وَنَجَّوْا جَمِيعًا “.

Hazret Nu'man ibn Beshiri ^{r.a.} rrëfen se i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} ka thënë:

“Shembulli i atij personi, i cili iu përmbahet kufijve të caktuar të Allahut dhe i atij i cili i tejkalon, është si ai populli që hodhi shortin për të siguruar vend në një anije. Disave u ra kuverta e sipërme, kurse të tjerëve kuverta e poshtme. Ata të kuvertës së poshtme, kur u nevojitej ujë, kalonin përmes atyre që ishin në kuvertën e sipërme. Atyre u ra ndërmend se nëse e bëjnë një vrimë në pjesën e poshtme të anijes, nuk do t'i trazonin udhëtarët e kuvertës së sipërme. Nëse ata, të kuvertës së sipërme i lejojnë të bëjnë këtë, të gjithë do të mbyten, ndërsa nëse i ndalojnë, të gjithë do të shpëtojnë”.

Sahih el-Bukhari, kitab “Esh-Sheriketi”,

bab: “Hel jukre’u fil-kismeti vel-istihami fihi”,

hadithi nr. 2493



Në hutben e kaluar, ju kisha treguar se Allahu i Madhërishëm na mësoi lutjen

إِهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ

Ihdinas-sirātal-mustekīm

“Na udhëzo në rrugën e drejtë.”¹

Por cila është kjo rruga e drejtë? Tha:

صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ

“rruga e atyre që i bekove Ti”.²

Në një ajet tjetër të Kuranit të Shenjtë, Allahu i Madhërishëm ka shpjeguar se cilët janë këta që i ka bekuar Ai, dhe tha:

وَمَنْ يُطِعِ اللَّهَ وَالرَّسُولَ فَأُولَٰئِكَ مَعَ الَّذِينَ أَنْعَمَ اللَّهُ عَلَيْهِمُ مِنَ النَّبِيِّينَ وَالصِّدِّيقِينَ وَالشُّهَدَاءِ وَالصَّالِحِينَ ۖ وَحَسُنَ أُولَٰئِكَ رَفِيقًا

“Dhe kushdo që i bindet Allahut dhe të dërguarit, do të jetë me ata që Allahu i ka bekuar (domethënë), ndër profetët, të vërtetët, dëshmorët dhe të dëlirët. Sa shoqëri e mbarë janë këta!”³

Pra, ata që ndjekin rrugën e drejtë, qëndrojnë me ata të cilët Allahu i ka bekuar, dhe ata janë xhemati i Profetëve, xhemati i të vërtetëve, xhemati i dëshmorëve dhe xhemati i të dëlirëve.

Pozita e parë – i Dëlirë (salih)

Unë ju kisha treguar se ashtu siç ka një pozitë shpirtërore që quhet “salih”, pra i dëlirë, po kështu edhe në aspektin tokësor, ka një pozitë me të njëjtën vlerë që mund të quhet “salib”. Ajo është që njeriu të përshtatet në bazë të kohës që jeton, me kushtin që kjo përshtatje të jetë vetëm në aspektin pozitiv, dhe jo në aspektin negativ. Pra, ai duhet të ruhet nga ligësitë e kohës dhe të përpiqet të kapë mirësitë dhe dijet e saj. Nëse sheh se aty ka ndonjë të metë, të mos e pranojë atë, por kur gjen një realitet dhe vërtetësi, ta përvetësojë atë.

وَمَنْ يُطِعِ اللَّهَ وَالرَّسُولَ فَأُولَٰئِكَ مَعَ الَّذِينَ أَنْعَمَ اللَّهُ عَلَيْهِمْ
مِنَ النَّبِيِّينَ وَالصِّدِّيقِينَ وَالشُّهَدَاءِ وَالصَّالِحِينَ ۖ
وَحَسُنَ أُولَٰئِكَ رَفِيقًا

Katër grada shpirtërore dhe laike

Një shpjegim i thellë nga Hazret Mirza Ghulam Ahmed,
Mesihu i Premtuar dhe Imam Mehdiu ^{a.s.} i cili sqaron katër
gradat shpirtërore e laike.

Shikoni, për shembull, studentët e universiteteve të vendit tonë. Mësojnë shkenca të ndryshme, përpiqen t'i përshtaten kohës që jetojnë, por ngaqë studiojnë librat dhe dijet e atyre, të cilët bashkë me këto dije, janë përpjekur të provojnë një njeri të jetë Zoti, edhe studentët e vendit tonë, kur i mësojnë dijet e tyre, gradualisht bëhen mohues të Zotit të Madhërishëm.

Këta studentë paraqesin teorinë e evolucionit si një argument kundër ekzistencës së Zotit, por nuk kuptojnë që teorinë e evolucionit njerëzimi e ka njohur qysh nga fillimi. Ajo që bëri Darvini është vetëm se spikati disa aspekte të fshehta të evolucionit. Përndryshe, edhe para Darvinit, njerëzit e shikonin që fëmija lindte pas nëntë muaj; fara kalonte një proces të tërë për t'u shndërruar në një pemë; natyra gjithkund u tregonte edhe më parë zhvillimin gradual në të gjitha punët e saj. Por këtë atëherë askush nuk e quante kundër ekzistencës së Zotit.

Përveç kësaj, Darvini në këtë kohë ka paraqitur teorinë e adaptimit (*Adaptation*), që do të thotë se një gjallesë e caktuar të përshtatet në bazë të mjedisit. Kurse feja Islame një mijë e treqind vjet përpara na e ka treguar këtë pozitë në jetën e besimtarit, por duke hequr anët negative të saj. Dhe këtë e quajti pozita më e vogël e besimtarit.

Fjala *صَلَحَ* (*saleha*) do të thotë – përshtatem deri në përsosmëri në bazë të një gjëje apo mjedisi të caktuar. Andaj, salihu është ai që nuk ngelet mbrapa në kohën e vet, përkundrazi, ecën krah me krah me kohën, dhe arrin t'i përshtatet asaj, por në atë mënyrë që, e ruan veten nga çdo ligësi e saj.

Pozita e dytë – Mbikëqyrës (*shehid*)

Pozita e dytë është ajo që quhet shehid. Në gjuhën arabe fjala shehid do të thotë mbikëqyrës. Kjo pozitë përveçse gjendet në botën shpirtërore, ekziston edhe në jetën e kësaj bote. Shkalla e parë e zhvillimit të njeriut në këtë botë është që ai të ketë dije. Kurse shkalla e dytë është që ai t'ua mësojë të tjerëve dijen, pra ai të bëhet “*mual-lim*” (mësues).

Në këtë ajet Allahu i Madhërishëm thotë se besimtari jo vetëm që përvetëson shkencat e kohës së tij ashtu siç duhet, por të përsoset në këtë aspekt, derisa arrin t'ua mësojë ato edhe të tjerëve. (Pra, të bëhet mbikëqyrësi i tyre).


Tani, në bazë të këtij kriteri, shikojini muslimanët se në çfarë shkalle të pozitës së shehidit qëndrojnë ata. Pra, deri në çfarë shkalle ata arrijnë t'i japin njerëzimit dijet shpirtërore dhe shkencore.

Më pas, shikojini edhe popujt europianë, sesi ata përpiqen të përhapin dijet e tyre, edhe fetare, edhe shkencore, anekënd botës. Për të përhapur shkencat tokësore, ata hapën shkolla në zona kaq të thella të botës ku mbretëronte vetëm injoranca. Kurse për të përhapur dijet fetare, misionarët e tyre shkojnë në Afrikë, Australi dhe në vende shumë të largëta. Ndërkohë, Islami ishte ajo fe e cila u kishte dhënë muslimanëve një mësim të tillë, në mënyrë që xhemati i tyre të bëhej i pari për të përvetësuar dijet shpirtërore dhe ato shkencore, dhe më pas po ata të bëheshin pararojë për t'i përhapur ato nëpër botë.

Pozita e tretë – i Vërtetë (*sid-dik*)

Pozita e tretë është ajo e sid-dikut, pra i të vërtetit. Sid-diku është afër me pozitën e Profetit, pasi të dy kanë një brumë. Të dy janë shokë me njëri-tjetrin, por jo ende vëllezër. Profetët kanë një lidhje shpirtërore me Zotin e Madhërishëm, sikur ajo që fëmijët kanë me babanë e tyre. Pra, Profetët fitojnë dijen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Zoti. Andaj, me njëri-tjetrin ata quhen vëllezër. Por sid-diku nuk e ka këtë lidhje me Profetin. *Sid-diku* përpigjet dhe mundohet për të qenë bashkë me Profetin, dhe arrin të bëhet shok i tij. Kjo quhet pozita e sid-dikut në botën shpirtërore.

Në botën lëndore, pozita e sid-dikut është e atij njeriu që përparon aq shumë në shkencë, derisa arrin t'i përngajë ndonjë zbuluesi të një teorie shkencore apo shpikësi të diçkaje të rëndësishme. Sid-diku në botën shpirtërore ndonëse merr dijet Hyjnore jo në mënyrë të drejtpërdrejtë prej Zotit, por arrin të shpjegojë



shumë saktë dijet Hyjnore që i ka marrë nëpërmjet Profetit. E njëjta është edhe pozita e sid-dikut të botës lëndore.

Andaj, në këtë ajet, Allahu i Madhërishëm thotë se besimtari duhet të përparojë kaq shumë në dije e në shkencë, që edhe sikur nuk arrin të zbulojë apo të shpikë diçka, të arrijë të krijojë lidhje të fortë me zbulimet dhe shpikjet e kohës.

Pozita e katërt – Profet (*nebij*)

Pozita e katërt është ajo e Profetit. Profeti në botën shpirtërore mëson në mënyrë të drejtpërdrejtë prej Zotit, duke komunikuar me Të dhe duke marrë shpallje prej Tij. Karshi këtyre Profetëve, ekzistojnë edhe “profetë” tokësorë, të cilët ndonëse nuk marrin shpallje në formë diktimesh prej Zotit të Madhërishëm, por përfitojnë nga shpallja e fshehtë (vahji khafij) e Zotit, dhe përhapin dije në botë.

Edisoni thotë se nganjëherë papritmas si një vetëtimë atij i lind në zemër një ide e saktë. Por ngaqë këta janë “profetë” tokësorë, edhe idetë që u lindin në zemër, janë tokësore. Ata bëjnë zbulime nga më të rejat, dhe nxjerrin ide nga më të befasueset.

Shkurt, Zoti i Madhërishëm gjënë më të vogël që u kërkon besimtarëve është që ata të përvetësojnë mirë edhe shkencat e kësaj bote. Dhe pasi t’i përvetësojnë mirë shkencat, të arrijnë t’u japin dije të tjerëve duke u bërë mësues të tyre.

Pas kësaj, të përparojnë në rrugën e dijes kaq shumë saqë edhe sikur të mos bëhen zbulues të ndonjë ideje shkencore, apo shpikës të diçkaje të rëndësishme, të kenë lidhje të fortë me shkencën, aq sa t’u përngjajnë shkencëtarëve të mëdhenj, të cilët si themelues shkencash, kanë dhënë kontribute madhore në botë. Pra, kurdoherë që të përmendet ndonjë shkencë, bashkë me themeluesin e saj, të përmendet edhe emri i tyre, për shkak të ngjashmërisë që kanë krijuar me të.

Dhe më pas, ata të përparojnë edhe më shumë, derisa të arrijnë të zbulojnë dije të reja dhe të shpikin gjëra të reja.

Nëse do ta kemi këtë shpirt, të gjitha vështirësitë apo problemet do të marrin fund vetvetiu. Sepse problemet dhe grindjet lindin për shkak të mosdijes. Në botë, çdo ligësi vjen për shkak të injorancës, dhe çdo mirësi lind për shkak të dijes.


Nëse çdo ahmedian, pra anëtar i Xhematit tonë, e krijon në veten e tij këtë gjendje që ju shpjegova më sipër, njerëzit që në këtë botë mund të shohin xhenetin. Ne nuk mund t’ua tregojmë njerëzve xhenetin shpirtëror ose xhenetin e botës tjetër, por këtë xhenet mund t’ua tregojmë. Nëse çdo ahmedian do t’i arrijë këto pozita, të gjithë njerëzit do të pohojnë – Ejani, edhe ne të hyjmë në xhenetin e tyre!


Njerëzit e rëndomtë në këtë botë shohin vetëm ferr, ndaj po shtohet edhe numri i vetëvrasjeve dita-ditës. Por nëse ata do ta shohin xhenetin ndonjëherë, kurrë nuk do të marrin një rrugë të tillë të vetëshkatërrimit. Nëse ahmedianët do të arrijnë ta krijojnë këtë xhenet, popujt e tjerë të botës mund të anojnë më shpejt nga ne.

Por është shumë e largët të krijojmë një xhenet të tillë. Në Xhematin tonë akoma kemi njerëz që grinden edhe për gjëra të vogla. Zoti i Madhërishëm ndërton një xhenet përmes Profetit të tij. Nëse ne grindemi me vëllezërit mes veti, ne jemi duke prerë me duart tona degët e këtij xheneti.

Nuk duhet të thotë dikush – Çfarë ndodh nëse unë pres vetëm një degë! Sepse nëse të gjithë ahmedianët do të pohojnë kështu, do të priten pemët e të gjithë xhenetit. Atëherë Zoti do të dërgojë një Profet tjetër, në mënyrë që ai të ndërtojë një xhenet tjetër nga e para.

Në pozitën më të vogël është salihu (i dëlirë). Domethënë, ai që integrohet në mjedisin e krijuar nga Zoti i Madhërishëm. Andaj, miqtë e mi, kemi nevojë të integrohemi në mjedisin e Zotit në fjalët dhe në veprat tona, që të bëhemi salihë. Nëse nuk e bëni dot as këtë, të paktën të përpiqeni për t’u bërë të tillë, sepse Zoti e sheh përpjekjen. Unë kursesi nuk mund të pranojë që ai që vdes






duke luftuar me ligësinë, të mos quhet triumfues dhe Zoti të mos e mëshirojë atë. Andaj, miqtë e mi, përpikuni të bëheni salihë (të dëlirë).

I lutem Allahut të Madhërishëm që Ai t'u japë të gjithë anëtarëve të Xhematit tonë mundësinë për t'i arritur këto grada dhe, më pas, secilit prej tyre t'i dhurojë qoftë një nga këto katër grada!

(Botuar për herë të parë në gazetën Al-Fazl, të datës 18 gusht, 1931)

SHËNIME

1. *Kurani Famëllartë* 1:6.
2. *Kurani Famëllartë* 1:7.
3. *Kurani Famëllartë* 4:70.



Një tregim i bukur

Mesihu i Premtuar ^{a.s.} rrëfente një tregim. Një njeri po vidhte një arkë me rrush nga një vresht, ndërkohë erdhi pronari dhe e pyeti: “Pse më merr rrushin nga vreshti im?”. “Më dëgjo një herë dhe pastaj trajtomë si të duash”, – ia ktheu ai. Pronari i tha: “Mirë, shpjegomë!”. Ai i tha: “Në fakt, një vorbull ere rastësisht më mori dhe më pruri në këtë hardhi, dhe për të shpëtuar veten, fillova të bëja manovra me duar. Nga tundimet, filluan të binin kokrrat e rrushit dhe rastësisht poshtë kishte një arkë, e cila shumë shpejt u mbush me to. Tani më thuaj se çfarë faji kam? Gjithçka ndodhi vetvetiu!”. Pronari kur e dëgjoi arsyetimin e tij, iu përgjigj: “Deri këtu s'ke faj. Pa më thuaj pak se kush të tha që ta vendosje arkën në kokë e të niseshe drejt shtëpisë sate?” “Eh, duke dalë nga vreshti, edhe unë këtë po mendoja”, – ia ktheu ai.

Pikërisht kjo është gjendja e atij personi që ushqen një mendim të keq në zemër. Ai nuk konsiderohet fajtor se pse i ra një mendim i tillë, por quhet fajtor pse e mbart atë. Ai absolutisht nuk do të pyetet se përse i erdhi mendim i keq, por do të pyetet patjetër se përse e mbajti mendimin e keq dhe për këtë do të ndëshkohet, sepse mbartja apo heqja e tij janë nën kontrollin e njeriut. Ai i ka të gjitha aftësitë për të larguar mendimet e këqija nga zemra.

Pra, për pastrimin shpirtëror, më së pari është e domosdoshme që njeriu të largojë mendimet e këqija nga zemra.

Hazret Mirza Bashiruddin Mahmud Ahmedi ^{r.a.}, *Njohja e Zotit*, Tiranë, Xhemati Musliman Ahmedia i Shqipërisë, 2015, f. 48.



“Bunch of fresh blue grapes on white background” nga Marco Vercel Professional, imazhi i licensuar sipas CC BY 2.0

Zoti e krijoj njeriun vetëm për të mëshiruar

– Emrat e Allahut dhe komentim i tyre

Muslimanët duhet të kenë parasysh se edhe nëse në dijen e Zotit fundi i një njeriu të jetë mohimi, prapëseprapë praktika e hershme e Allahut është që Ai ia largon ndëshkimin kur njeriu përgjërohet dhe i frikësohet Atij. Për këtë arsye, muslimanët ehli-sunet besojnë se Zoti i lejon Vetes të ndryshojë Vullnetin e Tij, edhe kur të ketë paralajmëruar dikë se do ta ndëshkojë atë, por nuk i lejon Vetes të ndryshojë parashikimin që t'i ketë bërë dikujt për ndonjë gëzim. Siç ndodhi me popullin e Junusit, ndaj të cilëve Zoti së pari tregoi një datë të prerë për ndëshkimin, e më pas Vetë ua largoi atë për shkak të përljes dhe të përgjërimit të tyre.



Hazret Mirza Ghulam Ahmed ^{a.s.}
Mesihu i Premtuar dhe Imam Mehdiu

... Nuk është në dëshirën Personale të Zotit të ndëshkojë dikë. Zoti ka katër attribute [katër emra], të cilat janë burimi i të gjitha attributeve të Tij të tjera, dhe të katërtat përbëhen nga mëshira e bujaria. Këto katër attribute përmenden në tri ajetet e para të sures El-Fatiha, e që janë:

Rabbil-‘ālemin: Zoti i botëve

Er-Rahman: i Gjithëmëshirshëm

Er-Rahim: Mëshirëbërës

Māliki jeumiddīn: Sundues i ditë së shpërblimit

Me secilin prej këtyre katër attributeve, Zoti i Madhërishëm synoi vetëm e vetëm mirësinë për njerëzit. Pra, Ai synoi të krijojë e të rrisë, gjë që mbulon atributi [Emri] *Rabbil Alemini*.

Ai synoi t'u japë krijesave të gjitha mjetet e rehatisë, pa pasur ndonjë kërkesë nga ana e tyre, dhe këtë e mbulon atributi i Tij *Rahman*.

Ai synoi t'i mundësojë njeriut mjetet që e mbrojnë nga brenga dhe fatkeqësia, për shkak të takvasë së njeriut dhe për shkak të besimit dhe të kërkimit të tij drejt Zotit. Këtë e mbulon atributi i Tij *Rahim*.

Dhe Ai synoi t'i japë njeriut pozitën që është pozita e lumturisë dhe e rehatisë së përfjetshme, kur njeriu e adhuron, agjëron, falet dhe tregohet i dhembshur ndaj njerëzve duke bërë sakrifica dhe duke i ndihmuar ata. Kjo pozitë quhet

Shpërblimi i mirësisë dhe vjen nga Sunduesi i ditës së shpërblimit.

Andaj, Zoti nuk deshi keq aspak në asnjërin prej këtyre katër attributeve, përkundrazi vendosi t'i bëjë vetëm të mirë njeriut. Por ai që e largon veten nga hija e mëshirshme e këtyre attributeve, duke bërë ligësi dhe shkelje dhe duke ndryshuar natyrën e vet, po këto attribute të Zotit aktivizohen jo për të mirën e njeriut, por në dëm të tij, e kjo vetëm si pasojë e vetë veprave të njeriut.

Kështu, *Rabil Alemini* në vend të krijimit dhe të rritjes, synon vdekjen e asgjësimit. *Rahmani* shfaqet në formë zemërimi dhe ashpërsie. *Rahimi* vepron si hakmarrës dhe i vrazhdë. Shpërblimi i mirësisë manifestohet në formën e tmerrshme të ndëshkimit.

Pra, ky ndryshim në atributet e Zotit vjen për shkak të ndryshimit që krijon njeriu në veten e tij. Dhe ngaqë ndëshkimi ose paralajmërimi i ndëshkimit nuk është në këto katër attribute të Zotit të Madhërishëm që janë attribute themelore të Tij, dhe ngaqë Ai ka dashur vetëm të mirën e njeriut, edhe paralajmërimi i Tij për ndonjë ndëshkim nuk është i prerë, për sa kohë që njeriu është i gjallë dhe ka fuqi ta ndryshojë veten.

Rubani Khazain, “*Enxham-e-At’hem*” vëll. 11, Rabwah, Pakistan, f. 7 – 10, 2008.



CILAT JANË MJETET PËR TË ARRITUR DIJEN DHE NJOHJEN NDAJ ZOTIT?

Hazret Mirza Ghulam Ahmed ^{a.s.}
Mesihu i Premtuar dhe Imam Mehdiu

Ajo që thotë Kurani Famëlartë në Amënyrë të hollësishme duke iu përgjigjur kësaj pyetjeje, nuk kemi mundësi ta përmendim të gjithën këtu, por si shembuj do të parashtrojmë disa pika.

Kurani Famëlartë shpjegon që dija ka tri shkallë:

- 1) dija përmes arsyetimit,
- 2) dija përmes konstatimit dhe
- 3) dija përmes përjetimit.

Më herët, duke komentuar suren *Et-Tekathur*, kemi thënë se **dija përmes arsyes** është ajo që nuk arrihet drejtpërdrejt, por nëpërmjet ndonjë mjeti tjetër, i cili na mundëson të nxjerrim një përfundim të caktuar, siç nxjerrim përfundimin për praninë e zjarrit duke parë tymin. Pra ne nuk e pamë zjarrin, por vetëm tymin, gjë që na bëri të besojmë se aty ka edhe zjarr. Dhe nëse kemi parë vetë zjarrin, sipas sures *Et-Tekathur* të Kuranit Famëlartë, shkalla e dijes sonë do të jetë **dija përmes konstatimit**. Dhe nëse kemi hyrë në atë zjarr, këtë shkallë të dijes Kurani Famëlartë e quan si **dija përmes përjetimit**. Nuk është e nevojshme ta shkruajmë përsëri këtu suren *Et-Tekathur* dhe dëgjuesit dhe lexuesit tanë mund t'i referohen kapitullit përkatës për të lexuar komentimin e saj.

وَقَالُوا لَوْ كُنَّا نَسْمَعُ أَوْ نَعْقِلُ مَا كُنَّا فِي أَصْحَابِ الشَّعِيرِ

Duhet ditur që mjetet për të arritur shkallën e parë të dijes, pra atë të arsyes, janë logjika dhe informacioni. Allahu i Madhërishëm citon dy banorë të ferrit, duke thënë:

Disa banorë të xhehenemit do të thonë: Po të kishim punuar me mend dhe të kishim logjikuar fenë dhe besimin siç duhet, ose po të kishim dëgjuar dhe ndjekur me vëmendje fjalët dhe shkrimet e të mençurve dhe studiuesve, sot nuk do të ishim në ferr.¹

Ajeti i mësipërm lidhet edhe me një ajet tjetër, në të cilin Allahu i Madhërishëm thotë:

لَا يَكِلُفُ اللَّهُ نَفْسًا إِلَّا وُسْعَهَا

Zoti i Madhërishëm nuk e ngarkon shpirtin e njeriut përtej fuqisë së tij të dijes dhe i paraqet vetëm atë besim, të cilin njeriu ka fuqi ta pranojë, në mënyrë që urdhrat e Tij, të mos jenë si një barrë e papërballueshme për të.²

Këto ajete tregojnë se njeriu mund të arrijë dijen e saktë në shkallën e arsyes edhe përmes dëgjimit. Për shembull, ne nuk e kemi vizituar Londrën, por kemi dëgjuar rreth atij qyteti nga njerëzit që e kanë parë. Por a mund të mbetemi në mëdyshje duke menduar se ndoshta të

gjithë kanë gënjyer?! Ose një shembull tjetër. Ne nuk ishim në kohën e mbretit Alamgir dhe as nuk ia kemi parë fytyrën, por a mund të dyshojmë ndopak në faktin se Alamgiri ka qenë njëri prej mbretërve mogulë?! Si u bindëm për këtë fakt? U bindëm sepse në mënyrë të vazhdueshme njerëzit kanë dëgjuar për të. Prandaj, nuk ka dyshim që edhe dëgjimi e çon njeriun në dijen e saktë që i përket shkallës së arsyes.

Edhe librat e Profetëve, nëse nuk ka mungesa në traditën e përcjelljes së historisë, janë një burim i dijes nëpërmjet të dëgjuarit. Por nëse një libër pretendon të jetë qiellor dhe ka pesëdhjetë a gjashtëdhjetë variante të ndryshme të tij, ku disa prej tyre janë kundërthënëse me disa të tjera, atëherë edhe nëse një grup të ketë besuar se vetëm dy a katër prej tyre janë të sakta dhe të gjitha variantet e tjera janë të sajuara, kjo për studiuesit nuk do të ishte një provë, mbi të cilën të vendosej baza e një dijeje të sigurt. Të gjitha variantet, për shkak të kontradiktave që kanë, cilësohen si të pabesueshme dhe nuk mund të merren si burim i një dijeje të sigurt. Sepse dija është ajo që ju siguron njohuri bindëse, kurse në një përmbledhje kontradiktash nuk mund të gjeni një dije të tillë.

Kurani Famëlartë nuk është i kufizuar vetëm në atë çfarë ndër shekuj ishte dëgjuar, sepse ai ka edhe argumente mjaft bindëse për njerëzit. Gjithashtu,

në asnjërën prej mësimëve, parimeve dhe porosive të tij, ai nuk imponohet thjesht me autoritet, madje thotë se këto mësimë janë të gdhendura vetë në ndërgjegjen e njeriut, kurse Kurani Famëlartë veten e quan “Kujtesë”, siç thotë në një ajet:

وَهَذَا ذِكْرُ مُبَارَكٍ أُتْرَلَاهُ

Ky Kuran i bekuar nuk solli ndonjë gjë të re, por është vetëm kujtesë e asaj që gjendet në ndërgjegjen e njeriut dhe në librin e natyrës.³

Në një vend tjetër, ai thotë:

لَا إِكْرَاهَ فِي الدِّينِ

Feja nuk synon të bindë me imponim, përkundrazi, jep argumente për çdo gjë që thotë.⁴

Përveç kësaj, Kurani Famëlartë ka një fuqi shpirtërore për të ndriçuar zemrat, siç thotë:

وَيَهْدِي لِمَا فِي الضُّلُومِ

Kurani është shërim për sëmundjet.⁵ Për këtë arsye, ai nuk mund të quhet thjesht një libër me informacion, i përcjellë përgjatë brezash, por është i mbushur me argumente të arsyeshme të një shkalle të lartë me një dritë të qartë.

Gjithashtu, edhe argumentet e logjikshme që janë nxjerrë si përfundime

të çështjeve mbi baza të shëndosha, e çojnë njeriun në dijen e saktë deri në shkallën e arsyes. Pikërisht kësaj i referohet Allahu i Madhërishëm në ajetet vijuese:

إِنَّ فِي خَلْقِ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَاخْتِلَافِ اللَّيْلِ وَالنَّهَارِ لَآيَاتٍ لِّأُولِي الْأَلْبَابِ ﴿الَّذِينَ يَذْكُرُونَ اللَّهَ قِيَامًا وَقُعُودًا وَعَلَىٰ جُنُوبِهِمْ وَيَتَفَكَّرُونَ فِي خَلْقِ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ رُبَّمَا مَا خَلَقْتَهُذَا بَاطِلًا مِّنْهُنَّ مَا فَتَنَّا عَذَابَ النَّارِ﴾

Kur njerëzit e mençur mendojnë rreth krijimit të tokës, qiellit dhe trupave qiellorë dhe studiojnë me thellësi arsyet e ndërrimit të natës e të ditës, gjejnë argumentin e ekzistencës së Zotit të Madhërishëm. Prandaj, për të zbuluar më shumë, ata i kërkojnë ndihmë Zotit dhe e kujtojnë Atë në këmbë, ulur dhe kur janë shtrirë në ijët e tyre, dhe kjo ua paston edhe më shumë mendjen. Më pas, me mendjet e tyre kur ata thellohen në krijimin pa të metë të tokës dhe të trupave të tjerë qiellorë, në mënyrë të vetvetishme shprehen: “Ky sistem i përsosur kurrësi nuk mund të jetë kot dhe pa qëllim, madje tregon fytyrën e Krijuesit Absolut”.⁶ Duke pohuar praninë e Zotit Krijues, ata i luten:

“O Zoti ynë! Ti je i Shenjtë dhe i Lartë ndryshe nga ajo që njerëzit Të mohojnë e Të veshin Ty me veti të padenja! Andaj, na shpëto nga zjarri i ferrit! Sepse të mohojmë Ty është ferri vetë dhe, të njohim dhe të arrijmë Ty është kënaqësia dhe lumturia vetë. Ai që e privoi veten nga njohja ndaj

Teje, është në zjarr që në këtë botë.

SHËNIME:

[1] “Dhe ata do të thonë: Po të kishim dëgjuar ose të kishim logjikuar, nuk do të ishim mes banorëve të zjarrit.” (El-Mulk 67:11).

[2] “Allahu nuk ngarkon asnjë shpirt përtej fuqisë që ka.” (El-Bekare 2:287).

[3] “Kjo është një kujtesë e bekuar”. (El-Enbija 21:51).

[4] “Nuk ka imponim në fe”. (El-Bekare 2:257).

[5] “... është shërim për atë (sëmundje) që keni në kraharorë”. (Junus 10:58).

[6] “Pa dyshim, në krijimin e qiejve dhe të tokës dhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka shenja për të mençurit. Ata që kujtojnë Allahun në këmbë, ulur dhe kur janë (shtrirë) në ijët e tyre dhe thellohen në krijimin e qiejve dhe të tokës: “O Zoti ynë! Këto nuk i ke krijuar kot! Ti je i Shenjtë. Andaj, na shpëto nga ndëshkimi i zjarrit!”” (Al Imran 3:191-192).

Lutja e hallexhiut

Hazret Abdurrahman Ibni Ebu Bekri r.a. tregon se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. tha se hallexhiu duhet të bëjë këtë lutje:

اَللّٰهُمَّ رَحْمَتَكَ اَرْجُوْ فَلَا تَكِلْنِيْ اِلَى نَفْسِيْ طَرَفَةً عَيْنٍ، وَاَصْلِحْ لِيْ شَأْنِيْ كُلَّهُ لَا اِلَهَ اِلَّا اَنْتَ

O Allah, mëshirën Tënde kërkoj! As për një çast të vetëm mos më dorëzo te vetja ime! Më rregullo gjithë çështjen time! Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Teje!

Sunen Ebi Davud, kitab "El-Edeb", bab "Ma lekulu idha asbaha", hadithi nr. 5090.

Dallimi midis vetëpëlqimit dhe vlerësimit të vetvetes

Pra, është shumë e rëndësishme që të mos paragjykon veten tuaj dhe, ashtu siç është e keqe të paragjykon të tjerët, në të njëjtën mënyrë edhe paragjykimi ndaj vetes nuk është mirë, por është mëkat. Duke iu mbështetur Allahut, duhet të besoni se nuk do ta lini shejtanin të triumfojë mbi ju. Dallimi midis moszhgënjimit ose mosparagjykimit ndaj vetes dhe vetëpëlqimit ose mburrjes është që e para gjithmonë bëhet për përpjekjet që njeriu ka për të bërë në të ardhmen, kurse e dyta në përgjithësi bëhet për punët që ka bërë në të kaluarën.

Njeriu që i pëlqen vetja dhe që mburret, shumë shpejt frikësohet gjatë misionit, por kur e përfundon punën, krenohet për të. Ndërsa ai që i mbështetet Zotit dhe nuk e paragjykon veten e tij, mban shpresën gjatë gjithë kohës kur është duke u marrë me ndonjë punë, dhe kur e përfundon atë, nuk e zë më në gojë.



SUKSESI

ÇFARË ËSHTË SUKSESI PËR VENDIN TONË?

Hazret Mirza Bashiruddin Mahmud Ahmedi

Kalifi i Dytë i Mesihut të Premtuar ^{r.a.}

Sukses është një fjalë, kuptimin e së cilës njerëzit e vendit tonë në përgjithësi, nuk e dinë plotësisht, dhe kjo pikërisht është edhe arsyeja e dështimeve tona. [Por çfarë është suksesi?] Në vendin tonë sukses do të thotë para; sukses do të thotë veshje të shtrenjta e ushqime të shijshme; sukses do të thotë pushtet ose qeverisje mbi të tjerët, etj.. Por e vërteta është që nuk ka kuptim më të gabuar të suksesit sesa ky.

Ato që ne i kemi quajtur sukses, dhe që i kemi bërë edhe synime të jetës sonë, në të vërtetë janë pengesa në rrugën tonë drejt suksesit. Realisht, këto gjëra nuk janë sukses në vetvete, por ato i gëzojmë nganjëherë për shkak të suksesit.

Duke mos e kuptuar pikërisht këtë realitet, disa njerëz nganjëherë më pyesin – Pse Hazret Imam Husejni ^{a.s.}

kishte dështuar dhe se pse Jezidi pati sukses?

Por nëse do të thelloheshin, do ta kuptonin, që Jezidi, pavarësisht nga pasuria, pushteti dhe luksi në të cilin jetonte, dështoi, kurse Hazret Imam Husejni ^{a.s.}, pavarësisht se ra dëshmor, e arriti suksesin. Pse? Sepse, ai nuk synonte pushtetin, por mbrojtjen e të drejtave të njerëzve.

Tani që kanë kaluar trembëdhjetë shekuj nga kjo ngjarje, parimi i shenjtë për të cilin Hazret Imam Husejni ^{a.s.} ishte ngritur, pra e drejta për të zgjedhur Kalifin u takonte qytetarëve të vendit dhe se asnjë njeri nuk kishte të drejtë ta uzurponte këtë të drejtë, duke ia kaluar si trashëgimi birit të vet, mbetet edhe sot e gjithë ditën po aq i shenjtë siç ishte atëherë. Madje, rënia dëshmor e tij e qartësoi edhe

më shumë këtë të drejtë. Andaj, Hazret Imam Husejni u bë i suksesshëm, e jo Jezidi.

Kurani i Shenjtë me disa fjalë shumë të thjeshta tregon çelësin e suksesit, për të cilin dua t’ju tërheq vëmendjen:

وَالسَّابِقُونَ السَّابِقُونَ مِنَ الْمُهَاجِرِينَ وَالْأَنْصَارِ وَالَّذِينَ اتَّبَعُوهُمْ بِإِحْسَانٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمْ وَرَضُوا عَنْهُ وَأَعَدَّ لَهُمْ جَنَّاتٍ تَجْرِي تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا أَبَدًا ۖ ذَٰلِكَ الْفَوْزُ الْعَظِيمُ ﴿١٠٠﴾

“Dhe prej muhaxhirëve dhe ensarëve që janë fitimtarët e parë, si dhe ata që i ndoqën këta në mirësi, Allahu është i kënaqur prej tyre dhe ata janë të kënaqur prej Tij. Dhe Ai u ka përgatitur kopshte nëpër të cilat rrjedhin lumenj. Ata në to do të jetojnë përgjithmonë. Ky është sukseksi madhështor!”¹

Ky ajet flet për ata të cilët parakalojnë të tjerët dhe gjithnjë përpiqen të jenë në vendin e parë, por që janë ndër ata që janë të gatshëm për të sakrifikuar çdo gjë për hir të Zotit të Madhërishëm, po kështu, ajeti flet edhe për ata të cilët angazhohen për t’i ndihmuar këta që u quajtën të parët, si dhe flet për një grup tjetër, i cili ndjek shembullin e këtyre të dyve, dhe në fund pohon: Allahu ka mbetur i kënaqur me ta dhe ata kanë mbetur të kënaqur me Allahun, dhe se Ai u ka përgatitur disa kopshte nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ata atje do të jetojnë përgjithmonë. Ky është sukseksi madhështor.

Ky ajet pohon se sukseksi i vërtetë për ty është të arrish pëlqimin e Zotit të Madhërishëm, dhe se rehatia dhe lehtësia do të të vijë vetvetiu, si rezultat i pëlqimit të Zotit, por ato nuk janë synime në vetvete.

Çelësi i suksesit

Po kështu, në këtë ajet, Allahu i Madhërishëm tregon çelësin e suksesit që populli që përpiket të parakalojë popujt e tjerë ose përpiket të zërë vendin e parë në arritjen e atyre synimeve, të cilat i kërkojnë sakrifica dhe që, në shikim të parë, nuk sjellin përfitime vetjake, por u sjellin dobi të tjerëve, ai popull quhet i suksesshëm.

Ky është ai çelës i suksesit, të cilin vendi ynë e ka harruar. Dhe pikërisht ky është ai çelës, pa të cilin sukseksi është i pamundur. Në vendin tonë kemi plot njerëz miliarderë, plot njerëz që zotërojnë prona të shumta, por prapëseprapë, nuk jemi të suksesshëm. Kjo për arsye se përpjekjet e vendit tonë dhe të qytetarëve të vendit tonë, që të gjitha harxhohen për të mbajtur nderin personal dhe për të arritur rehatinë personale.

Kurse, sipas këtij ajeti, çelësi i suksesit është që i gjithë populli t’u përngajë muhaxhirëve, pra ta harrojnë veten e tyre dhe të angazhohen në punët që janë në dobi të njerëzimit; ose t’u përngajë

ensarëve, pra, të bëhen ndihmëtarë të njerëzve siç ishin muhaxhirët. Sakrifica e këtij grupi ose e këtij populli të jetë aq e lartë, saqë çdo shtet i botës të gëzojë dobi të shumta, për të cilat të jetë i bindur se pa sakrificën e atij grupi të parë, këto do të ishin të pamundura. Ky popull quhet i suksesshëm dhe përmendja e mbarë e këtij populli do të mbetet përgjithmonë.

Shpresoj se bashkëqytetarët e mi ta kuptojnë këtë të vërtetë dhe të përpiqen ta arrijnë atë. Nuk mund të arrini suksesin vetëm duke kopjuar. Për sa kohë që nuk do të përpiqeni të bëheni “fitimtarët e parë” dhe për sa kohë që nuk do të arrini t’i bëni popujt e tjerë t’ju ndjekin ju, do të vijoni të përballeni me dështime.

Por, vallë, akoma nuk paska ardhur koha që dështimet tona të mëparshme të na zgjojnë?! Vallë, a ka ndonjë humnerë më të thellë që ne ta vijojmë të tatëpjetën tonë?! Pasi kaluam fëmijërinë, a nuk do ta gëzojmë, vallë, rininë, dhe a do të përfundojmë në pleqëri pa e shijuar forcën?! Zoti kurrë mos na bëftë të tillë! Zoti e bëftë popullin tonë të marrë ngjyrën e muhaxhirëve e të ensarëve, dhe të qëndrojë krahë për krahë me “fitimtarët e parë” në arenën e zhvillimit të botës, dhe çdo sakrificë t’i bëhet e lehtë jo vetëm përkohësisht, por përjetësisht, dhe të lërë në arenën e suksesit gjurmë kaq të forta, që as koha të mos i fshijë dot! Amin! Amin o Zot!

Dhe thirrja jonë e fundit do të jetë që lavdia është e Allahut, Zotit të botëve.²

SHËNIME:

[1] Kurani Famëlartë 9:100.

[2] Gazeta “Al-Fazl”, e datës 12 korrik, 1929; marrë nga “*Envarul-‘ulum*”, vëll. 10, “Nazarat Nashr-o-isha’at Qadian, 2008, f. 589 – 591.



STUDIMI MË I MADH MBI KONSUMIMIN E ALKOOLIT, PROVON VËRTETËSINË E KURANIT, TË ZBRITUR 1400 VJET MË PARË

Një ditë tjetër dhe një ajet tjetër i Kuranit, i vërtetuar nga shkenca empirike. Këtë herë, vetë fjalët e Kuranit janë theksuar (me pavetëdi) në përfundimin e studimit në fjalë.

Mesazhi kryesor i studimit

Duke parë 195 vende ndërmjet viteve 1990 dhe 2016, kjo meta-analizë (më e madhja e këtij lloji), pjesë e serisë The Global Burden of Disease 2016, botuar në revistën e shquar mjekësore të botës, Lancet, përfundoi si vijon:

... Këto të dhëna theksojnë që përdorimi i alkoolit, pavarësisht nga sasia, çon

në humbjen e shëndetit në të gjithë popullatat. Megjithatë gjetëm disa efekte mbrojtëse për sëmundjen ishemike të zemrës dhe diabetin te gratë, këto efekte u venitën kur u morën parasysh rreziqet e përgjithshme shëndetësore, veçanërisht për shkak të lidhjes së fortë midis konsumit të alkoolit dhe rrezikut të kancerit, të lëndimeve dhe të sëmundjeve të transmetueshme. Këto zbulime theksojnë rëndësinë e vlerësimit se si përdorimi i alkoolit ndikon në shëndetin e popullatës gjatë gjithë jetës.¹

Gazeta *The Independent* përmbledhi gjetjet si më poshtë:

Megjithatë studimi i mëparshëm ka treguar që nivelet e moderuara të pirjes mund të mbrojnë nga sëmundjet e zemrës, studimi i ri arriti në përfundimin se çdo rritje e supozuar e shëndetit² zhvlerësohet masivisht nga kostot.³

Sado e habitshme mund të duket, kjo është fjalë për fjalë ajo që Kurani i Shenjtë ka dhënë si argument 1400 vjet më parë:

يَسْأَلُونَكَ عَنِ الْخَمْرِ وَالْمَيْسِرِ ۖ قُلْ فِيهِمَا إِثْمٌ كَبِيرٌ وَمَنَافِعُ لِلنَّاسِ وَإِثْمُهُمَا أَكْبَرُ مِن نَّفْعِهِمَا ۚ وَيَسْأَلُونَكَ مَاذَا يُنْفِقُونَ قُلِ الْعَفْوَ ۚ كَذَلِكَ يُبَيِّنُ اللَّهُ لَكُمُ الْآيَاتِ لَعَلَّكُمْ تَتَذَكَّرُونَ ﴿٩٠﴾

“Të pyesin ty për alkoolin dhe kumarin. Thuaj: “Nga to ka (edhe) mëkat të madh, edhe dobi për njerëzit. Por mëkati prej tyre është më i madh sesa dobia e tyre”. Dhe të pyesin ty se çfarë të shpenzojnë. Thuaj: “Atë që ju tepron”. Kështu Allahu ju shpjegon qartë shenjat e Tij, që të mendoni.”⁴

Është një karakteristikë e Kuranit që ai pranon edhe përfitimin më të vogël që mund të jetë i pranishëm në një gjë të caktuar. Kjo qasje e hapur dhe e sinqertë ka bërë që muslimanët të kuptonin arsyetimin e ndalimit të alkoolit në fenë e tyre, dhe rezultoi që ata të konsumojnë alkoolin më pak, nga të gjitha bashkësitë fetare për 1400 vitet e fundit.

Rezultatet

Përfundimet e studimit The Global Burden of Disease do të trondisë disa, kurse disa të tjerë aspak. Ata zbuluan se për moshat 15-49 vjeç, alkooli ishte

shkaku kryesor i vdekjes tek burrat (12.2%) dhe te gratë (3.8%) globalisht. Këto nivele të larta të vdekshmërisë erdhën si rezultat i rritjes së gjasave të tuberkulozit, të aksidenteve të trafikut rrugor dhe të vetë-dëmtimit. Midis atyre më të vjetër se 50 vjeç, gjasat dhe rritja e kancerit ishin shkaku kryesor i vdekjes si për burrat (18.9%), ashtu edhe për gratë (27.1%).

Më në fund, ata zbuluan se niveli i vetëm i alkoolit në të cilin këto dëmtime u minimizuan, nën nivelin e konsumit “të moderuar” të alkoolit që mendohet se ofron një përfitim, ishte zero. Me fjalë të tjera, nuk ka asnjë nivel të konsumit të alkoolit që është i mirë për ju. Ata e përshkruan këtë gjetje si më poshtë:


Në vlerësimin e kurbës së rrezikut relativ të ponderuar, kemi gjetur se konsumimi zero i pijeve standarde (95% UI 0.0 – 0.8) çdo ditë minimizon rrezikun e përgjithshëm të të gjitha humbjeve shëndetësore (shih grafikun më poshtë). Rreziku u rrit monotonisht me rritjen e sasive të pirjes ditore.

Kjo kurbë e rrezikut relativ të ponderuar mori parasysh efektet mbrojtëse të përdorimit të alkoolit të shoqëruar me sëmundje ishemike të zemrës dhe të diabetit te femrat. Sidoqoftë, këto efekte mbrojtëse u zhvlerësuan nga rreziqet që lidhen me kanceret, të cilat u rritën monotonisht me konsumin.

Një ndarje e rreziqeve relative për secilën barrë të sëmundjes tregohet në grafikët më poshtë:

(A) Kurbat e rrezikut relativ për kancerin e gjirit, sëmundjen ishemike të zemrës, diabetin dhe tuberkulozin te femrat.

(B) Kurbat e rrezikut relativ për kancerin e buzëve dhe të zgavrës së gojës, sëmundjen ishemike të zemrës, diabetin dhe tuberkulozin te meshkujt. Pikët janë vlerësime relative të rrezikut



nga studimet. Shiritat vertikale dhe horizontale kapin pasigurinë në secilin studim, në lidhje me madhësinë e mostrës dhe numrin e pijeve të konsumuara nga individë në studim. Vija e zezë përfaqëson rrezikun relativ të vlerësuar për secilën gjendje në secilin nivel të konsumit. Zonat e gjelbërta përfaqësojnë intervalin e pasigurisë 95%, të lidhur me rrezikun relativ të vlerësuar. Vija me pika është një vijë referimi për një rrezik relativ prej.¹

Përfundimi

Gazeta *The Independent* përmbledhi ndarjen e gjetjeve në bazë të numrit të

pijeve në ditë, si më poshtë:

Ata vlerësuan se një pije në ditë rrit rrezikun e zhvillimit të një sëmundjeje të lidhur me alkoolin duke përfshirë kancerin, diabetin dhe tuberkulozin me 0.5 përqind. Kjo shtoi deri në 7 përqind për ata që pinë dy pije në ditë, dhe 37 përqind për pesë pije në ditë.

Vetëm para pak ditësh kemi trajtuar se si shkenca moderne, kohët e fundit ka vërtetuar thënien shumë specifike të Kuranit, që malet nënujore ulin efektet e tërmeteve për ne që jetojmë në sipërfaqen e Tokës.⁵ Tani po shohim një shpallje tjetër Kuranore që po përmbushet në mënyrën më të goditur, me një ri-formulim të drejtpërdrejtë të arsytimit Kuranor në meta-analizën më të madhe të kryer ndonjëherë mbi alkoolin.


Këto shërbejnë si shenja të qarta të së vërtetës së Kuranit Famëlartë, por në idiomën Kuranore, vetëm për ata që kanë veshë për të dëgjuar.

أَفَلَمْ يَسِيرُوا فِي الْأَرْضِ فَتَكُونَ لَهُمْ قُلُوبٌ يَعْقِلُونَ بِهَا أَوْ آذَانٌ يَسْمَعُونَ بِهَا
فَأَبْهَاتُوا الْأَبْصَارَ وَلَكِنْ تَتَعَمَّى الْقُلُوبُ الَّتِي فِي الصُّدُورِ

“A nuk kanë shëtitur në tokë, që të kishin zemra që të kuptonin përmes tyre dhe veshë që të dëgjonin prej tyre?! Sepse në të vërtetë, nuk verbohën sytë, por verbohën zemrat që janë në kraharorë.”⁶

SHËNIME:

[1] Vizitoni: [https://www.thelancet.com/journals/lancet/article/PIIS0140-6736\(18\)31310-2/fulltext](https://www.thelancet.com/journals/lancet/article/PIIS0140-6736(18)31310-2/fulltext)



[2] <https://www.independent.co.uk/news/health/wine-alcohol-dementia-middle-age-teetotal-abstinence-a8473351.html>

[3] <https://www.independent.co.uk/news/health/alcohol-drinking-no-safe-level-health-heart-disease-cancer-study-a8505181.html>

[4] Kurani i Shenjtë 2:220.

[5] <https://rationalreligion.co.uk/1400-year-old-quranic-claim-on-mountains-earthquakes-proven-true-by-new-scientific-research/>

[6] Kurani i Shenjtë 22:47.

Burimi: <https://bit.ly/30Q2XZK>



IDENTITETI DHE IMAZHI I NJË MUSLIMANI

Ahmad Kamal

وَإِذْ قَالَ رَبُّكَ لِلْمَلَائِكَةِ إِنِّي جَاعِلٌ فِي الْأَرْضِ خَلِيفَةً ۖ قَالُوا أَتَجْعَلُ فِيهَا مَنْ يُفْسِدُ فِيهَا وَيَسْفِكُ الدِّمَاءَ وَنَحْنُ نُسَبِّحُ بِحَمْدِكَ وَنُقَدِّسُ لَكَ ۗ قَالَ إِنِّي أَعْلَمُ مَا لَا تَعْلَمُونَ ﴿١٠٠﴾

“Dhe kur Zoti yt u tha engjëjve: “Unë do të vë një mëkëmbës në Tokë”. Ata thanë: “A do të vësh dikë që do të bëjë çrregullime në të dhe do të derdhë gjak, ndërkohë që ne të përkujtojmë Ty me lavdërimin Tënd dhe përmendim shenjtërinë Tënde?” Ai tha: “Unë e di atë që ju nuk e dini.”¹

Përgjigja për atë që Allahu e dinte dhe atë që u ishte fshehur engjëjve është përgjigja kur ne si muslimanë, i bëjmë pyetje vetes rreth identitetit dhe imazhit tonë.

Kush jemi ne?

Të dashur lexues! Kush jemi ne? Kjo është një pyetje kaq e rëndësishme që e hasim qindra, nëse jo, mijëra herë gjatë jetës sonë, të cilës pyetje mendojmë se çdo herë u përgjigjemi saktë. Por, a jemi plotësisht të sigurt se kemi deklaruar identitetin tonë të vërtetë? Kush jemi ne në të vërtetë? A jemi ne vetëm një emër dhe mbiemër? Një gjerman, një pakistanez, një arab, një evropian? Një punonjës, akademik, tifoz i apasionuar i ekipit sportiv apo anëtar partie? A mundet ndonjë nga këto përgjigje të pasqyrojë vërtetë thelbin e identitetit tonë? Cili është identiteti ynë i vërtetë?

“Kush jam unë dhe nëse po, sa shumë?” Filozofët shpesh e kanë trajtuar thelbin e identitetit njerëzor gjatë historisë, por asnjëherë nuk e kanë deshifruar plotësisht atë. Kjo pyetje rreth identitetit nëse mbetet pa përgjigje mund të çojë në mjegullën e nihilizmit. Sipas nihilistëve, ekzistenca nuk është kuptimi më i lartë. Bota jonë dhe ne jemi produkte të rastësishme.

Universi pothuajse i pafund është zbuluar nga galaktika të panumërta, secila prej tyre përbëhet nga miliarda dhe miliarda yje, që i bëjnë planetët të lëvizin në orbita të caktuara rreth tyre. Dhe ndër planetët, toka jonë, është e banueshme nga miliona e miliona specie. Truri i njeriut ka më shumë sinapse sesa Rruga e Qumështit ka yje. Funksionaliteti i tij është më kompleks se çdo kompjuter i bërë nga njeriu, dhe projekti i tij është regjistruar vetëm në një pjesë të ADN-së njerëzore. Këto konstante të natyrës dhe ligjeve të natyrës të koordinuara hollësisht zbulojnë një bukuri që mund të gjendet vetëm në veprat e përsosura të artit – të gjitha këto produkte të rastësishme, pa ndonjë sens apo kuptim më të lartë?! Rendi dhe harmonia e gjithë kozmosit na bëjnë në mënyrë të pashmangshme të bërtasim: “Jo!”

Asgjë nuk u krijua rastësisht

رَبَّنَا مَا خَلَقْتَ هَذَا بَاطِلًا

“O Zoti ynë! Këto nuk i ke krijuar kot!”²

Allahu nuk krijoi për veten asgjë!

لَقَدْ خَلَقْنَا الْإِنْسَانَ فِي أَحْسَنِ تَقْوِيمٍ

“Vërtet, Ne e krijuam njeriun në formën më të bukur.”³

Çfarë ishte ajo që ishte e fshehur për engjëjt që Allahu synonte të na dhuronte nga urtësia e Tij gjithëpërfshirëse? Allahu na e zbulon atë në Kuranin e Shenjtë në vende të ndryshme:

إِذْ قَالَ رَبُّكَ لِلْمَلَائِكَةِ إِنِّي خَالِقٌ بَشَرًا مِنْ طِينٍ
فَإِذَا سَوَّيْتُهُ وَنَفَخْتُ فِيهِ مِنْ رُوحِي فَقَعُوا لَهُ سَاجِدِينَ
فَسَجَدَ الْمَلَائِكَةُ كُلُّهُمْ أَتْمَعُونَ
إِلَّا إِبْلِيسَ اسْتَكْبَرَ وَكَانَ مِنَ الْكَافِرِينَ

“Kur Zoti yt u tha engjëjve: ‘Unë po krijoj njeriun nga balta, dhe kur ta kem formuar dhe të kem fryrë në të prej Shpirtin Tim, atëherë përkuluni dhe tregojini atij druajtje.’ Pastaj të gjithë engjëjt u përkulën me druajtje, pa përjashtim, përveç Iblisit. Ai u bë mendjemadh dhe tashmë ishte prej mosbesimtarëve.”⁴

Pra, njeriu është një krijim shumë i veçantë sepse Allahu i ka dhënë frymën e Tij në të.

Në këtë pikë, fryma hyjnore nënkupton aftësinë e njeriut për të pasqyruar karakteristikat e krijuesit të tij dhe kështu

të bëhet i ngjashëm me të. Mesihu i Premtuar a.s. në librin “Hakikatul-Vahji” shpjegon se imazhi i Allahut do të thotë ngjashmëri shpirtërore me Të.

Kjo frymë e Allahut e bën njeriun një krijim kaq sublim, saqë edhe engjëjt, me urdhër të Allahut, iu desh të bënin sexhde para tij. Çfarë grade sublime, çfarë hiri hyjnor!

Dhe kur Zoti i Botëve dhe Krijuesi thërret secilin shpirt që të vijë në ekzistencë nga asgjëja, atëherë Ai gjithashtu i lejon ata të dëshmojnë:

أَلَسْتُ بِرَبِّكُمْ قَالُوا بَلَىٰ شَهِدْنَا

“A nuk jam Zoti juaj?” Ata thanë: “Po, ne dëshmuam”.⁵

Njeriu u krijua sipas imazhit të Zotit

Ne muslimanët ahmedianë jemi të vetëdijshëm se edhe para ekzistencës sonë tokësore ne dëshmuam se Allahu është Zoti ynë, se Ai është origjina jonë dhe vetëm tek Ai kthimi ynë – *Inna lil-lahi ve inna ilejhi raxhi’un*.

Origjina dhe kthimi i njerëzve janë të një natyre transhendente, ne duhet të pyesim veten se cilat do të jenë pasojat e këtij imazhi në këtë jetë të kësaj bote. Si shfaqet Shpirti i Zotit në ne? Çfarë na bën saktësisht të ngjashëm me Të?

Kjo është ajo që na shpjegon Hazret

Musleh-e-Ma’udi ^{r.a.} në librin e tij “*Mesh’ale-e-Rab*”:

“Është vetëm Zoti që nuk bën asnjë veprim për përfitimin e Tij, por vepron vetëm për të mirën e krijesave. Ai është i Vetëmjaftueshëm (Ganij) dhe i lirë nga njollosja e të qenit i varur nga ndonjë përfitim. Çdo gjë që Ai bën është në dobi të krijimit të Tij. Pra, kur një person bën diçka që nuk është në dobi të tij, por të të tjerëve, ai në atë moment është reflektim i Zotit. Vetëm atëherë imazhi i Zotit mund të njihet në qenien e tij.”

Hazret Musleh-e-Ma’udi ^{r.a.} më tej shpjegon:

Profeti i Shenjtë (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) tha: ‘Kur të vini në namazet e së Premtes, duhet t’i parfumosni rrobat tuaja’. Parfumosja mund të marrë vetëm një çast, por aroma mbetet për disa orë, ditë, madje edhe javë, në varësi të cilësisë. Shiu bie vetëm për një periudhë të caktuar kohe, por efekti i tij freskues zgjat me ditë. Një zjarr digjet dhe fiket, por ngrohtësia e tij mbetet në dhomë më pas. Po kështu, nëse besimtari ndihmon të tjerët qoftë duke anashkaluar veten e tij, ai bëhet një pasqyrim i Zotit. Si mund të ndodhë që nga njëra anë një spërkatje e një arome në rroba lë efektin e saj për disa ditë, dielli që tashmë ka perënduar akoma lë ngrohtësinë e tij në tokë, shiu ndalet, por

efekti i tij freskues ruhet ende, dhe nga ana tjetër Zoti shfaqet në një person, por efekti zbehet pas përfundimit të punës?

Nëse bëheni pasqyrim i Zotit për vetëm një minutë, gjendja juaj do të vazhdojë të pasqyrojë atributet e Zotit për orë të tëra më pas. Nëse e bëni një veprim të tillë për një moment, do të jeni një pasqyrim i Zotit për orë të tëra. Nëse vazhdoni me këtë moment, ju mund të jeni një pasqyrim i Allahut gjatë gjithë ditës, edhe nëse në sytë e botës ju i keni shërbyer njerëzve vetëm për një ose dy orë...

Hazret Musleh-e-Ma’udi ^{r.a.} gjithashtu thotë:

Jo vetëm që është e mundur, por me siguri shpirti juaj i pastruar do të rritet aq shumë dhe qëllimet tuaja do të jenë aq të pastra sa puna juaj dyorëshe do t’ju bëjë një reflektim të Zotit jo për vetëm 22 orët e ardhshme, por ky imazh i ditës së mëparshme do të vazhdojë të ekzistojë ditën tjetër dhe puna juaj, të cilën e filloni ditën tjetër si imazh i Zotit, do të vazhdojë të rritet, kështu që të dy imazhet do të shumëfishojnë dritën tuaj së bashku dhe trupi juaj gradualisht do të bëhet një koleksion i pafund i imazheve hyjnore. Kushdo që ecën në këtë rrugë – ia kushton jetën Allahut, dhe ky është gjithashtu kuptimi i sakrifikimit të jetës së tij në rrugën e Allahut.

Pra, ne bëhemi imazhi i Zotit! Pyetja e vetme që shtrohet tani është deri në ç'masë secili prej nesh e ndjek këtë përpjekje të vazhdueshme? A i njohim cilësitë e Allahut? Sa prej nesh e pasqyrojnë këtë dhe kështu shfaqin shpirtin hyjnor çdo ditë në shërbim të qenieve njerëzore dhe krijimit? Deri në ç'masë e mbajmë këtë imazh të identitetit brenda nesh dhe imazhin e Zotit si identitet?

A e ka ndryshuar pandemia gjendjen tonë?

Ne, mbi 7 miliardë njerëz në këtë planet, jemi aktualisht në mes të një pandemie. Dhe të gjithë pajtohen se kjo pandemi paraqet një pikë kthese: Jeta më pas nuk do të jetë më siç e kemi njohur para pandemisë. Sidoqoftë, pyetja vendimtare është: çfarë ka ndryshuar kjo pandemi në gjendjen tonë mendore? Sot a jemi më të shqetësuar dhe më të vendosur se më parë në përpjekjen për siguri materiale? Apo jemi ata që e kemi kuptuar se sa e pakuptimtë është jeta tokësore dhe pastaj kërkojmë strehim tek Krijuesi ynë? Duhet vetëm një virus i vogël, aq i padukshëm për syrin e njeriut, për të përmbytur të gjithë botën njerëzore. Botën e atij personi i cili, në mendjen e tij çliroi veten nga zgjedha e natyrës dhe u vendos si një specie e padiskutueshme, nga i sunduar tek sundimtar i saj. Por, ai mësoi se sundimtari i supozuar sot u gjunjëzua nga një virus i vogël dhe u la i

pafuqishëm dhe i paaftë.

Aktualisht, shumë njerëz pyesin: a mund të flasim për një ndëshkim hyjnor këtu! Si e njihni ndëshkimin hyjnor? Nëse një person afrohet më shumë me Zotin gjatë një faze vuajtjeje, dikush flet për një sprovë. Por, pavarësisht nga vuajtja, nëse një person largohet gjithnjë e më larg nga Zoti, vuajtja do të jetë një ndëshkim.

Përballë pandemisë, megjithatë, njerëzit duket se mbajnë qëndrimet e tyre patologjike të pandërprera. Ne vazhdojmë të jetojmë në një shoqëri që ka zgjedhur narcisizmin dhe hedonizmin si idhuj të saj. Ndonëse qytetërimi njerëzor tronditet dhe kërcënohet të shembet, njeriu zhytet paturpësisht në ngutje dhe nxitim drejt kotësive dhe dëfrimeve. Këto zhurma janë të panumërta dhe tani na vijnë në formën e mediave sociale edhe në formën dixhitale. Ndonëse njerëzit mësojnë për mirëqenien e qindra miqve të supozuar në Facebook, ata as që e dinë se si janë fqinjët e tyre. Në vend që të ndajnë bukën e tyre me mbi 155 milionë njerëz të uritur në të gjithë botën, në vend të tyre njerëzit shpërndajnë fotografi të ushqimeve të tyre në Instagram. Gjersa njerëz të panumërt në mbarë botën bëhen viktimat të bombardimit qilim, njerëzit vallëzojnë nën ritmin e videove të TikTok.

Ç'thonë psikologët për këtë gjendje?

Shkurtimisht: duket sikur njerëzit po largohen më shumë nga Allahu dhe po i kushtohen gjithnjë e më shumë materializmit, kënaqësisë dhe dekadencës së pakuptimtë. Megjithatë, edhe në këto gjëra ai nuk do të jetë i kënaqur. Kjo është një pije që nuk mund të shuajë etjen e shpirtit! Përparimi teknologjik i njerëzimit nuk ka qenë kurrë kaq i madh, në të njëjtën kohë njeriu kurrë nuk është ndjerë aq i tjetërsuar nga vetja. Ose e thënë sipas fjalëve të profesorit të psikologjisë Paul Verhaeghe:

Asnjëherë nuk është thënë se ishim kaq mirë – por kurrë më parë nuk jemi ndjerë kaq keq. Ideologjia neoliberale tani përshkon jetën tonë deri në cepin e fundit: Ajo formëson perceptimin tonë për veten, marrëdhënien tonë me trupat tanë, partnerët dhe fëmijët tanë – me fjalë të tjera, identitetin tonë. Me sa duket liria e re dhe përgjegjësia personale ka një anë negative. Mesazhi i tyre i nënkuptuar është: Të gjithë mund të jenë të përsosur, të gjithë mund të kenë gjithçka. Ata që dështojnë nuk janë përpjekur mjaftueshëm; kush dështon është vetëm fajtor. Turpi dhe ndjenja e fajit janë rezultati, zemërimi, agresioni dhe pikëllimi i përhapur, dyshimi në vetvete dhe “çrregullime bipolare” – apo edhe iluzion dhe mashtrim kur bëhet fjalë për përmbushjen e katalogëve të

performancës së tejmbushur të botës moderne të punës...

Jo gjithçka që shkëlqen është ar

Hazret Mirza Masrur Ahmedi (Allahu e ndihmoftë fuqimisht) kohët e fundit paralajmëroi pikërisht për këtë anë të errët të një lirie të pretenduar:

Jetojmë në një kohë që është plot me materializëm. Ka shumë njerëz inteligjentë në këtë kohë, por ata janë pa spiritualitet dhe vlera morale. Ata e konsiderojnë të artë gjithçka që shkëlqen. Ata vetë nuk e dinë se sa sipërfaqësore janë bërë qëndrimet e tyre dhe sa serioze mund të jenë pasojat për t'u bërë kaq të varur nga materializmi. Jam i sigurt se do të vijë një kohë kur ata do të kuptojnë se konsumi i vazhdueshëm i materializmit të përshkruar në televizion, internet dhe media sociale, si dhe ndjekja e dëshirave të kota, ka qenë në disavantazhin e tyre të madh. Do të shihni se çfarëdo që ata menduan se ishte e mirë dhe përparimtare, në të vërtetë ka shkaktuar një sëmundje shpirtërore dhe morale, siç nuk mund ta ketë parë bota më parë. Ata do të detyrohen të pranojnë se pasuria e botës i la ata të varfër shpirtërisht dhe të falimentuar moralisht. Ne jemi dëshmitarë të tyre, sepse një numër shumë më i lartë se më parë vuajnë nga histeria, depresioni dhe sëmundje të tjera mendore. Unë jam plotësisht i bindur se arsyeja për këtë qëndron në

faktin se ata ishin bllokuar në aspiratat dhe dëshirat e tyre materialiste dhe, mbi të gjitha, sepse ata hoqën dorë nga besimi i tyre në Zotin e Plotfuqishëm.⁶

Historia nuk përsëritet, por shpeshherë rimon

“Historia nuk përsëritet, por shpeshherë rimon!” Kjo do të thotë që: nëse studioni historinë e njerëzimit, ju në mënyrë të pashmangshme dhe në mënyrë mahnitëse do të njiheni me modelet që lindin në epoka dhe rajone të ndryshme të botës që duken se përsëriten. Kurani Famëlartë i referohet vazhdimisht fatit të popujve të ndryshëm të cilët – pavarësisht paralajmërimit nga profetët e dërguar atyre – janë larguar nga Allahu dhe kështu i janë afruar rënies së tyre. Historiani musliman Ibn Khaldun e ka përmbledhur këtë parim të përgjithshëm si më poshtë. Sipas tij:

Historia rimon në katër pjesë të njëpasnjëshme. Faza e parë është ai i revolucionit: një grup njerëzish, të udhëhequr zakonisht nga një udhëheqës ose profet, thyjnë traditat dhe zakonet e kohës së tyre dhe bëjnë thirrje për një rend të ri botëror. Në pjesën tjetër, njerëzit punojnë drejt stabilizimit të rendit botëror të sapokrijuar. Në pjesën vijuese, megjithatë, idealet ngadalë bëhen të paqarta dhe vetëm pak kujtojnë motivin dhe viktimat e revolucionit derisa të duken plotësisht

të harruara në pjesën e katërt dhe të fundit. Njerëzit këtu humbin plotësisht veten në dekadencë.

Kjo a nuk tingëllon e njohur për ne? A nuk është pikërisht zbrazëtia e identitetit dhe vlerave në të cilat njerëzimi duket se po lëviz aktualisht? Ende askush nuk e di se kush është, nga vjen, apo ku po shkon. Çfarë pjese ndjek? Sipas Ibn Khaldunit,

Faza e katërt do të përfundojë me një revolucion të ri dhe rrethi do të vijë i plotë.

Bota jonë është e pjekur për këtë revolucion. Ajo fjalë për fjalë thërret për një profet, një reformator, i cili thyen kokat e idhujve nga identitetet e rreme dhe i ngre njerëzit përsëri në vendin e mëkëmbësit për të cilin ata synojnë.

Rrëfimi më i suksesshëm në historinë njerëzore

Duke pasur parasysh të gjitha revolucionet që ka parë njerëzimi, vetëm një meriton të quhet me të vërtetë një revolucion. Jam duke folur për revolucionin që Profeti Muhammed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ndezi në shkretëtirën e Arabisë në shekullin VII dhe i cili, me ndihmën e Allahut, arriti të të gjithë popujt e botës edhe pas vdekjes së tij. Nëse shkrimtarët po kërkojnë rrëfimin më të suksesshëm në historinë njerëzore

që është pa trillime dhe ekzagjerime, ata nuk do të gjejnë shembull më të mirë sesa biografia e Profetit të Shenjtë, Muhammedit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të).

لَقَدْ كَانَ لَكُمْ فِي رَسُولِ اللَّهِ أُسْوَةٌ حَسَنَةٌ لِمَن كَانَ يَرْجُو اللَّهَ وَالْيَوْمَ الْآخِرَ
وَذَكَرَ اللَّهَ كَثِيرًا ﴿٢٢٠﴾

“Sigurisht, për ju në të Dërguarin e Allahut ka një model të shkëlqyer, për çdokënd që shpreson Allahun dhe ditën e ahiretit dhe kujton shumë Allahun”.⁷

Kështu e sheh shkrimtari dhe politikani francez Alphonse de Lamartine, i cili për Profetin tonë (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) tha:

“Në qoftë se madhështia e qëllimit, ngushtësia e mjeteve dhe pafundësia e rezultateve të arritura, do të ishin tri kriteret për të matur gjeninë njerëzore, atëherë kush do të guxonte të përqaste njerëzit më të mëdhenj të kohëve moderne me figurën e Muhammedit?... Po të kemi parasysh të gjitha standardet me të cilat mund të matet madhështia e njeriut, mundet fare mirë të pyesim: A ka njeri më të madh se ai?”

Kushdo që mendon se profetët dhe veprat e tyre janë vetëm histori nga e kaluara dhe të parëndësishme për kohët moderne, mund të mësojnë më mirë nga pacifisti dhe fituesi i Çmimit Nobel për Letërsi, Bernard Shaw. Ai për Profetin

Muhammed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) shkruan:

“Unë e kam studiuar këtë njeri të mrekullueshëm dhe sipas mendimit tim [...] ai duhet të quhet shpëtimtari i njerëzimit. Unë besoj që, në qoftë se një njeri si ai do të ushtronte pushtetin e botës së sotme, do t’ia arrinte t’i zgjidhte problemet e saj e do t’i sillte paqen dhe lumturinë aq të nevojshme”.

Vetëm ky njeri më i madh në histori, ishte në gjendje të shpallte më të madhin nga të gjitha revolucionet: Para thirrjes së tij, ai i gjeti njerëzit e tij si më barbarët në botë. Çfarëdolloj veprimesh të turpshme që mund të ketë pasur e që ekzistonin në mesin e popullit të tij, njerëzit mburreshin me veprimin e tyre! Ligji i të fortëve ishte gjithmonë i vlefshëm dhe ata që dinin të shtypnin të tjerët më me sukses konsideroheshin të fortë. Të varfërit dhe skllevërit nuk kishin vlerë dhe zakonisht trajtoheshin më keq se bagëtia. Vajzat u konsideruan një turp dhe u varrosën të gjalla pasi lindën. Kurvëria, paturpësia, dehja, krenaria dhe kotësia konsideroheshin virtyte. A nuk konfirmon kjo atë që engjëjt kishin dyshim tek njerëzit?

Profeti Muhammed ^{s.a.v.s.} – Dielli ndriçues

Në mesin e këtyre njerëzve Allahu zgjoi një profet i cili do të kthente dhe

të rindërtonte busullën e tyre morale me 180° duke përdorur shembullin e tij. Duke filluar të pasqyrojë atributet ndriçuese të Allahut, që atëherë ai u bë ylli i ri polar në të cilin të gjithë ata që ecin nëpër jetën tokësore mund të orientoheshin. Çdo person që përpiket sipas shembullit të Profetit Muhammed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) dhe gjithashtu fillon të pasqyrojë cilësitë e Allahut në vetvete, bëhet një udhëzues i ndriçuar për të tjerët.

Edukatorët dhe sociologët gjithmonë kanë rënë dakord se formimi i identitetit fillon në fëmijëri dhe se modelet e roleve janë thelbësore për këtë proces. Qenia njerëzore si qenie shoqërore, është e orientuar natyrshëm në orientimin drejt modeleve në mënyrë që të kuptojë botën përreth tij dhe të gjejë rrugën e tij në të. Në këtë mënyrë, njerëzit formojnë një botëkuptim të bazuar në modele, në të cilat ata ngulitin në mënyrë koherente veten dhe identitetin e tyre. “Më thuaj kush është modeli yt, të të them se kush je.”

Ndoshta asnjë person tjetër në tokë nuk ka kapërcyer kaq shumë faza të vështira duke bërë sakrifica brenda një brezi dhe brenda jetës së tij të arrijë kulmin e suksesit botëror dhe shpirtëror siç bëri Profeti i Shenjtë, Muhammedi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të). Këto nuk janë fjalët e mia. Këto janë fjalët e një jomuslimani, më saktësisht

Michael M. Hart, i cili e rendit Profetin e Shenjtë (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) në vendin e parë në veprën e tij të mirënjohur “**100 njerëzit më me ndikim në histori**”. Ai e renditi para Jezusit nga Nazareti, dhe shumë para Budës dhe Moisiut. Si arsye për këtë përzgjedhje, autori shkroi:

“Ndoshta përzgjedhja ime e Muhammedit për vendin e parë të 100 njerëzve më me ndikim në botë, do t’u ngjallë çudi disa lexuesve, madje disa mund të ngrenë pyetje rreth kësaj, por, ai është i vetmi njeri në histori që mbeti jashtëzakonisht i suksesshëm, jo vetëm në arenën fetare, por edhe laike”.

“Kuranit nuk do t’i mbetet asgjë më shumë se sa teksti”

Ky sukses megjithatë nuk mund t’u jepte drejtësi brezave në vijim, dhe muslimanët u bënë viktima të një rënieje të vazhdueshme pas kalifëve të drejtëudhëzuar: së shpejti nuk mbeti asgjë nga Islami, përveç emrit dhe Kuranit, asgjë më shumë se sa teksti – si thuhet në një hadith të mirënjohur. Por kjo nuk është ajo që Allahu ka synuar për Islamin. Ai u dha muslimanëve nëpërmjet Profetit të Shenjtë, Muhammedit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) lajmin e mirë të ringjalljes së Islamit që do të përmbante shkëndijën e revolucionit që Profeti i Shenjtë (paqja dhe bekimet e Allahut

qofshin mbi të) kishte filluar.

Profeti i Shenjtë (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), duke vënë dorën mbi shpatullën e Hazret Selman Faresiut (Zoti qoftë i kënaqur me të) tha:

‘Edhe sikur besimi të ngjitej në Plejadë (të zhdukej plotësisht nga toka), do të dalin disa nga populli i tij që do ta sjellin atë përsëri në tokë’.

Kur bota të humbasë besimin, disa njerëz do ta ringjallin atë. Në suren El-Xhumu’a, Allahu i ka dhënë detyrën e ringjalljes një grupi njerëzish që ndjekin Profetin e Shenjtë, Muhammedin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) por që ende nuk i janë bashkuar atij.

Ringjallja e Islamit në kohët e mëvonshme

Në suren El-Xhumu’a, ky grup njerëzish nënkupton besnikërinë ndaj Mesihut të Premtuar dhe Mehdiut (paqja qoftë mbi të). Tani na mbetet neve të zgjedhim identitetin e saktë:

وَلَا تَكُونُوا كَالَّذِينَ نَسُوا اللَّهَ فَأَنْسَاهُمْ أُولَئِكَ هُمُ الْفَاسِقُونَ ﴿٨٨﴾

“Mos u bëni si ata që harruan Zotin, kështu që Ai i bëri ata të harrojnë shpirtat e tyre. Këta janë shkelësit”.⁸

A i përkasim ne atij grupi të njerëzve që

përmenden në suren El-Xhumu’a dhe që bëjnë *bej’at* (besëlidhje) në dorën e Mesihut (paqja qoftë mbi të) duke hipur mbi arkën e tij për të sjellë revolucionin që ai udhëhoqi? Mesihu i Premtuar (paqja qoftë mbi të) e përshkruan këtë mision me fjalët e mëposhtme:

Unë u dërgova për të forcuar besimin dhe për të vërtetuar ekzistencën e natyrës hyjnore për njerëzit, pasi gjendja e besimit të çdo populli është bërë jashtëzakonisht e dobët. Bota tjetër konsiderohet si një rrëfim i thjeshtë dhe çdo person tregon përmes veprimit të tij se bindja që ai e lidh me botën, famën dhe statusin e kësaj bote dhe atë besim që ai vendos në mjetet e kësaj bote, në asnjë mënyrë nuk e vendos këtë bindje dhe besim tek Zoti dhe bota tjetër. Ka shumë lloje të oratorëve, por zemrat janë të mbingarkuara nga dashuria e botës. Ishte pikërisht kësi gjendje që Hazret Mesihu i gjeti hebrenjtë. Dhe siç është e natyrshme dobësimi i besimit, ashtu edhe gjendja morale e hebrenjve ishte shumë e shthurur. Unë u dërgova në mënyrë që koha e vërtetësisë dhe besimit të fillonte përsëri dhe që frika ndaj Zotit të lindte në zemra. Ky është qëllimi i qenies sime. Më është zbuluar se parajsa do t’i afrohet tokës përsëri pasi është zhvendosur shumë larg.

Rikthimi i Kalifatit përmes rrugës së profetësisë

Ky mision, i cili iu dha Mesihut të Premtuar (paqja qoftë mbi të) nga Allahu, është aq i madh dhe i gjerë saqë për një jetë të shkurtër njerëzore është e pamundur të përfundohet. Për këtë arsye, Allahu e ka ringjallur Kalifatin përmes rrugës së profetësisë pasi muslimanët harruan identitetin e tyre gjatë shekujve pas vdekjes së Kalifëve të Drejtëudhëzuar dhe trashëgimia e Kalifatit u varros në rrënojat e identiteteve të rreme.

Duke përfaqësuar Mesihun e Premtuar (paqja qoftë mbi të), Kalifi i kohës na thërret sot:

صدق سے میری طرف آؤ اسی میں خیر ہے

ہیں درندے ہر طرف میں عافیت کا ہوں حصار

Ejani tek unë me sinqeritet, vetëm aty qëndron e mira –

Egërsirat fshihen nga të gjitha anët, unë jam festa e sigurisë!

Ne e ndoqëm këtë thirrje dhe e vendosëm besëlidhjen (bej'atin) në dorën e Kalifit. Ne e shitëm veten për çmimin e identitetit tonë. Ne jemi muslimanë ahmedianë. Dhe nëse akoma pyesni veten se kush është një musliman ahmedian, më lejoni t'ju them:

Kush është një musliman ahmedian?

Musliman ahmedian është dikush që nuk u thotë "oh!" prindërve të tij kur të

kenë arritur pleqërinë, por kujdeset për ta. Ai kujdeset sepse në atë moment ai pasqyron cilësinë e Allahut "*Er-Rezzak*" (Furnizuesi).

Musliman ahmedian është ai që mund t'i shpëtojë një situatë duke gënjyer, por nuk e bën këtë dhe e thotë të vërtetën. E flet të vërtetën sepse në atë moment ai reflekton cilësinë e Allahut "*El-Hakk*" (i Vërteti).

Musliman ahmedian është ai që toleron hapat e gabuar të vëllezërve dhe motrave të tij me durim. Qëndron me durim sepse në atë moment ai pasqyron cilësinë e Allahut "*Es-Sabur*" (i Durueshmi).

Musliman ahmedian është ai që vihet në dijeni për mëkatet dhe veset e shokëve të tij, por i mbulon ato në vend që t'i zbulojë ato. Ai i mbulon ato sepse në atë moment reflekton cilësinë e Allahut "*Es-Sattar*" (Mbuluesi).

Musliman ahmedian është ai të cilit i është bërë padrejtësi dhe ka forcën për t'u hakmarrë, por falë për hir të përmirësimit. Ai falë sepse në atë moment pasqyron cilësinë e Allahut "*El-Afuw*" (Falësi).

Musliman ahmedian është ai që nuk refuzon një falje të sinqertë nga arroganca, por pranon pendimin. Ai pranon pendimin sepse në atë moment reflekton cilësinë e Allahut "*Et-Tevvab*" (Pendimpranuesi).

Allahu na mundësoftë që të ndjekim udhëzimet e Kalifit të Kohës (Allahu e ndihmoftë fuqimisht) dhe të ndjekim shembullin e Profetit të Shenjtë, Muhammedit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të). Le ta tërheqim kënaqësinë e Allahut tek ne duke u bërë imazhi i Tij dhe duke përmbushur kështu rolin e mëkëmbësit të tij në tokë, Amin!

SHËNIME:

[1] Kurani Famëllartë, Surja El-Bekare, 2:31.

[2] Kurani Famëllartë, Surja Ali 'Imran, 3:192.

[3] Kurani Famëllartë, Surja Et-Tin, 95:5.

[4] Kurani Famëllartë, Surja Sad, 38:72-75.

[5] Kurani Famëllartë, Surja El-A'raf, 7:173.

[6] <https://www.pressahmadiyya.com/press-releases/2021/09/head-of-ahmadiyya-muslim-community-concludes-42nd-lajna-imaillah-ijtema-uk-with-inspiring-address/>

[7] Kurani Famëllartë, Surja El-Ahzab, 33:22.

[8] Kurani Famëllartë, Surja El-Hashr, 59:20.

Rreth autorit:

Ahmad Kamal është misionar dhe teolog i Xhematit Musliman Ahmedia. Aktualisht, ai është kryetar i Organizatës së të Rinjve të Xhematit Musliman Ahmedia të Gjermanisë.



MENDIMI JUAJ ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR NE

Na shkruani komentet, mendimet dhe sugjerimet tuaja në WhatsApp, Viber ose Telegram në numrin

+355 69 4644 888

ose në email

vertetesia@gmail.com

VËRTETËSIA

KURANI DHE JETA JASHTËTOKËSORE

HAZRET MIRZA TAHIR AHMED

Vizioni i universit që paraqet Kurani është pole larg nga ai i mbajtur nga filozofët dhe të mençurit e të gjitha epokave të kaluara. Në kohën e shpalljes kuranore, astronomia greke ishte ajo që mbizotëronte në mendjet e njerëzve në të gjithë botën dhe të gjitha civilizimet dukeshin se ishin të ndikuara nga ajo. Ky dominim vazhdoi i pandërprerë deri në kohën e Kopernikut [Nicolaus Copernicus]. Ishte universalisht e pranuar që qiejt konsistonin nga shtresa mbi shtresa të përbëra nga disa materiale plastike transparente, të zbukuruar me trupa qiellorë të ndritshëm që ne i njohim si yje. Që të jemi më specifik, po japim në vijim njohurinë e përgjithshme të njerëzve që i përkisnin asaj epoke:

1. Toka ishte përbërë prej një mase pluhuri, shkëmbi, uji, ajri dhe minerale. Ajo ishte e palëvizshme, me një sipërfaqe pothuajse të sheshtë, dhe as që rrotullohej rreth vetvetes dhe as rreth ndonjë trupi tjetër qiellor.
2. Toka posedonte një pozicion unik në kozmos, ngjashmëria e të cilit nuk ekzistonte askund tjetër në hapësirë. Ajo qëndronte e palëvizur, e ankoruar në hapësirë, kurse trupat e tjerë qiellorë vazhdimisht rrotulloheshin rreth saj.

Sigurisht, ky koncept i universit eliminoi mundësinë e ekzistencës së jetës diku tjetër. Habitat i vetëm për jetën që

njerëzit e asaj kohe njihnin, ishte Toka, e veçuar në mes të hapësirës, sic ata e mendonin. Në kundërshtim me këtë, Kurani nuk e pranon as unikalitetin e Tokës dhe as të qenët e saj e palëvizshme. Për sa i përket çështjes së numrit të botëve, Kurani deklaron:

اللَّهُ الَّذِي خَلَقَ سَبْعَ سَمَاوَاتٍ وَمِنَ الْأَرْضِ مِثْلَهُنَّ

“Allahu është Ai që krijoi shtatë qiej dhe po aq (edhe) toka ...”¹

Është nevojshme që të shpjegohet këtu që numri “shtatë” mund të trajtohet si një term specifik i Kuranit në këtë ajet dhe në shumë ajete të tjera të ngjashme. Si i tillë do të thotë që universi përfshin shumë njësi qiejsh, secili i ndarë në grupe me shtatë (një numër perfekt), secili prej tyre ka të paktën një tokë në të, e cila mbështetet nga i gjithë sistemi i atij qielli (galaktike). Referuar këtij sistemi në përgjithësi, një ajet më specifik mbi ekzistencën e jetës jashtëtokësore vazhdon si më poshtë:

وَمِنْ آيَاتِهِ خَلْقُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَا بَيْنَهُمَا مِنْ دَابَّةٍ

“Ndër shenjat e Tij është edhe krijimi i qiejve dhe i tokës, si dhe gjithçka prej gjallesave [*dābbeh*] që Ai përhapi në to ...”²

Fjala arabe *dābbeh* mbulon të gjitha kafshët që zvarriten ose lëvizin përgjatë sipërfaqes së tokës. Nuk aplikohet për kafshët që fluturojnë ose notojnë. Kjo, pa dyshim, nuk i referohet ndonjë

forme të jetës shpirtërore. Në arabisht një fantazme apo hije nuk mund t'i referohemi kurrë si *dābbēh*, dhe as ndonjë engjëlli. Pjesa e dytë e të njëjtit ajet flet jo vetëm për mundësinë e jetës jashtëtokësore, por kategorikisht deklaron se ajo ekziston – një pohim të cilin edhe studiuesit shkencorë më modernë nuk kanë qenë në gjendje ta bëjnë deri më tani me ndonjë metodë të sigurt. Sidoqoftë, kjo nuk është gjithçka që zbulon ky ajet. Mrekullia dhe habia shtohet kur lexojmë në fund të këtij ajeti, se Ai (Allahu) do të bashkojë jetën që gjendet në trupa të tjerë qiellorë dhe jetën tokësore kur Ai të dëshirojë:

وَهُوَ عَلَىٰ جَمْعِهِمْ إِذَا يَشَاءُ قَدِيرٌ ﴿٦﴾

“... dhe për bashkimin e tyre [xhem’ihim] Ai është i Plotfuqishëm kur të dojë.”³

Fjala xhem’ihim është shprehja arabe në këtë ajet që flet specifikisht për bashkimin e jetës në tokë dhe jetën tjetërkund. Se kur do të zhvillohet ky takim i të dyve nuk është caktuar, as nuk përmendet nëse do të ndodhë këtu në tokë apo gjetkë. Megjithatë një gjë është e shpallur pa dyshim: kjo ngjarje me siguri do të ndodhë kur të dëshirojë Zoti. Duhet mbajtur në mendje se fjala xhem’ihim mund të nënkuptojë ose një kontakt fizik ose një kontakt përmes komunikimit. Vetëm e ardhmja do të tregojë se si dhe kur do të zhvillohet ky kontakt, por vetë fakti që para 1400 vitesh

një mundësi e tillë ishte parashikuar, është një mrekulli në vetvete.

Kjo zbulesë e Kuranit u bë në një kohë kur kozmologjia si shkencë nuk kishte lindur akoma. Mbizotëronte një epokë tjetër e vizualizimit hipotetik, e cila duhej të bënte një rrugë shumë të gjatë, përpara se të mendonte ekzistencën e jetës jashtëtokësore. Edhe sot pretendime të tilla gjenden vetëm në trillime shkencore.

Shkencëtarët ende nuk kanë qenë të aftë të shkundin plotësisht skepticizmin e tyre të hershëm në lidhje me ekzistencën e jetës në hapësirë. Asnjë provë përfundimtare nuk është zbuluar ende në mbështetje të saj. Shkencëtarët ende flasin vetëm për ‘shanse’.

Profesori Archibald Roy i Universitetit të Glasgow është një nga shumë entuziastët e spikatur, i angazhuar thellësisht për të hetuar në mundësitë e formave inteligjente të jetës në trupat qiellorë. Ai shkruan:

“Në konferenca të ndryshme ndërkombëtare mbi problemin e jetës jashtëtokësore, çështja është diskutuar dhe është bërë e qartë se jo vetëm që ekziston mundësia të pranohet që një sinjal është me origjinë inteligjente, por gjithashtu do të jetë e mundur të hyjmë në komunikim me specie inteligjente dhe të shkëmbejmë informacion.”⁴

Jo të gjithë ndajnë entuziazmin e profesorit Roy mbi këtë temë. Dr Frank Tipler nga Universiteti Tulane, New Orleans, mund të llogaritet midis skeptikëve. Ai e bazon pesimizmin e tij në llogaritjet matematikore. Sipas tij, shfaqja e qenieve inteligjente diku tjetër në univers përmes proceseve të verbra të evolucionit material bie ndesh me ligjin e numrave të mëdhenj. Evolucion i jetës këtu në tokë është dilemë e mjaftueshme për ta zgjidhur shkencëtarët. Dhe që ai të përsëritet vetvetiu përmes një kolapsi tjetër të një numri kaq të madh shansesh, që sfidojnë llogaritjet njerëzore, është një pamundësi matematikore. Dr. Tipler deklaron:

“... inteligjencat jashtëtokësore nuk janë këtu. Ne thjesht duhet ta interpretojmë këtë fakt. Shumica e astronomëve përqafojnë një besim në inteligjencën jashtëtokësore kundër provave për shkak të një parimi filozofik: ideja kopernikane që planeti ynë në kozmos duhet të jetë plotësisht tipik. Por ne e dimë që kjo ide është e gabuar. Universi po evoluon: rrezatimi kozmik tregon se dikur ishte një kohë kur nuk ekzistonte asnjë lloj jetë sepse ishte shumë nxehtë. Si rrjedhim, vendi ynë është jotipik në kohë. Në veçanti duhet të ketë një civilizim të parë, dhe ndodh që të jetë i yni.”⁵

Dr Tony Martin, ish nënkryetar i Shoqatës Britanike Ndërplanetare, ka pikëpamje skeptike të ngjashme.

Megjithatë, përkundër gjithë këtij kundërshtimi, ëndrra shkencore e Dr. Roy duket, të paktën pjesërisht, t’i jetë afruar realizimit. Në Shtetet e Bashkuara, NASA tashmë ka siguruar miratimin e qeverisë për një kërkim të madh për sa i përket inteligjencës jashtëtokësore. Shkencëtarë të tjerë me famë ndërkombëtare si Profesor Sagan, janë gjithashtu mbështetës të fortë të kësaj kauze.⁶

A nuk është e habitshme ajo çfarë Kurani pohoi si fakt, rreth 1400 vite më përpara, që sapo ka filluar të shfaqet si një realitet i mundshëm për shkencëtarët e sotëm! Kurani shkon një hap më tej kur parashikon se njeriu një ditë do të bëjë kontakt me jetën jashtëtokësore.

Koha për realizimin e plotë të kësaj profecie ende nuk ka mbërritur, por shenjat e saj po shfaqen në horizont. Kjo vërteton se profecitë e Kuranit shkojnë përpara zhvillimit shkencor të njeriut.

Çdo epokë e re dëshmon përmbushjen e disa zbulesave të tjera, të cilat epokat e mëparshme nuk kishin mjete për t’i dëshmuar. Prandaj duhet të kuptohet qartë këtu se profecitë kuranore janë krejtësisht të ndryshme në natyrë nga ato të nënkuptuara në trillime shkencore.

Asnjëherë nuk ka qenë e pazakontë që fantazia njerëzore të marrë një fluturim nga trampolina e fakteve të njohura të

natyrës, në drejtim të gjërave që do të jenë në të ardhmen. Por rrallëherë e ardhmja ka vërtetuar parashikimet e këtyre fluturimeve imagjinare. Madje, të gjitha trillimet e tilla, mbeten të kufizuara deri në masën që konsiderohet e mundshme sipas dijes së kohës. Shkrimtarët e trillimeve gjithmonë marrin sugjerime nga njohuritë e tanishme për të parashikuar atë që mund të dalë nesër. Megjithatë më shpesh, realiteti shfaqet krejt ndryshe nga supozimet e tyre “çmendurake”. E ardhmja siç është e caktuar, nuk ndjek diktatet e vizionit të tyre. Kjo mund të çojë vetëm në përfundimin e pashmangshëm se ushtrimi i imagjinatës njerëzore në lidhje me të panjohurën ka limitet e saj.

Për të ilustruar limitet e e shtrirjes së imagjinatave të njeriut, të çdo epoke përkatëse, gjeniu Leonardo da Vinci mund të citohet si një shembull i përshtatshëm. Ai u përpoq të parashikonte mundësinë e fluturimit të njeriut, por arriti ta konceptonte atë vetëm në lidhje me njohuritë e atëhershme që kishte në dispozicion. Shkenca dhe teknologjia nuk kishin përparuar deri atëherë, në një fazë ku mendja e njeriut të mund të parashikonte imazhin e njeriut duke fluturuar me ndihmën e makinerive të drejtuara nga zjarri. Kështu, për të parashikuar madje edhe një aeroplan bazik shtrihet përtej kufijve të potencialit të Leonardos.

Rasti i shkrimeve hyjnore, megjithatë, është një çështje krejtësisht tjetër dhe dija e shprehur në to nuk mund të kufizohet në ndonjë epokë të veçantë. Për më tepër, shansi nuk ka asnjë rol për të luajtur në përmbushjen e tyre. Zbulimet shkencore të epokave pasuese nuk kanë vërtetuar ndonjë profeci kuranore të jetë e gabuar.

Prandaj, ne duhet të vështrojmë përpara me shpresë të shëndoshë për realizimin edhe të profecive të tilla si të tjerat, në pritje të së ardhmes për të vendosur. Profecia për takimin e jetës këtu dhe jetës diku tjetër i përket së njëjtës kategorie, e cila mbetet akoma e paplotësuar. Shpresoj që të jetojmë mjaftueshëm gjatë për të dëshmuar ditën e lavdishme kur jeta në tokë do të krijojë “një lloj shkëmbimi” me jetën në hapësirë.

SHËNIME

[1] Kurani Famëlartë 65:13.

[2] Kurani Famëlartë 42:30.

[3] Kurani Famëlartë 42:30.

[4] ROY, A. E., CLARKE, D. (1989) Astronomy: Structure of the Universe. Adam Hilger Ltd., Bristol, fq. 270.

[5] TIPLER, F. (November, 1991) Alien Life. Nature: 354:334–335.

[6] Mc KIE, R. (September, 1985) Calling Outer king

Bashkëpunimi

Profeti ^{s.a.v.s.} gjithmonë i këshillonte sahabët r.a. e tij të bashkëpunonin me njëri-tjetrin. Kështu, ai kishte vendosur një rregull për xhematin e tij që nëse ndokush prej sahabëve bënte ndonjë shkelje, e cila i sillte gjobë dhe ai nuk do të kishte mundësi ta paguante gjobën, atëherë banorët e lagjes, apo të qytetit apo të kombit të tij, bashkërisht do t’ia shlyenin gjobën.

Disa njerëz që i vinin për t’i shërbyer fesë, Profeti ^{s.a.v.s.} këshillonte të afërmit e tyre t’ua përballonin shpenzimet dhe të kujdeseshin për nevojat e tyre. Enesi ^{r.a.} rrëfen që gjatë kohës së të Dërguarit të Allahut ^{s.a.v.s.} dy njerëz, që ishin vëllezër, u bënë muslimanë. Njëri prej tyre filloi të qëndronte pranë Profetit ^{s.a.v.s.} dhe tjetri merrej me zanatin e tij. Ky i dyti, një ditë, iu ankua të Dërguarit të Allahut ^{s.a.v.s.} për të vëllanë duke thënë se ai rrinte kot dhe nuk bënte asnjë punë. I Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} tha:

“Mos thuaj kështu. Zoti i Lartësuar falë atij të furnizon me risk, ndaj, shërbeji dhe lëre të lirë që të punojë për fenë”.¹

Një herë, i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} bashkë me sahabët e tij ishte në një udhëtim. Pasi udhëtuan gjithë ditën, u ndalën në një vend për të kaluar natën. Sahabët filluan të hapnin tendat dhe të bënë punë të tjera të nevojshme për qëndrim. Të gjithë i ndanë detyrat midis njëri-tjetrit, por të Dërguarin e Allahut ^{s.a.v.s.} nuk e ngarkuan me ndonjë detyrë. Ai tha pse s’i kishin dhënë ndonjë punë dhe pastaj vetë tha që do të mblidhte drunjtë për të gatuar ushqim. Sahabët i thanë: “O i Dërguari i Allahut, jemi këtu për të punuar, nuk keni nevojë të shqetësoheni”, por ai u tha: “Në asnjë mënyrë jo. Edhe unë kam për detyrë të kontribuoj”. Kështu që ai mblodhi dru nga pylli, që sahabët ^{r.a.} të gatuanin ushqim.²

SHËNIME

[1] *Tirmidhiu*, Kitabuz-zuhd, bab fi tevekuli elellah.

[2] *Zerkani*, vëll. IV, f. 265.

*Pse mbajnë shaminë
gratë muslimane?*

HADAYATULLAH HÜBSCH

të tyre, ose vëllezërve apo djemve të vëllezërve të tyre, ose djemve të motrave a grave të tyre, ose atyre që i kanë nën zotërim, ose shërbëtorëve meshkuj që nuk kanë dëshirë epshore ose fëmijëve që nuk dinë për pjesët intime të femrave. Le të mos i rrahin këmbët (për tokë), në mënyrë që të zbulohen stolitë e tyre të fshehta. O besimtarë, kthehuni të gjithë tek Allahu duke u penduar, që të arrini shpëtimin!³

Nganjëherë thuhet që ky ajet u tërheq vëmendjen grave muslimane që t'i shmangen vesit të shfaqjes së pjesës së kraharorit, por në të njëjtën sure, lexojmë edhe këtë porosi:

وَالْقَوَاعِدُ مِنَ النِّسَاءِ اللَّاتِي لَا يَرْجُونَ نِكَاحًا فَلَيْسَ عَلَيْهِنَّ جُنَاحٌ أَنْ يَضَعْنَ
ثِيَابَهُنَّ غَيْرَ مُتَبَرِّجَاتٍ بِزِينَةٍ وَأَنْ يَسْتَغْفِرْنَ خَيْرٌ لَّهُنَّ وَاللَّهُ سَمِيعٌ عَلِيمٌ

“Gratë e vjetra, që nuk shpresojnë më të martohen, nuk është gjynah ta heqin mbulesën e jashtme, por jo duke i treguar stolitë e tyre. E, nëse përmbahen, është edhe më mirë për ato. Allahu i dëgjon dhe i di të gjitha”.⁴

Lejimi i heqjes së mbulesës së jashtme për gratë e moshuara, nuk duhet përdorur si pretekst që ato të dalin kokëzbuluar. Së dyti, në ajetin e sipërm, është porositur shprehimisht që gratë muslimane “të mos shfaqin bukurinë dhe stolitë e tyre, përveç atyre që shfaqen në mënyrë të vetvetishme”. Kjo tregon qartë se gratë muslimane nuk duhet të ndihen

të penguar apo të paafta në punën e tyre të përditshme dhe të kontribuojnë denjësisht në zhvillimin e shoqërisë dhe vendit.

Megjithatë, është pyetur disa herë: Përse vetëm gratë muslimane duhet të jenë të kufizuara në aspektin e veshjeve, dhe përse duhet të jenë vetëm ato që mbulohen për t'iu shmangur shikimeve epshore e të papërgjegjshme të meshkujve? A nuk duhet të ishin meshkujt, të cilët duhet të frenonin shikimin e tyre? Po kështu anasjelltas, a mund të themi që nuk ka gra që i kundrojnë meshkujt e tjerë me joshje? Përse të mos mbulohen edhe meshkujt me shami?

Në të vërtetë, Kurani duke përshkruar tiparet e një shoqërie hyjnore, u drejtohet fillimisht meshkujve besimtarë që të ulin shikimin e tyre ndaj grave të huaja. Sipas tij, besimtarët muslimanë nuk duhet të vështrojnë të ndaluarat, kategori kjo që përfshin edhe grat e huaja. Ata duhet të sillen me modesti, druajtje e vetëpërmbajtje dhe të kalojnë një jetë të moralshme. Islami nuk u jep meshkujve kompetencë për të imponuar urdhrin e mbulesës mbi gratë, por i porosit për t'i përmbajtur sytë e tyre.

Disa njerëz, duke shprehur pakënaqësinë e tyre, pyesin që përse u është dashur grave muslimane të heqin dorë nga liria e tyre, për të vetmen arsye që disa meshkuj

të pafytyrë sillen me to në mënyrë fyese. Përse u mohohen të drejtat e tyre, vetëm se disa meshkuj mund t'i manipulojnë ato? Me të vërtetë, po të silleshin njerëzit ashtu siç duhet, nuk do të nevojiteshin as shami, as hixhab e as masa të tjera mbrojtëse. Por, fatkeqësisht në këtë kohë, sjellja e shumë njerëzve nuk është gjithmonë në shkallën e dëshirueshme. Përderisa, nuk është kaq e lehtë për të larguar babëzinë e grykësinë nga kjo botë materiale, shoqëria muslimane në tërësi duhet të ndërmarrë masat e nevojshme në aspektin e parandalimit të stimuljeve që nxisin shthurjen dhe përmbysjen e jetës shoqërore në baza morale. Këto masa synojnë të parandalojnë pasojat që rezultojnë nga mungesa e kontrollit mbi instinktet joshëse.

Cilat janë këto masa? Në Kuranin Famëllartë ne gjejmë këto udhëzime:

قُلْ لِلْمُؤْمِنِينَ يَغُضُّوا مِنْ أَبْصَارِهِمْ وَيَحْفَظُوا فُرُوجَهُمْ ذَٰلِكَ أَزْكَىٰ لَهُمْ إِنَّ اللَّهَ
خَبِيرٌ بِمَا يَصْنَعُونَ

“Thuaju besimtarëve që të ulin shikimet e tyre dhe t'i ruajnë pjesët e tyre intime! Kjo është mënyra më e dëlirë për ta, dhe Allahu është i Dijshëm për çka bëjnë ata”.⁵

وَلَا تَقْرَبُوا الزَّوْجَ إِنَّهُ كَانَ فَاحِشَةً وَسَاءَ سَبِيلًا

“Dhe mos iu afroni kurvërisë, se me të vërtetë ajo është shthurje morale dhe një rrugë e shëmtuar”.⁶

وَالْحَافِظِينَ فُرُوجَهُمْ وَالْحَافِظَاتِ وَالذَّاكِرِينَ اللَّهَ كَثِيرًا وَالذَّاكِرَاتِ أَعَدَّ اللَّهُ لَهُمْ
مَغْفِرَةً وَأَجْرًا عَظِيمًا

“Me të Vërtetë, Allahu ka përgatitur falje dhe shpërblim të madh ... për meshkujt që i ruajnë pjesët e tyre intime dhe gratë që i ruajnë pjesët e tyre intime”.⁷

Megjithatë, në mesin e muslimanëve ekziston një pakicë njerëzish, e cila duke qenë e dobët dhe e cenueshme, nuk arrin dot të mposhtë instinktet e saj. Ka edhe të këtillë “që dëshirat e veta i kanë bërë zot”⁸ dhe kështu duke mos iu përgjigjur udhëzimeve hyjnore, ata zbrazen edhe nga vlerat morale.

Profeti Muhammed s.a.v.s. ka thënë:

عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: “صَفَانِ مِنْ أَهْلِ
النَّارِ لَمْ أَرُهَا قَوْمٌ مَعَهُمْ سَيَاطِرُ كَاذِبَاتِ الْبَقَرِ يَضْرِبُونَ بِهَا النَّاسَ وَنِسَاءُ
كَاسِيَاتٍ غَارِيَّاتٍ مُمِيلَاتٍ مَايَلَاتِ زُفُوفُهُنَّ كَأَسْمَةِ الْبُحْتِ الْعَائِلَةِ لَا
يَدْخُلْنَ الْجَنَّةَ وَلَا يَجِدْنَ رِجْلَهَا وَإِنْ رِجْلَهَا لَتُوجَدَ مِنْ مَسِيرَةِ كَذَا وَكَذَا”.

“Ndër banorët e xhehenemit, ka lloje njerëzish që ende nuk i kam parë. Burra me kamxhik si bishtat e lopëve me të cilat ata i rrahin njerëzit (d.m.th. udhëheqës tiranë) dhe gra që janë të veshura por të zhveshura, të joshura (në rrugën e gabuar) dhe bëjnë që njerëzit të joshen pas tyre, flokët e tyre janë si pjerrtësia e gungave të devesë. Ato nuk do të hyjnë në Xhenet, e as nuk do ta nuhasin aromën e tij edhe pse ajo kundërmon në largësi të mëdha”.⁹

Mbulesa dhe veshja dinjitoze e një

gruaje muslimane rrezaton modestinë, por edhe krenarinë për identitetin e saj, duke i paralajmëruar meshkujt që pushtohen nga dëshira të shfrenuara, të sillen në mënyrë më të përgjegjshme ndaj tyre.

Urdhri i Kuranit Famëlartë lidhur me mbulimin e flokëve dhe vënien e hixhabit për gruan muslimane, është një shprehje dhe formë e vetëmbrojtjes së saj. Duke iu bindur kësaj porosit kuranore, ajo jep një mesazh të qartë se i nënshtrohet plotësisht dëshirës së Zotit, dhe mbivendos vullnetin e Tij mbi çdo dëshirë apo interes të saj që lidhet me jetën e kësaj bote. Përmes paraqitjes së saj të jashtme, ajo demonstroi se është e gatshme për të sakrifikuar çdo kënaqësi materiale, për të arritur sjelljen e lartë morale dhe ngritjen në gjendjen shpirtërore.

Ajo është e vetëdijshme, që dashuria e vërtetë kërkon sakrificë të mëdha. Në këtë mënyrë, duke shfaqur nënshtimin e saj ndaj Zotit dhe besnikërisë ndaj bashkëshortit, ajo dëshmon se nuk ka kurrfarë interesi për meshkujt e huaj. Duke qenë e moralshme dhe besnike ndaj fesë së saj, ndonëse ajo privon veten nga përvojat dhe aventurat e lidhjeve të shfrenuara të një jete të shthurur, ajo fiton një kënaqësi të thellë dhe gjen lumturinë që nuk mund të përjetohet kurrë në lidhje të paligjshme.

Përpos kësaj, mënyra e të veshurit në publik, ia forcon ndjesinë e modestisë dhe përlësisë, dhe fuqizon lidhjen dhe sjelljen e saj të singertë brenda familjes. Kjo i ngjall vetëdije dhe i forcon dinjitetin e vetëbesim.

Ajo nuk humbet më kohë duke u marrë aq shumë me rregullimin e vetes në mënyrë estetike, për t'u bërë sa më joshëse, që t'i tërheqë edhe ata sy të shfrenuar e të papërgjegjshëm, që gjejnë ëndje në bukurinë e saj të jashtme. Prandaj shfaqja publike e një vajze muslimane në veshje modeste e dinjitoze, nuk është simboli i shtypjes apo nënshtimit, por një shprehje e qartë e dinjitetit dhe vullnetit të saj.

Ne po jetojmë në një kohë, në të cilën njeriu në kërkim të kënaqësisë, po nëpërkëmb e përmbys të gjitha normat morale e shoqërore. Prandaj, duhet të ekzistojë doemos kufiri midis ndershmërisë e pandershmërisë, turpiti dhe paturpësisë, normave morale e shthurjes etj. Islami e bën këtë vijë ndarëse qartësisht të dalluar, duke shquar kufirin e pikënisjes së joshjes nga kufiri aktual i “joshjes” i cili është gjithçka që bie në sy.

Hixhabi ose shamia, nuk janë vetëm masa mbrojtëse për t'iu shmangur imoralitetit, që mund të burojnë nga të tjerët, por edhe si një nxitje, që një muslimane duhet të përqendrojë përpjekjet e saj për të arritur

dëlrësinë, dhe duhet të distancohet nga çdo mendim a veprim, që mund ta devijojë nga kjo objektivë.

Mbulesa dhe shamia janë gjithashtu kundërmasat e një vajze muslimane për të mbrojtur nderin dhe dinjitetin e saj. Ajo e bën të qartë se nuk dëshiron të jetë objekt i kënaqësisë së meshkujve të paskrupullt dhe assesi nuk është e disponueshme për t'u plotësuar nevojat e tyre epshore.

Sipas Kuranit Famëlartë, gratë muslimane nuk kanë të drejtë vetëm për të mbrojtur nderin dhe dinjitetin e tyre, por Islami jep udhëzime të hollësishme që u nevojiten për të ndërtuar karakterin dhe për të zhvilluar aftësitë e tyre.

Si duhet të jetë veshja e besimtarëve?

Megjithatë, një pyetje akoma ka nevojë për t'u sqaruar. A duhet të jenë vetëm gratë muslimane ato të cilat duhet t'i mbulojnë pjesët e trupit apo edhe meshkujt muslimanë? Veshjet e meshkujve duhet t'u mbulojnë pjesët intime e nuk duhet të jenë të ngushta, që tregojnë formën e pjesëve intime. Nuk pëlqehet që veshjet e burrave t'u ngjajnë atyre të grave dhe të krijojnë ngjashmëri midis dy gjinive.¹⁰ Hazret Profeti Muhammed ^{s.a.v.s.} ka porositur që muslimanët duhen t'u shmangen veshjeve ekstravagante e nuk duhet të sillen me mendjemadhësi.¹¹ Prandaj

është ndaluar veshja e floririt dhe mëndafshit për burrat muslimanë.¹² Ai mbante një çallmë (*Amama*) në kokë.¹³ Profeti ^{s.a.v.s.} ka thënë: Meshkujt duhet të vishen me rroba normale që ua mbulojnë pjesët e trupit dhe t'i mbulojnë flokët kur të dalin jashtë shtëpisë. Ai personalisht mbante çallmë në kokë.¹⁴ Të gjitha shkollat e jurisprudencës Islame pranojnë unanimisht që mbulimi i kokës veçanërisht gjatë namazit është një praktikë e pëlqyeshme (مستحب). Kjo është arsyeja që meshkujt muslimanë kur dalin në publik shpesh e mbulojnë kokën me kapuç apo me diçka tjetër.

Pritet që çdo musliman qoftë mashkull apo femër t'u nënshtrohet vullnetarisht mësimave të Islamit. Në Kuranin Famëlartë, Zoti deklaron:

فَمَنْ شَاءَ فَلْيُؤْمِرْ وَمَنْ شَاءَ فَلْيُكْفُرْ¹⁵

“E vërteta është ajo që vjen prej Zotit tuaj. Kush të dojë le t'i bindet, dhe kush të dojë le ta mohojë atë”.¹⁵

لَا إِكْرَاهَ فِي الدِّينِ¹⁶

“Nuk ka imponim në fe”.¹⁶ Allahu tregon rëndësinë e ndjekjes së rrugës së Profetit ^{s.a.v.s.} duke thënë:

فَلْ إِنْ كُنْتُمْ تُحِبُّونَ اللَّهَ فَاتَّبِعُونِي يُحْبِبْكُمُ اللَّهُ وَيَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ¹⁷

“Thuaj (o Muhammed)! Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua. Kështu edhe Allahu do t'ju dojë dhe do t'ju

falë gjynahet”.¹⁷

لَقَدْ كَانَ لَكُمْ فِي رَسُولِ اللَّهِ أُسْوَةٌ حَسَنَةٌ لِمَن كَانَ يَرْجُو اللَّهَ وَالْيَوْمَ الْآخِرَ
وَذَكَرَ اللَّهَ كَذِكْرًا

“Vërtet, ka një model të shkëlqyer në të Dërguarin e Allahut për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e kujton shpesh Allahun”.¹⁸

Muslimanët, si burri ashtu gruaja, nuk duhet të veshin rroba, që janë tejet tërheqëse e ekspozuese, të cilat në vend të mbulojnë tiparet fizike të bukurisë, i zbulojnë ato në mënyrën më provokuese. Veshjet e tilla shërbejnë vetëm për të vënë në sy, për të tunduar ndjenjat erotike dhe për të nxitur rrjedhimisht “kërkesat e padëshirueshme”.

Mbulesa nuk është shprehja e ekstremizmit e as demonstrimi i aspiratave politike për të arritur pushtet. Mbulesa shërben si një mjet për t’iu shmangur dëshirave epshore dhe për t’u mbrojtur nga instinktet e ulëta. Ajo është element i qenësishëm i etikës islame dhe një ndër dispozitat jetike të edukimit të moralshëm.

Dispozita e hixhabit ndihmon në ruajtjen e dëlirësisë së jashtme dhe të brendshme, dhe u jep një mesazh të qartë të tjerëve se kjo vajzë nuk simpatizon apo toleron sjellje imorale a të pahijshme. Mbulesa është pjesë integrale e mësimave islame, dhe nuk është e mundur që muslimanët

të ndryshojnë apo të shfuqizojnë një dispozitë të tillë, për të cilën gjejmë udhëzime të qarta në Kuran dhe në praktikën profetike.

SHËNIME

[1] Kurani Famëlartë 33:60

[2] Si më sipër

[3] Kurani Famëlartë 24:32

[4] Kurani Famëlartë 24:61

[5] Kurani Famëlartë 24:31

[6] Kurani Famëlartë 17:33

[7] Kurani Famëlartë 33:36

[8] Kurani Famëlartë 45:24

[9] *Sahih el-Muslim, Kitabul Xheneti ve Sifetu Ne'imiba, ve ehlilha*, Bab: *en-Naru jedkbuluhel-Xhebār-Ūna vel-Xhenetu jedkbuluhed-Du'afāu*, hadith numër 2128b

[10] عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ لَعَنَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ الرَّجُلَ يَلْبَسُ لِبْسَةَ الْمَرْأَةِ [Sunen Ebu Daudi, Kitabul-Libās, Bāb: *Libāsin-Nisāi*, nr. i hadithit 4098

[11] قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ "كُلُوا وَتَصَدَّقُوا وَابْتَشُوا فِي غَيْرِ إِسْرَافٍ وَلَا مَخِيلَةٍ" [Sunen En-Nisai, Kitab: ez-Zekāt, Bāb: *el-Ikhtijālu fis-Sadakati*, nr. i hadithit 2559

[12] عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ زُرَّارٍ الْقَافِي، سَمِعْتُهُ يَقُولُ سَمِعْتُ عَلِيَّ بْنَ أَبِي طَالِبٍ، يَقُولُ أَخَذَ رَسُولُ اللَّهِ - صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ - خَيْرًا مِنْ مَالِهِ وَذَهَبًا يَتِيمِيهِ ثُمَّ رَفَعَ يَدَيْهِ فَقَالَ "إِنَّ هَذَيْنِ خَرَامٌ عَلَى ذِكْرِ أُمَّي جُلِّ لَتَائِهِمْ" .

Ibn Maxhe, Kitabul-Libās, Bāb: *Lubsil-Hariri vedh-Dhebebi lin-Nisāi*, nr. i hadithit 3595

[13] عَنْ جَابِرٍ، أَنَّ النَّبِيَّ - صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ - دَخَلَ مَكَّةَ وَعَلَيْهِ عِمَامَةٌ سَوْدَاءُ [Ibni Maxha, Kitabul-Libās, nr. i hadithit 3585

[14] Rijadus Salihin, libri 4, nr. i hadithit 784

[15] Kurani Famëlartë 18:30

[16] Kurani Famëlartë 2:257

[17] Kurani Famëlartë 3:32

[18] Kurani Famëlartë 33:22

Si u mblodh Kurani i Madhërishëm? (Historiku i shkurtër)

Kurani i Madhërishëm është libri shynor që Zoti ia zbriti Profetit Muhammed^{s.a.v.s.}. Zbritja e Kuranit vijoi përgjatë 23 vitesh, në Mekë dhe në Medinë. Renditja e Kuranit gjatë zbritjes ishte e ndryshme nga renditja e tij siç e shohim sot, pasi ajetet dhe suret zbrisnin sipas dinamikës së ngjarjeve që ndodhnin gjatë këtyre 23 viteve. Kurse renditja në formë libri është bërë në formë temash, dhe edhe kjo renditje është bërë gjatë jetës së Profetit Muhammed^{s.a.v.s.} me Vullnetin e Zotit të Madhërishëm.

I Dërguari i Allahut^{s.a.v.s.} kishte marrë shpallje nga Allahu për të ruajtur Kuranin, dhe ai ua diktoi atë sahabëve dhe i renditi suret. Hazret Ebu Bekri^{r.a.} gjatë kalifatit të tij, e mblodhi atë tekst dhe e ruajti në një libër nëpërmjet Hazret Zejd bin Thabitit^{r.a.}, i cili ka qenë një ndër shkruarit e Kuranit. Përfundimisht Hazret Osmani^{r.a.} gjatë kalifatit të tij, përgatiti disa kopje të atij teksti dhe i dërgoi në vendet muslimane dhe kështu e përhapi Kuranin Famëlartë në të gjithë botën dhe është po ai Kuran që kemi ne sot.

Cili është premtimi që bëri Allahu xh.sh. për ruajtjen e Kuranit Famëlartë?

Allahu i Madhërishëm ka thënë:

إِنَّا نَحْنُ نَزَّلْنَا الذِّكْرَ وَإِنَّا لَهُ لَحَافِظُونَ

“Sigurisht ne e kemi shpallur Kuranin dhe sigurisht ne do ta ruajmë atë”. [Surja El-Hixhr 15:10]

Cilat janë dy suret e para dhe të fundit të Kuranit?

Dy suret e para të Kuranit janë El-Fatiha dhe El-Bekare ndërsa dy të fundit janë El-Felek dhe En-Nas.

Cila është surja më e gjatë dhe cila është surja më e shkurtër e Kuranit?

Surja më e gjatë e Kuranit është El-Bekare ndërsa surja më e shkurtër është El-Keuther.

Sipas kohës së shpalljes, cili është ajeti i parë?

Ajeti i parë është:

اَفْرَأْ بِاسْمِ رَبِّكَ الَّذِي خَلَقَ

“Lexo me emrin e Zotit tënd, që krijoi”. [Surja El-Alak 96:2]



Roli i Kalifatit në vendosjen e paqes botërore

ABDULLAH UWE WAGISHAUSER



Në po jetojmë në një kohë të çuditshme, të mbushur me kontradikta e konflikte, në një botë ku përveç disa përjashtimeve, feja është kthyer në tregti. Politika, në vend që t'i shërbejë popullit, është shndërruar në një vegël në shërbim të oligarkisë. Po jetojmë në një botë, ku dituria nuk shërben për të ndriçuar ndërgjegjen, por për të siguruar një vend pune të mirë, me një pagë të majme. Kjo është një botë, në të cilën një person që mohon ekzistencën e Zotit në bazë të disa teorive shkencore a filozofike, konsiderohet më i ndritur dhe më i emancipuar. Është një botë ku miliona njerëz dalin në protestë duke kërkuar barazinë gjinore, të drejtat e kafshëve dhe kundër ndryshimeve klimatike, ndërsa luftërat civile, konfliktet e përgjakshme, varfëria, mungesa e ujit të pijshëm, uria dhe shëndetësia, nuk përbëjnë më lajmet kryesore në media.

Shtetet po bombardohen njëri pas tjetrit dhe këto plane shkatërruese, që paraqiten si përpjekje për vendosjen e paqes, i kanë kthyer qytetet e vendbanimet në gërmadha dhe grumbull rrënojash. Fëmijë të panumërt kanë mbetur jetimë e shumë gra vejusha, megjithatë kjo ndërhyrje vijon të quhet “mision i ndihmës dhe mbështetjes”.

Situata paradoksale

Me të vërtetë po jetojmë në një botë përplot kontradikta. Shtypi, mediat elektronike dhe mjetet sociale kanë në dorë një shkop magjik me anë të të cilit shtypësi shtiret si i shtypur dhe viktima paraqitet si agresor. Ata u hedhin hi syve spektatorëve, ashtu siç bënin magjistarët e kohës së Musait ^{a.s.}. Allahu i Plotfuqishëm thotë në suren el-Araf:

قَالَ أَتَوَا فَلَمَّا أَتَوْا سَخِرُوا لَأُعْزِزَ الْتَائِبِينَ وَأَسْخَرَهُمْ وَجَاءُوا بِسِحْرِ عَظِيمٍ

Musai iu përgjigj (magjistarëve) “Hidhni ju”. Dhe kur (magjistarët) i hodhën (shkopinjtë e tyre), i magjepsën sytë e spektatorëve dhe u kallën frikën, dhe sollën një magji të madhe.¹

Plani i Zotit për një ndërmarrje shpirtërore

Pikërisht në kohëra të tilla të errëta, Zoti, botëzotërues dhe Krijuesi i gjithësisë, Hirploti e Mirëbërësi, i veçon robërit e Tij të zgjedhur për të dalluar të vërtetën nga gënjeshtria, të mirën nga e keqja dhe të drejtën nga e shtrembra. Këta të dërguar të Zotit vijnë me qëllimin e lartë për të çrrënjësuar të keqen dhe padrejtësinë nga shoqëria.

Përmes tyre, Zoti poshtëron çdo

shtypës arrogant dhe të shtypurit i bën triumfues duke u kthyer të drejtat e tyre të mohuara. Me urdhrin e Zotit, profetët themelojnë një mbretëri shpirtërore në tokë. Kjo fuqi hyjnore u shfaq në kohën e Musait ^{a.s.} kur magjistarët e Faraonit e sfiduan për ballafaqim. Zoti iu drejtua Musait ^{a.s.} dhe i tha:

وَأَوْحَيْنَا إِلَى مُوسَى أَنْ أَلْقِ عَصَاكَ فَإِذَا هِيَ تَلْقَفُ مَا يَأْفِكُونَ
فَوَقَعَ الْحَقُّ وَبَطَلَ مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ

Dhe ne i shpallëm Musait: “Hidhe shkopin tënd!” – (Vërejeni), ai menjëherë filloi të gëlltiste gjithçka që po trillonin ata. Pra, e vërteta doli në shesh dhe dështoi ajo që bënin ata.²

Kalifati – çelësi i ripërtëritjes dhe bashkimit

Këta njerëz të cilët Zoti i zgjodhi për të vendosur paqe dhe harmoni në botë quhen “*Kalifatullah*” ose “*Kalif*”. Ashtu siç thotë Allahu në suren en-Nur:

وَعَدَ اللَّهُ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ لَيَسْتَخْلِفَنَّهُمْ فِي الْأَرْضِ كَمَا
اسْتَخْلَفَ الْأَدْنَى مِنْ قَبْلِهِمْ وَلَيُمَكِّنَنَّ لَهُمْ دِينَهُمُ الَّذِي ارْتَضَى لَهُمْ وَلَيُبَدِّلَنَّهُمْ مِنْ
بَعْدِ خَوْفِهِمْ أَمْنًا يُغْنِيهِمْ لَا يَشْرِكُونَ فِي شَيْئًا وَمَنْ كَفَرَ بَعْدَ ذَلِكَ فَأُولَئِكَ
هُمُ الْفَاسِقُونَ

Allahu u ka premtuar atyre që besuan dhe bënë vepra të mira prej jush, se do t’i bëjë patjetër kalifë në tokë, ashtu siç i ka bërë kalifë ata që ishin para tyre. Ai do t’ua përforcojë fenë e tyre, të cilën e ka pëlqyer për ta dhe do t’ua shndërrojë frikën e tyre në siguri. Ata do

të më adhurojnë Mua dhe nuk do të Më shoqërojnë asgjë (në adhurim). Sa për ata që tregohen mosmirënjohës edhe pas kësaj, pikërisht ata janë të pabindur.³

Hazret Mirza Bashiruddin Mahmud Ahmedi ^{r.a.}, Kalifi i II i Mesihut të Premtuar ka thënë:

“Ky ajet parashtron dekretin përfundimtar për fatin e muslimanëve. Atyre u kërkohet betim, që nëse mbështesin Kalifatin, dhe bëjnë përpjekje të duhura duke synuar këtë qëllim, Zoti do të vendosë Kalifatin në mesin e tyre, ashtu siç e ka vendosur Ai në popujt e mëparshëm. Ai do t’ua forcojë fenë, të cilën Ai ka zgjedhur për ta, dhe do t’ia forcojë bazat. Pas gjendjes së frikës, Ai do t’i kaplojë ata me paqe e siguri dhe rrjedhimisht ata do të bëhen adhurues të vërtetë të Zotit dhe nuk do t’i shoqërojnë Atij asgjë”.⁴

Nga kjo që u përmend më lart, mund të arrijmë në përfundimin që Allahu ka lënë vetëm një zgjidhje për të nxjerrë umetin musliman nga situata kaotike dhe për t’ia shndërruar frikën në paqe, dhe ajo është “vendosja e kalifatit.”

Dështimi i politikës për vendosjen e paqes në botë

Fuqitë e mëdha dhe mbretëritë kanë dështuar të vendosin paqe në botë. Të gjitha format e qeverisjes; demokratike,

autokratike, monarkike, teokratike etj., që bazohen në parimet e kapitalizmit apo socializmit kanë rezultuar të pasuksesshme në këtë drejtim. Organizata e Kombeve të Bashkuara, aleancat dhe blloqet e tjera Lindore a Perëndimore, politike apo ekonomike, nuk kanë arritur të bëjnë një ndryshim shpresdhënës. Në të kaluarën “Lidhja e Kombeve” (*The League of Nations*) është shpërbërë pikërisht për shkak të paftësisë së saj për të ndaluar Luftën e Dytë Botërore. Por edhe Organizata e Kombeve të Bashkuara pothuaj ka dështuar në shuarjen e mosmarrëveshjeve dhe konflikteve të përgjakshme, pasi fuqitë e mëdha e kanë gjymtuar aftësinë e saj për të luajtur rolin që i takon. Në shekullin e fundit, bota është lënduar dy herë nga luftërat që sollën dëme e pasoja të paimaginueshme. Ndërsa tani bota po vrapon me shpejtësi drejt një lufte të tretë botërore.

Megjithatë, edhe në këto kohëra të vështira Zoti nuk i ka harruar robërit e Tij paqedashës. Edhe para se të plasnin këto konflikte të sotme, para luftës së ftohtë, madje edhe para Luftës së Dytë a Parë Botërore Zoti e dërgoi një shërbëtor të Tij, të cilin e kishte zgjedhur për të vendosur paqen e vërtetë në botë. Ardha e tij ishte paralajmëruar plotë 14 shekuj më parë, nga Profeti i shenjtë i Islamit Muhammedi ^{s.a.v.s.} Në përmbledhjen e haditheve, Sahih



el-Buhariu ruhen fjalët e tij: “وَتَضَعُ الْحَرْبُ أَوَْارَهَا” d.m.th. kur do të vijë Imam Mehdiu dhe Isai biri i Merjemes, ai do t’ju japë fund luftërave dhe do të përhapë mësimet e paqes, pajtimit, reformimit dhe përparimit në shoqëri.

Sikur bota do t’i ishte përgjigjur thirrjes së Imam Mehdiut ^{a.s.}, që ai e kishte shpallur në 1889, ajo nuk do të kishte hequr kaq shumë vuajtje. Ashtu siç tha Mesihu i Premtuar ^{a.s.}:

صدق ے میری طرف آؤ اسی میں خیر ہر
یہ درندے ہر طرف میں عافیت کا ہوں حصار

“Ejani tek unë me sinqeritet, ngase kjo është e vetmja rrugë për përmirësim.

Egërsirat janë shpërndarë kudo dhe vetëm unë jam kështjella e pamposhtur”.

Bota as atëherë, nuk do të kishte pësuar Luftën e Parë dhe të Dytë Botërore, dhe as tani ajo nuk do të ishte vend i dhunës dhe i vrasjeve masive sikur t’i ishte përgjigjur thirrjes së Mesihut të Premtuar dhe Kalifëve të tij, për vendosjen e unitetit dhe paqes globale.

Demaskimi i kalifatit të rremë

Ato të ashtuquajtura grupe fetare, të cilat po e përdorin emrin e Kalifatit për t'i keqduhëhequr njerëzit nuk po bëjnë asgjë që i ngjan paqes. Vetëm ky kriter është më se i mjaftueshëm për t'i refuzuar ideologjitë dhe pretendimet e tyre rreth Kalifatit.

Në vend që të përmendin dhe të diskutojnë rreth attributeve të Zotit, i gjithë mekanizmi i tyre është përqendruar vetëm për të tmerruar shoqërinë dhe për të prodhuar frikë, terror, kërcënime, gjakderdhje, luftëra dhe çrregullim në tokë. A mund të quhet ky Kalifat?

Në vend që të shfaqin mësimet e vërteta paqësore dhe të bukura të Islamit, ata pushkatojnë njerëz të pafajshëm, shkaktojnë gjakderdhje dhe bëjnë kërdi në emër të atij që ata e quajnë zot. A mund të quhet ky Kalifat?

Në vend që të predikojnë diturinë dhe mbështesin konvergencën ndërmjet fjalës dhe veprës së Zotit, që njihet si shkencë në ditët e sotme, ata djegin librat dhe shkatërrojnë bibliotekat. Për të ndaluar edukimin perëndimor përfshirë çdolloj shkencë, ata po shkatërrojnë shkollat dhe po indoktrinojnë fëmijët me mendime të rrezikshme. A mund të quhet ky Kalifat?

Në vend që të ndërgjegjësojnë ndjekësit e tyre dhe t'i lartësojnë moralisht e shpirtërisht, ata i trajtojnë si të përdorin armë vdekjeprurëse, si të torturojnë dhe si të ndjellin frikë mes njerëzve. Në vend që t'u ndëtojnë karakterin dhe t'i ushqejnë me dashuri dhe morale të larta, ata janë të interesuar të tjetërsojnë emrat dhe pamjet e tyre. Në vend që të kontribuojnë për paqe në botë, ata ndezin gjithnjë konflikte të reja. Duke ndryshuar kufijtë politikë të shteteve, ata hapin vatra të reja agresioni. A mund të quhen këta mëkëmbës të Allahut në Tokë?

Jo, Jo... assesi jo!!

Kurani dëshmon se këta nuk kanë të bëjnë asgjë me Islamin dhe sistemin e Kalifatit i cili vendos paqe në botë. Kurani i hedh poshtë ideologjitë dhe pretendimet e tyre të rreme duke dhënë këtë vendim të qartë, që këto grupe terroriste, çfarëdo që bëjnë për interesat e tyre vetjake në emër të fesë, nuk përkojnë me Islamin. Këta nuk kanë aspak lidhje me Profetin Muhammed ^{s.a.v.s.}, i cili erdhi në këtë botë si رحمة للعالمين, mëshirë për mbarë njerëzimin. Ky profet i paqes kishte parashikuar ardhjen e Imam Mehdiut, që t'u jepte fund luftërave dhe konflikteve fetare.

Konvergenca dhe divergjenca midis popujve

Ndonëse, bota sot është kthyer në një fshat global, ajo ndodhet shumë larg të qenit i bashkuar. Përmes shpikjeve bashkëkohore, në një anë vërehet konvergencë politike e ekonomike ndërmjet shteteve, por nga ana tjetër vihet re shtimi i divergjencës midis popujve. Nganjëherë dallimet fetare bëhen burim konfliktesh. Mospërputhjet dhe mospajtimet në mendim e qytetërim nxisin acarim në marrëdhëniet e Lindjes dhe Perëndimit, duke thelluar hendekun ndërmjet klasave, racave dhe kulturave. Bota është distancuar nga paqja e cila u soll nga Profeti i parë Universal ^{s.a.v.s.} me anë të mësimave globale dhe kështu duke iu larguar këtyre parimeve, bota po ndjek një rrugë që e shpie drejt shkatërrimit.

Xhemati Ahmedia – shpresa për paqen

Zoti na ka dhënë një mundësi tjetër në këtë kohë të brishtë. Ne po jetojmë në një epokë, në të cilën Allahu për të ringjallur mësimet paqësore të Islamit, ka dërguar Imam Mehdiun, dhe për ta fuqizuar këtë mision, ka themeluar sistemin e Kalifatit pas tij.

Ky reformator i madh i ditëve të mëvonshme, është dërguar në këtë kohë për t'u dhënë fund konflikteve të përgjakshme, për të zhdukur dallimet ndërmjet njerëzve, për t'u prirë njerëzve drejt paqes e harmonisë dhe për të ndërtuar një kështjellë të pamposhtur

për të gjithë banorët e tokës.

Hazret Mesihu i Premtuar ^{a.s.} ka deklaruar:

“Zoti im më ka lajmëruar se unë jam si Varka e Nuhut për njerëzit. Kushdo që më afrohet duke hyrë në besëlidhje me mua, do të ruhet nga humbja dhe unë i jap sihariqin e fitores”.⁵

Ai gjithashtu ka thënë:

“Vërtet, unë asgjësoj gënjeshtrën dhe bëhem strehim për të munduarit. Unë jam arma e Zotit tim të Gjithëmëshirshëm dhe argument i Allahut bujar. Unë jam dita dhe dielli. Unë jam rruga. Fjalët janë përmbushur në qenien time, ndërsa të pavërtetat janë përgënjeshtruar përmes meje. Unë përshkruaj të vërtetën, dhe si shpërblim lavdërohem prej Zotit. Unë jam simboli i shfaqjes së fuqisë hyjnore. Unë kam ardhur në gjurmët e Profetit ^{s.a.v.s.} dhe përmes meje do të ringjallen të vdekurit e do të zhduket errësira”.⁶

Kalifati – rruga që shpie drejt bashkimit global

Kjo është rruga që shpie drejt paqes së vërtetë e cila mund të vendoset në botë vetëm nëse ne punojmë me të gjitha mundësitë tona për të arritur bashkimin global në këtë fshat global.

Mësimet e vërteta të Islamit, që u paraqitën rishtas në botë në formën

e tyre origjinale përmes Mesihut të Premtuar a.s. janë të tilla që mund të udhëzojnë botën drejt vëllazërisë universale, dhe që është i pari dhe më i rëndësishmi hap në ndërtimin e paqes botërore.

Përmes Kalifatit Ahmedia, miliona muslimanë ahmedianë nga më shumë se 220 vende të botës, ngrihen dhe ulen me një shenjë dhe mundohen të ndjekin çdo porosi të Imamit të tyre, për të vendosur paqe në botë.

Promovimi i mësimave të vërteta të Islamit

Kalifati Ahmedia po promovon mësimet e vërteta të Islamit, që bazohen në drejtësi e barazi. Sa e shkëlqyeshme është kjo porosi që thotë: Ji i drejtë! Ji i drejtë! Madje më shumë se i drejtë! Madje as armiqësia me dikë të mos ju largojë nga drejtësia. Në 2008-ën, parlamenti britanik dëgjoi zërin e Kalifit të kohës duke thënë qartë e shkoqur:

“Në këtë kohë, kur bota sërish po ndahet në blloqe, ekstremizmi po përshkallëzohet, situata financiare e ekonomike po përkeqësohet, ka nevojë urgjente për t’i dhënë fund çdolloj urrejtjeje dhe për të hedhur themelet e paqes. Kjo mund të realizohet vetëm duke respektuar ndjenjat e gjithsecilit”.⁷

Përmes Kalifatit Ahmedia mësimet e

vërteta të Islamit rreth besnikërisë dhe dashurisë ndaj atdheut u paraqitën në Qendrën Ushtarake të Gjermanisë. Kalifi u shpreh:

“Besnikëria është një veti madhore dhe njerëzit që e kanë shfaqur këtë veti në shkallën më të lartë ishin profetët e Zotit. ... Sipas mësimave të Islamit, përkufizimi apo kuptimi i vërtetë i besnikërisë është që një person duhet në mënyrë të pastër t’i përmbushë të gjitha zotimet dhe premtimet e tij në të gjitha nivelet dhe në të gjitha rrethanat, pavarësisht nga vështirësitë që has në mes”.⁸

Kalifi mbron fuqimisht kauzën e Islamit

Për vendosjen e paqes në botë, a ka ndonjë mënyrë më të mirë se kjo? Nëse liderët e botës dhe personalitetet e spikatura të shoqërisë, do të mundoheshin për t’i zbatuar këto mësim, atëherë pavarësisht dallimeve tona fetare, paqja do të mund të vendosej.

Duke promovuar mësimet paqësore dhe të harmonishme të Islamit, Kalifi deklaroi fuqimisht me fjalë plot patos që:

“Islami nuk lejon mizorinë ose shtypjen në çfarëdo mënyre, trajte a forme qoftë”.⁹

Ky mesazh shpresëdhënës kumboi sërish në Capitol Hill, Washington D.C.

dhe prej andej u përhap në gjithë botën. Kalifi përshkroi imtësisht të gjitha mjetet e nevojshme që shpien drejt kësaj rruge dhe tha:

“Kështu, Islami na tërheq vëmendje ndaj mjeteve që duhen për vendosjen e paqes. Ai kërkon drejtësinë absolute. Ai kërkon që gjithmonë të paraqiten vetëm dëshmi të vërteta. Ai kërkon që vështrimet tona të mos hidhen lakmueshëm ndaj pasurive të të tjerëve. Ai gjithashtu kërkon që vendet e zhvilluara të heqin dorë nga interesat e tyre vetjake dhe të përkrahin e t’u vijnë në ndihmë shteteve të varfra e më pak të zhvilluara me një qëndrim të sinqertë dhe frymë altruiste. Nëse të gjithë këta faktorë respektohen, vetëm atëherë mund të arrihet paqja”.¹⁰

Sot bota po rrokulliset vulltas drejt një lufte tjetër botërore. Në emër të Pranverës Arabe, në emër të lirisë, në emër të fesë, në emër të kufijve gjeografikë, nga të gjitha kahet po fryn një stuhi e fuqishme, një uragan shkatërrues dhe një shakullinë e tërbuar, të cilat kanë mbërthyer gjithë botën. Popujt kanë nisur përgatitje për agresion kundër popujve të tjerë, ndërsa shtetet po i tregojnë dhëmbët njëri-tjetrit. Qoftë Siria apo Iraku, Jemeni apo Libia, Turqia apo Koreja Veriore, bota po bën hapa të vazhdueshëm drejtë greminës së shkatërrimit.

Në këto kohëra, është vetëm një zë

qiellor, vetëm një figurë shpirtërore, vetëm një pishtar i paqes, i cili në njërin anë po i bën thirrje Papës dhe në anën tjetër liderëve muslimanë. Ai i bën thirrje liderëve të Arabisë Saudite, Kryeministrit të Iranit e të Izraelit e u dërgon letra atyre. Ky është ai person i cili i zgjon qeveritë e Britanisë e të Amerikës dhe udhëton gjerë e gjatë për të përhapur mesazhin e paqes në gjithë botën duke ua paraqitur kuptimet e vërteta të Islamit.

Ky zë ka mahnitur gjithkënd, dhe me të vërtetë nëse ekziston ndonjë mundësi për të vendosur paqen në botën tonë, ajo lidhet me ndjekjen e këtij zëri.

Derisa nuk u bindet përulësisht udhëzimeve të Kalifit të kohës, bota kurrë nuk mund ta gjejë paqen e vërtetë. Toka e shkretë nuk mund të bëhet pjellore e të japë frytin derisa nuk laget nga shiu qiellor. Kurani shtjellon dukurinë e paqes absolute për besimtarët e sinqertë me fjalët “لا خوف عليهم ولا هم يحزنون” pra, ata nuk do të kenë as frikë e as nuk do të pikëllohen.¹¹ Ndërsa Bibla duke iu referuar kohës së Mesihut të Premtuar a.s., ka paralajmëruar të njëjtën dukuri. Ajo e përshkruan atë kohë me këto fjalë:

“Do t’i gjykojë të varfrit me drejtësi dhe do të marrë vendime të drejta për njerëzit e përlulur të vendit. Do ta godasë vendin me shufrën e gojës së tij dhe me frymën e buzëve të tij do ta bëjë të vdesë

të pabesin. Drejtësia do të jetë brezi i ijëve të tij dhe besnikëria brezi i anëve të tij. Ujku do të banojë bashkë me qengjin dhe leopardi do të rrijë me kecin; viçi, luani i vogël dhe bagëtia e majmur do të rrinë bashkë dhe do të udhëhiqen nga një fëmijë. Lopa do të kullosë bashkë me arushën, të vegjlit e tyre do të rrinë bashkë, dhe luani do të ushqehet me kashtë si kau”.¹²

Prandaj vendosja e paqes, harmonisë dhe vëllazërisë nëpërmjet Imam Mehdiut është një dekretim hyjnor. Zoti ka vendosur që me anë të fjalëve të tij ndikuese dhe frymës së tij të shenjtë, bota do të dëshmojë paqen e vërtetë. Ku përkatësitë etnike, ngjyrat e lëkurës, klasat shoqërore apo dallimet fetare nuk do të jenë më shkak i çrregullimeve në botë. Ku të bardhët, zezakët, hindut, muslimanët, të krishterët dhe hebrenjtë nuk do të luftojnë më me njëri-tjetrin në emër të Zotit. Ky është përcaktimi i Zotit që do të ndodhë patjetër.

Pra gëzohuni ju që i keni braktisur rrugët e luftës dhe u jeni nënshtruar porositë të Mesihut të Premtuar dhe kalifëve të tij të bekuar.

Pra gëzohuni ju që jeni bërë pjesë e këtij dekreti qiellor, e cila është rruga e vetme drejt paqes së vërtetë. Jashtë kësaj kështjelle nuk ka paqe kurrkund, ashtu siç kishte deklaruar Mesihu i Premtuar^{a.s.}. E mbyll këtë temë me fjalët e tij të

bekuara. Ai shkruan:

“Ato ditë janë afër, madje janë shumë pranë kur bota do të dëshmojë pamjen e kiametit. Nuk do të bien vetëm tërmetet, por do të ndodhin edhe fatkeqësi të tjera të lahtarshme. Disa prej tyre do të zbresin nga qielli e disa do të shpërthejnë nga toka. Kjo do të ndodhë sepse njeriu ka hequr dorë nga adhurimi i Zotit, dhe shpirtrat, me të gjitha mendimet dhe përpjekjet e tyre, janë tërhequr pas botës. ... Ata që pendohen, do të gjejnë paqe, dhe ata që përgjyken para se t'i zërë gjëma, do të mëshirohen. A kujtoni se planet tuaja do t'ju shpëtojnë dhe do të ruheni prej këtyre gjëmave? Jo, assesi jo. Atë ditë të gjitha përpjekjet njerëzore, do të marrin fund.

... Nuk je e sigurt, oj Europë, as ti, oj Azi. O banorët e ishujve, asnjë perëndi e trilluar nga ju nuk do të jetë e aftë t'ju ndihmojë. Unë shikoj qytete që shemben dhe banime në rrënoja. Ai Zot i Vetëm heshti për një periudhë të gjatë. Vepra të këqija u bënë përpara syve të Tij dhe Ai u tregua i duruar. Por tani Ai do të shfaqet në një formë të tmerrshme. Ai që ka veshë le të dëgjojë se koha nuk është e largët. Unë jam përpjekur t'i mbledh të gjithë nën sigurinë e Zotit, por edhe dekretet hyjnore duhet të plotësoheshin. Sinqerisht ju them të vërtetën, që po i afrohet radha edhe këtij kombi. Ju do të jeni dëshmitarë të kohës së Nuhit

(Noas) dhe sytë tuaj do të shikojnë atë që ndodhi në tokën e Lutit (Lotit).

Por Zoti është i ngadaltë në zemërimin e Tij. Pendohuni që t'u tregohet mëshirë. Ai që braktis Zotin është një insekt dhe jo njeri, dhe ai që nuk i frikësohet Atij është i vdekur dhe jo i gjallë”.¹³

SHËNIME

[1] *Kurani Famëlartë* 7:117

[2] *Kurani Famëlartë* 7:118-19

[3] *Kuran Famëlartë* 24:56

[4] “*Tefsir Kabir*”, vëll VI, botuar nga Drejtoria e publikimit dhe botimit Kadian, f. 367

[5] “*Aina kamaalati Islam*”, *Rubani Khezain*, Vëll. V f. 486, botuar në 2009, Angli, ISBN 978-1-84880-102-8

[6] “*Luxhetun Nur*”, *Rubani Khezain*, vëll. XVI, f. 473-474, botuar në Pakistan, 2008, ISBN 81791217555

[7] “*Kriza botërore dhe rruga drejt paqes*”, nga Hazret Mirza Masrur Ahmed, f. 14, botuar nga Xhemati Musliman Ahmedia i Shqipërisë, 2014, ISBN: 978-1-84880-255-1

[8] Si më parë, f. 28-29

[9] si më parë, f. 231

[10] Si më parë, f. 91

[11] *Kurani Famëlartë* 2:63

[12] *Isaia* 11:4-7

[13] “*Hakikatul Vahi*”, *Rrubani Khezain*, Vëll. XXII, f. 268-269, botuar në 2008, Pakistan, ISBN 8179121755

Lutje për kërkuar të mira materiale dhe shpirtërore për fëmijët

Për të mira materiale dhe shpirtërore të fëmijëve të tij, Hazret Ibrahim ^{a.s.} kishte bërë edhe këtë lutje:

رَبَّنَا إِنِّي أَسْكَنْتُ مِنْ ذُرِّيَّتِي بِوَادٍ غَيْرِ ذِي زَرْعٍ عِنْدَ بَيْتِكَ الْمُحَرَّمِ
رَبَّنَا لِتَقْبِلُوا الصَّلَاةَ فَاجْعَلْ أَفْتَدَةً مِنَ النَّاسِ تَهْوِي إِلَيْهِمْ وَارْزُقْهُمْ مِنْ
الثَّمَرَاتِ لَعَلَّهُمْ يَشْكُرُونَ ﴿١﴾ رَبَّنَا إِنَّكَ تَعْلَمُ مَا نُخْفِي وَمَا نُعْلِنُ ۖ وَمَا يَخْفَى
عَلَى اللَّهِ مِنْ شَيْءٍ فِي الْأَرْضِ وَلَا فِي السَّمَاءِ ﴿٢﴾

O Zoti im! Kam vendosur disa nga fëmijët e mi në një luginë të pambjellë, pranë Shtëpisë Sate të shenjtë o Zoti im, që ata të kryejnë namazin. Bëj që zemrat e njerëzve të anojnë nga ata dhe jepu ushqim prej të vjelave që ata të të falënderojnë. O Zoti ynë! Ti pa dyshim e di atë që ne fshehim dhe atë që e zbulojmë. Për Allahun asgjë nuk është e fshehtë, as në tokë e as në qiell.¹

[1]. *Kurani Famëlartë* 14:38-39.

METODA E LEXIMIT DHE E STUDIMIT TË KURANIT TË SHENJTË

HAZRET HAKIM MAULVI NURUDIN (R.A.)

Sipas asaj që kuptoj unë, këto janë metoda për të kuptuar Librin e Zotit.

1. Lutja. T'i kërkonte Zotit të Madhërishëm mendimin e pastër dhe dijen e vërtetë. Kurani i Shenjtë na mëson:

قُلْ رَبِّ زِدْنِي عِلْمًا

“O Zoti im! Më shto dijen mua!”¹

Kurse për lutjen, janë të nevojshme: ushqimi i pastër, veshja e pastër, vullneti i fortë dhe qëndrueshmëria.

2. Të përpiqeni duke qenë brenda Zotit vetëm për të gjetur pëlqimin e Tij dhe për të arritur tek e vërteta, siç Ai tha:

وَالَّذِينَ جَاهَدُوا فِينَا لَنَهْدِيَنَّهُمْ سُبُلَنَا وَإِنَّ اللَّهَ لَمَعَ الْمُحْسِنِينَ

“Ata që përpiqen duke qenë brend Nesh, Ne patjetër ua tregojmë rrugët Tona.”²

3. Meditimi. Kurani Famëlartë thotë:

أَفَلَا يَتَذَكَّرُونَ الْقُرْآنَ أَمْ عَلَى قُلُوبٍ أَقْفَالُهَا

“A nuk thellohen në Kuran, apo i kanë zemrat të kyçura?! ”³ Dhe tha:

لَا تَأْتِي لَأُولَى الْأَلْبَابِ الَّذِينَ يَذْكُرُونَ اللَّهَ قِيَامًا وَقُعُودًا وَعَلَى جُنُوبِهِمْ

“... ka shenja për të mençurit. Ata që kujtojnë Allahun në këmbë, ulur dhe kur janë (shtrirë) në ijët e tyre dhe thellohen ...”⁴

4. Të keni bindje të pastër, fjalë të pastra, vepra të pastra dhe qëndrueshmëri gjatë skamjes, sëmundjes, orvatjeve dhe

vështirësive. Këtë përmbledhje Kurani e quan takva. Shikoni ajetin e sures El-Bekare që fillon me fjalët:

لَيْسَ الذِّكْرُ أَنْ تُولُوا وَجُوهَكُمْ قِبَلَ الْمَشْرِقِ وَالْمَغْرِبِ

“Mirësia nuk është të ktheni fytyrat tuaja nga Lindja apo Perëndimi ...”⁵

Dhe një pjesë të takvasë, Zoti e përmendi edhe në fillim të sures El-bekare, siç tha: “Besojnë në të padukshmen”. Njeriu me takva është ai që lutet dhe sipas vullnetit dhe fuqisë së tij përpiket për t'u ardhur në ndihmë të tjerëve, duke qenë dashamirës të tyre. Dhe pikërisht për takvanë Allahu i Madhërishëm thotë:

وَاتَّقُوا اللَّهَ وَيُعَلِّمُكُمُ اللَّهُ

“Kijeni druajtjen ndaj Allahut (takvanë), dhe Allahu do t'ju mësojë.”⁶

Por njeriu që i pëlqen vetja e tij, privohet nga kuptimet e ajeteve të Zotit, siç tha Ai:

سَاصْرَفُ عَنْ آيَاتِي الَّذِينَ يَتَكَبَّرُونَ فِي الْأَرْضِ بِغَيْرِ الْحَقِّ

“Ata që bëhen mendjemëdhenj në tokë pa të drejtë, Unë do t'i largoj nga ajetet e Mia.”⁷

5. Kuptimet e Kuranit të Shenjtë duhet t'i shikoni në radhë të parë në vetë Kuranin e Shenjtë.

6. Për asnjë fjalë të Kuranit të Shenjtë, nuk duhet të nxirri asnjë komentim që bie ndesh me vetë Emrat [atributet] e Allahut, me Shenjtërinë e Tij dhe me

Lartësinë e Tij.

7. Duhet të kesh parasysh sunetin e Profetit Muhammed^{s.a.v.s.} dhe kuptimet t'i nxirrni pa dalë nga vija e tij.

8. Nuk duhet t'i kundërshtoni praktikat e Allahut që janë të vendosura.

9. Kuptimet që nxirrni për fjalët e Kuranit, nuk duhet të jenë kundër gjuhës arabe dhe kundër frazeologjisë arabe.

10. Për pjesën që flet në mënyrë të përgjithshme, duhet të përqipesh që të mos i cenosh kuptimet e përgjithshme.

11. Kuptimi nuk duhet të jetë kundër dritës së zemrës.

12. Nuk duhet të jetë kundër haditheve të sakta e të vërtetuara.

13. Për të gjetur kuptimet e Kuranit, u referohen edhe librave të mëparshëm

14. Kuptimet e Kuranit mund të zgjidhen edhe nëpërmjet ndonjë shpalljeje (*vahji ose ilhami*) të vërtetë të Zotit.

Nëse ju jap shembuj të secilës pikë, do të bëhet një libër i madh dhe disa nga pikat e lartpërmendura nuk u vijnë në përdorim njerëzve të zakonshëm. ...⁸

Metodat për të arritur dijet e Kuranit të Shenjtë i ka treguar Vetë Allahu i Madhërishëm. Ai tha:

الرَّحْمَنُ ۞ عَلَّمَ الْقُرْآنَ

“I Gjithëmëshirshmi (i) mësoi Kuranin (njeriut).”⁹

I Gjithëmëshirshmi është atribut i Allahut, pra, është karakteristika e të Gjithëmëshirshmit, që t'i mësojë Kuranin e Shenjtë njeriut. Se çfarë gjërash nevojiten për për këtë punë, edhe këtë e ka treguar Vetë Zoti i Madhërishëm.

وَاتَّقُوا اللَّهَ ۖ وَيَعْلَمَ اللَّهُ

“Kijeni druajtjen ndaj Allahut (takvanë), dhe Allahu do t'ju mësojë.”¹⁰

Pra, njeriu që ka druajtje, Zoti i Madhërishëm i dhuron dijet dhe njohuritë Kuranore dhe druajtja ndaj Allahut është një mjet për të pasur dijet Kuranore.

Në një ajet tjetër thotë:

وَالَّذِينَ جَاهَدُوا فِينَا لَنَهْدِيَنَّهُمْ سُبُلَنَا

“Ata që përpiqen duke qenë brend Nesh, Ne patjetër ua tregojmë rrugët Tona.”¹¹

Pra, duhet përpjekje e vazhdueshme duke pasur takvanë ndaj Zotit. Andaj, Allahu i Madhërishëm është Vetë Mësuesi i dijeve të Kuranit dhe metodat për të thithur këtë bekim dhe begati të të Gjithëmëshirshmit janë takvaja dhe përpjekja në rrugën e Allahut.

Unë kam provuar një metodë, e cila është që së pari duhet të krijosh në zemër dëshirë dhe etje të singertë për të gjetur dijet Kuranore, të përsosësh takvanë tënde dhe të lutesh për këtë dhe në këtë formë të fillosh studimin e Kuranit të Shenjtë, sipas metodës që vijnë:

Leximi i parë

Zgjidh një përkthim të Kuranit të Shenjtë, një përkthim që është fjalë për fjalë, ku të mos ketë gjëra shtesë nga njeriu dhe ta lexosh vetë. ... Çdo ditë, pa bërë mungesë, duhet të lexosh një pjesë të Kuranit, sipas mundësisë. Të thellohesh në kuptimet e fjalëve të tij.

Gjatë këtij leximi, aty ku flitet për Ademin dhe Shejtanin, shiko në veten tënde: a i përngjan Ademit apo Iblisit? Musait apo Faraonit? Ke cilësitë e “jehudive” apo të të nënshtruarve?

Po kështu, kur lexon, duhet të ndiesh frikë nga ajetet që flasin për ndëshkim e t'i kërkosh mbrojtje Allahut nga ai; të gëzohesh nga ajetet e mëshirës dhe të lutesh për të marrë mëshirën Hyjnore.

Çdo ditë duhet t'i dërgosh salavate Profetit Muhammed s.a.v.s., të bësh lutje, t'i kërkosh falje Allahut, e të thuash: “Nuk ka fuqi tjetër përveç Fuqisë Sate, o Allah!” Në këtë mënyrë, ta mbarosh leximin e parë. Gjatë këtij leximi, duhet të mbash dhe një fletore për të shënuar tema të vështira.

Leximi i dytë

Gjatë leximit të dytë, tregoji bashkëshortes ato që mëson, duke besuar se Kurani i Shenjtë është zbritur për ju të dy, bashkëshortja në daç të të kushtojë vëmendje apo jo. Pra, duhet të zgjerosh studimin më shumë sesa që ishte gjatë leximit të parë.

Gjatë këtij leximi, të shohësh herë pas here shënimet që ke mbajtur në fletoren në leximin e mëparshëm. Kështu ta përfundosh leximin e dytë. Do të shohësh që shumë nga tema të vështira që nuk ishin të qarta gjatë leximit të parë, do të të zgjidhen. Edhe gjatë leximit të dytë, të mbash një fletore më vete.

Leximi i tretë

Në të njëjtën mënyrë, të nisësh leximin e tretë dhe në përhapjen e këtij leximi të përfshish fëmijët, njerëzit e tjerë të familjes, fqinjët etj., por ata që nuk të kundërshtojnë. Krahoso herë pas here fletoren e parë e të dytën. Do të shohësh që gjatë këtij leximi shumë gjëra do të të qartësohen edhe më tej. Sërisht, mbaj një fletore më vete edhe gjatë këtij leximi.

Leximi i katërt

Pas leximit të tretë, në leximin e katërt përfshij edhe njerëzit e tjerë të rrethit shoqëror në përgjithësi. Pra, tregoua njerëzve që të dëgjojnë. Nëse ata ngrenë akuza, përgjigju në rast se i di, përndryshe shënoji pyetjet e tyre në fletore. Më pas lutju Allahut të Madhërishëm duke ndier dhimbje në zemër që Ai t'i mësojë përgjigjet e akuzave.

Leximi i pestë

Gjatë leximit të pestë përfshij në diskutime gjithë njerëzit e tjerë, qofshin muslimanë apo idhujtarë, qofshin besimtarë apo mohues. Do të kesh begatinë dhe bekimin e Allahut

dhe Ai do të të mësojë një pjesë të konsiderueshme të Kuranit të Shenjtë dhe ty do të të hapen vërtetësi të imëta dhe njohiri të thella të Fjalës së Hyjnore.

Këtë metodë e kam provuar unë. Prandaj, kushdo që ka dashurinë ndaj Kuranit dhe ka etje për të pasur dijet e Kuranit dhe është i sinqertë në dëshirën e tij, mund ta provojë këtë recetë, sepse do të ketë rezultat.¹²

Mbajeni mend! Mësoni Kuranin e Shenjtë që ta praktikoni atë. Me këtë synim, kur ta hapni Kuranin e Shenjtë dhe ta lexoni përkthimin e saktë, nga fillimi deri në fund, shikoni vazhdimisht se cilit grup i përkisni ju: atyre që Allahu i ka bekuar apo atyre që tërhoqën zemërimin e Allahut dhe atyre që devijuan?

Analizoni se çfarë kërkoni të bëheni. Krijoni një dëshirë të sinqertë në zemër për t'u bërë ndër ata që i ka bekuar Allahu dhe për këtë lutuni shumë. Ndiqni rrugët që ka caktuar Allahu për t'ju përfshirë në bekimin e Tij dhe ndiqini ato vetëm e vetëm për të fituar pëlqimin e Allahut.

Në këtë mënyrë, edhe sikur ta lexoni suren El-Fatiha, ju them me bindje se do ta kuptoni sekretin për të cilin u zbrit Kurani i Shenjtë. Më pas, është punë e Allahut të Madhërishëm t'ju tregojë kuptimet e thella, njohuritë e imëta dhe vërtetësitë e pastra të Kuranit të Shenjtë. Kjo njëkohësisht është një metodë

edhe për të bërë përpjekje në rrugën e besimit.¹²

(Marrë nga “*Hakaikul-Furkan*”, vëll. 1, Kadijan, Indi, 2005, f. 1 – 4)

SHËNIME

[1] *Ta.Ha.* 20:115.

[2] *El-Ankabut* 29:70.

[3] *Muhammed* 47:25.

[4] *Ali-Imran* 3:191-192.

[5] Ajeti i plotë është: “Mirësi nuk është të ktheni fytyrat tuaja nga Lindja apo Perëndimi, por mirësi i cilësohet atij që beson në Allahun, ditën e ahiretit, engjëjt, Librin dhe profetët; që, duke pasur dashuri ndaj Tij, u jep pasuri të afërmve, jetimëve, të varfërve, udhëtarëve, lypësve, dhe për lirimin e të robëruarve; që fal namazin dhe jep zekatin; (mirësia është e atyre) që përmbushin premtimin kur premtojnë, që janë të durueshëm gjatë vështirësive, brengave dhe gjatë luftës. Pikërisht këta janë që përvetësojnë të vërtetën dhe pikërisht këta janë të devotshëm (pra, që kanë takva).” (El-Bekare 2:178).

[6] *El-Bekare* 2:283.

[7] *El-A'raf* 7:147.

[8] “*Dibaça Nuruddin*”, f. 8, 9; Revista “*Tesh'bidhul-Edb'han*”, muaji shtator, 1913.

[9] *Er-Rahman* 55:2-3.

[10] *El-Bekare* 2:283.

[10] *El-Ankabut* 29:70.


[11] Gazeta “*Al-Hakam*”, Kadijan, 7 tetor 1913, f. 6.

[12] Gazeta “*Al-Hakam*”, Kadijan, 24 prill 1904, f. 12.

Burimi i jetës

Zoti ynë bën mrekulli të panumërta, por i shohin vetëm ata që bëhen të Atij me vërtetësi dhe besnikëri. Ai nuk u shfaq mrekullitë e Tij të tjerëve që nuk besojnë me bindje në fuqitë e Tij dhe që nuk janë të vërtetë e besnikë ndaj Tij.

Sa fatkeq është ai njeri që ende nuk di se ai ka një Zot, i cili ka fuqi mbi çdo gjë! Parajsa jonë është Zoti ynë. Kënaqësitë tona më të larta gjenden në Zotin tonë, sepse ne e pamë Atë dhe çdolloj bukurie gjetëm në Të. Kjo pasuri është me vlerë ta marrësh nëse e gjen duke dhënë edhe jetën. Dhe ky rubin është me vlerë ta blesh edhe sikur të kushtojë sa e gjithë qenia jote. O të humbur, vraponi drejt këtij burimi se do t'ju shuajë etjen. Ky është burimi i jetës që do t'ju shpëtojë. Ç'të bëj unë? Si mund ta gdhend në zemrat e njerëzve këtë lajm të gëzuar? Me çfarë daulleje t'i njoftoj njerëzit se Ky është Zoti i tyre? Dhe me çfarë ilaçi t'ua kuroj veshët që ata të fillojnë të dëgjojnë?



Emrat e Allahut



14. EL-BĀRI'
(FILLUESI)

هُوَ اللَّهُ الْخَالِقُ الْبَارِئُ الْمُصَوِّرُ لَهُ الْأَسْمَاءُ الْحُسْنَى يُسَبِّحُ لَهُ مَا فِي السَّمَاوَاتِ
وَالْأَرْضِ وَهُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ

Ai është Allahu, Krijuesi, Filluesi, Formuesi. Ai i ka Emrat më të bukur. Atë e kujton gjithçka që është në qiej e (në) tokë. Dhe Ai është Triumfuesi, i Urti.¹

Kuptimi leksikor

Fjala el-Bāri' rrjedh nga folja بَرَأَ (krijoi) dhe në fjali shërben si vepruese. Arabët thonë: بَرَأَ اللَّهُ تَعَالَى عِبَادَهُ يَرْوَهُمْ بَرَاءً "Allahu i krijoi robërit e Tij". Nga kjo rrënjë rrjedh kundrina e shprehur nga emri الْبَرِيَّةُ (el-Berijeh) d.m.th. krijesë.² Hazret Aliu zotohej me këto fjalë: "لَا، وَالَّذِي فَلَقَ الْحَبَّةَ وَبَرَأَ النَّسَمَةَ" Jo, betohem në Atë që e shpërtheu farën dhe krijoi shpirtrat!"³

Sipas gjuhëtarëve rrënja الْبَاءُ-الرَّاءُ-الْهَمْزَةُ (el-Ba, er-Ra, el-Hemza) mbartin dy kuptime kryesore. Së pari, për të krijuar, shpikur apo formuar diçka, prandaj Allahu është el-Bāri' الْبَارِئُ (Krijuesi) dhe krijesa الْبَرِيَّةُ el-Berijeh. Së dyti, largimi a lirimi nga diçka në kuptimin e zhdukjes. P.sh.

thuhet بَرَاءَةٌ مِنَ الْمَرَضِ hoqa një sëmundje. بَرَاءَةٌ مَبْرُتُونَ mbart kuptimin e largësisë, shfajsimi dhe faljes. Në Kuran gjejmë thënien e Ibrahimit a.s.:

إِنِّي بَرَاءٌ مِمَّا تَعْبُدُونَ

"Unë përnjëmend jam i distancuar nga ato që adhuron ju".⁴ Nga kjo del që nëse kjo fjalë përdoret për njeriun, në kuptimin e largësisë dhe shmangies, nënkuptohet largësia nga idhujtaria e hipokrizia, distancimi nga mëkatet dhe disiplinimi i karakterit nga vetitë, fjalët dhe sjelljet e ulëta.

Kuptimi ideologjik

El-Bāri' الْبَارِئُ është një prej emrave të Allahut, që do të thotë krijues, nismëtar dhe dhuruesi i jetës, i cili solli çdogjë në ekzistencë nga asgjëja. Atributi el-Bāri' është sinonimi i emrit el-Khāliq pasi mban kuptimin e krijimit dhe shpikjes, megjithatë ekziston një dallim midis këtyre dy attributeve. I atribuohemi emrit el-Bāri' kur flasim për krijimin e qenieve të gjalla, ndërsa për krijimin e qenieve joorganike, si qielli dhe toka, i referrohem atributit el-Khalik. Shejh Sadiu thotë: "El-Bariu shënjon atë, i cili krijoi gjithçka që ekziston. Përmes urtësisë së Tij, Ai e përsosi çdo qenie dhe përmes madhësisë dhe dijes së pakufishme Ai i dha aformën dhe trjaten më të bukur. Ai vazhdon ta ushtrojë këtë cilësi, siç ka vepruar më parë".

El-Zemakhsheri ka thënë se Allahu është el-Bāri', sepse Ai ka krijuar çdo gjë në mënyrë të përsosur dhe pa ndonjë të metë. Siç Ai ka thënë:

الَّذِي خَلَقَ سَبْعَ سَمَوَاتٍ طِبَاقًا مَّا تَرَى فِي خَلْقِ الرَّحْمَنِ مِنْ تَفَوتٍ

(Ai) që krijoi shtatë qiej në shtresa. Ti nuk sheh asnjë mospërputhje në krijimin e të Gjithëmëshirshmit.⁵

Ibn Kethiri ka thënë: “Ai nuk ka asnjë ndryshim, asnjë disonancë, asnjë mospërputhje, asnjë mangësi, asnjë çekuilibrim e asnjë çrregullim”. Ebu Aliu ka thënë: “Ai i ka bërë fytyrat që të dallohen nga njëra-tjetra. Prandaj tiparet e Zejdut e dallojnë atë nga Amri dhe një gomar dallohet nga kali. Padyshim, Ai është Krijuesi dhe Filluesi më i mirë”.⁶

Përmendja në Kuran e hadith

Përpos ajetit të sipërpërmendur, Allahu e ka përmendur këtë atribut edhe në dy vende të tjera në Kuran. P.sh.:

وَإِذْ قَالَ مُوسَىٰ لِقَوْمِهِ يَا قَوْمِ إِنَّكُمْ ظَلَمْتُمْ أَنفُسَكُمْ بِاتِّخَاذِكُمُ الْعِجْلَ فَتُوبُوا إِلَىٰ بَارِئِكُمْ فَاقْتُلُوا أَنفُسَكُمْ ذَٰلِكُمْ خَيْرٌ لَّكُمْ عِنْدَ بَارِئِكُمْ فَثَابَ عَلَيْهِمْ إِنَّهُ هُوَ التَّوَّابُ الرَّحِيمُ

Dhe kur Musai i tha popullit të tij: “O populli im! Vërtet ju shkelët veten tuaj, duke e marrë vëzhgimin për zot. Kthehuni, pra, të penduar te Krijuesi juaj dhe vritni veten tuaj (d.m.th. vritni instinktin tuaj që ju nxit për mëkat). Kjo, te Krijuesi juaj, është më e mira për ju”. Pastaj Ai jua pranoi pendesën duke ju mëshiruar. Me të vërtetë, Ai është Pendimpranuesi, Mëshirëbërësi.⁷

Në lidhje me emrin El-Bāri, kemi një hadith të njohur.

عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «إِنَّ لِلَّهِ تَعَالَى تِسْعَةً وَتِسْعِينَ اسْمًا مِنْ أَحْصَاهَا دَخَلَ الْجَنَّةَ هُوَ اللَّهُ الَّذِي لَا إِلَهَ هُوَ - الرَّحْمَنُ الرَّحِيمُ --- الْخَالِقُ الْبَارِئُ الْمُصَوِّرُ

Hazret Ebu Hurejra ^{r.a.} përcjell se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: “Allahu i Lartësuar ka 99 emra. Ai që i ruan ato në kujtesë, do të hyjë në xhenet. Ai është Allahu, nuk ka të adhuruar (tjetër përpos Tij). Ai është i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëbërësi, ... Krijuesi, Filluesi, Formuesi...”.⁸

Krijimi i shpirtit

Hazret Mesihu i Premtuar ^{a.s.} shkruan:

“Fjala e pastër e Zotit na tregon që shpirti vjen në jetë në të njëjtën strukturë, e cila vjen prej spermës dhe përgatitet në mitër. Siç thotë Ai në Kuranin Famëlartë:

ثُمَّ أَنشَأْنَاهُ خَلْقًا آخَرَ ۖ فَتَبَارَكَ اللَّهُ أَحْسَنُ الْخَالِقِينَ

Trupin, që përgatitet në mitër, Ne e shndërrojmë në një krijesë tjetër dhe e shfaqim në një qenie, që quhet shpirt. Zoti ka bekime të shumta dhe është Krijuesi i tillë që asnjëri nuk barazohet me Të.⁹

Kjo që thuhet, “Nga trupi, Ne sjellim një krijesë tjetër”, është një sekret i fshehur që zbulon realitetin e shpirtit dhe që tregon ato lidhje të forta që ekzistojnë midis shpirtit dhe trupit. Ky ajet gjithashtu na mëson se e njëjta filozofi Hyjnore gjendet edhe në gjestet trupore, në thëniet dhe në të gjitha lëvizjet instinktive të njeriut kur ato fillojnë të realizohen për hir të Zotit të

Madhërishëm dhe në rrugën e Tij. Me një fjalë, sikundër në spermë, edhe në veprat e singerta, që nga fillimi fshihet një shpirt, i cili shkëlqen gradualisht bashkë me formimin dhe përsosmërinë e veprave të njeriut. Kur ky shpirt përsoset, ai përnjëherë ndizet si një dritë me gjithë madhësinë e saj dhe qenia shpirtërore shfaq jetën në mënyrë të plotë. Vetëm kur plotësohet modeli i veprave të njeriut, atëherë brenda tij, si një vetëtimë diç fillon të ndriçohet.”¹⁰

SHËNIME

1. *Kurani Famëlartë* 59:25
2. *Kurani Famëlartë* 98:8 إِنَّ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ أُولَٰئِكَ هُمْ خَيْرُ الْكَرِيمَةِ. “Sigurisht, ata që besuan dhe bënë të mira, janë krijesat më të mira.”
3. Ebu Is’haq ez-Zuxhaxh, “*Tefsiru Esmailabil Husna*”, f. 38, Darul-Mamun lit-Turath, Damask, 1979.
4. *Kurani Famëlartë* 43:27.
5. *Kurani Famëlartë* 67:4.
6. Ebu Is’haq ez-Zuxhaxh, “*Tefsiru Esmailabil Husna*”, f. 38, Darul-Mamun lit-Turath, Damask, 1979.
7. *Kurani Famëlartë* 2:55.
8. El-Beghavi, *el-Mishkat el-Mesabih*, Kitab: ed-Da’vat, Bab: Esma-ullahi Te’ala, hadith numër 2288.
9. *Kurani Famëlartë* 23:15 “...pastaj e bëmë atë krijesë tjetër. Pra, Allahu zotëron bekimin, Krijuesi më i mirë nga të gjithë krijuesit!”
10. Hazret Mirza Ghulam Ahmedi ^{a.s.}, “*Filozofia e mësimave të Islamit*”, f. 37, Islam International Publications Ltd., Tiranë, 2019.



15. EL-MUSAV-VIR (FORMUESI)

هُوَ اللَّهُ الْخَالِقُ الْبَارِئُ الْمُصَوِّرُ لَهُ الْأَسْمَاءُ الْحُسْنَى يُسَبِّحُ لَهُ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَهُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ

Ai është Allahu, Krijuesi, Filluesi, Formuesi. Ai i ka Emrat më të bukur. Atë e kujton gjithçka që është në qiej e (në) tokë. Dhe Ai është Triumfuesi, i Urti.¹

Zoti ka krijuar çdo gjë nga asgjëja dhe i ka dhënë asaj një formë të veçantë dhe një trajtë unike që i përgjigjet plotësisht funksionet dhe veprimtaritë e saj. Kjo formë e bën atë të dallueshme nga të tjerët pavarësisht shumëllojshmërisë dhe mjaftueshmërisë së saj.

Kuptimi leksikor

Emri *el-Musav-vir* المصور përdoret si veprues, dhe rrjedh nga folja صور يصور që do të thotë ai modeloi gjithçka me tiparet e nevojshme.

Ibn Athiri ka thënë: “Atributi المصور

el-Musav-vir është një prej emrave të Allahut të Madhërishëm. Ai i ka dhënë çdo qenieje të krijuar një formë të përshtatshme dhe i vuri sipas një rregulli. Kështu Ai i dha çdo gjëje një pamje të veçantë dhe një trajtë unike që dallohet nga të tjerat në ndryshueshmëri dhe në shumësin e saj”.

El-Musav-viri është Ai që u ka dhënë krijesave të Tij pamje dhe trajta të ndryshme, të dukshme a të fshehura dhe shqisore apo mendore, të cilat u përgjigjen plotësisht funksioneve të saj. Nuk ekzistojnë dy gjini që t'i ngjajnë njërit-tjetrit e as dy tipa që të jenë të barabarta, madje as dy individë nuk janë të njëjta, pasi secili ka tiparet dhe trajtën e vet specifike që e dallon atë nga të tjerët. Kjo tregon se përsosmëria e krijimit nuk varet vetëm nga pajisja me aftësitë e duhura, por edhe me formën a trajtën e përshtatshme.

Kuptimi ideologjik në Kuran e hadith

Sipas mufesirinėve, tri atributet e Allahut janë të ndërlydhura. Ato janë: *الخالق el-Khālik* (Krijuesi), *البارئ el-Bari'* Filluesi dhe *المصور el-Musav-vir* (Formuesi). Si Krijues, Zoti krijoi gjithçka nga asgjëja, kur nuk ekzistonte asgjë të ngjashme. Si Fillues, Ai krijoi çdo gjë në mënyrë të përsosur, me një urtësi të thellë, pa ndonjë të metë dhe duke i dhënë asaj veçoritë specifike. Atributi 'Formues' është etapa e tretë, përmes të cilit, Allahu i jep çdo gjëje një

formë apo trajtë të caktuar.

«هُوَ الَّذِي يُصَوِّرُكُمْ فِي الْأَرْحَامِ كَيْفَ يَشَاءُ»

Është Ai që ju formon në mitra si të dojë. Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Tij, të Plotfuqishmit, të Urtit.²

Mevlana Xhelāl ud-Dīn Muhammed Rūmī shkruan:

هر چه را خوب و خوش و زیبا کند
از برای دیده بینا کند

Çdo gjë që është bërë e bukur, e hijshme dhe mahnitëse, është bërë (kështu) për syrin e atij që e sheh.³

Allahu e ka krijuar njeriun në formën më të përsosur dhe i ka dhuruar fuqitë, veçoritë dhe shqisat e nevojshme. Në tokë jetojnë rreth 7,9 miliardë njerëz dhe secili prej tyre posedon një fytyrë të veçantë.⁴ Çdo qenie, nga një pikë shiu te një fjollë bore, nga gurët te bimët, nga gjurmët e gishtave te bebëzat, nga milingonat te yjet në qiell dhe nga grimcat te galaktikat, të gjitha këto pasqyrojnë atributin *el-Musav-vir* me format, trajtat dhe veçoritë e tyre përkatëse.

Shumëllojshmëria e fytyrës dhe tiparet poligenike (gjatësia, ngjyra e lëkurës, syve dhe të flokëve etj.) e bën çdo njeri të veçantë, unik dhe të dallueshëm nga të tjerët. Këto karakteristika

përcaktohen nga gjenet ose ADN, në të cilat mbartet e koduar, informacioni i trashëgimisë, dhe ajo është përgjegjëse për strukturën dhe karakteristikat fizike dhe biokimike për gati të gjitha qeniet e gjalla. Struktura e ADN-së bazohet në 4 nukleotide: Adenina (A), Citozina (C), Timina (T), Guanina (G) që përbëjnë kodin gjenetik të njeriut. Çdo qelizë në trupin tuaj mban rreth 3.2 miliardë nukleotide çifte dhe trupi i njeriut ka rreth 20-25,000 gjene, të cilat përcaktojnë të gjitha karakteristikat dhe funksionet e tij.⁵

اللَّهُ الَّذِي جَعَلَ لَكُمُ الْأَرْضَ قَرَارًا وَالسَّمَاءَ بِنَاءً وَصَوَّرَكُمْ فَأَحْسَنَ صُورَكُمْ وَرَزَقَكُم مِّنَ الطَّيِّبَاتِ ۚ ذَٰلِكُمُ اللَّهُ رَبُّكُمُ الْعَلِيِّ

Është Allahu Ai që për ju bëri tokën si vendbanim dhe qiellin si bazë (të mbijetesës suaj), ju dha formë, e shumë bukur ju formoi, dhe ju ushqeu me të pastrat. Ky është Allahu, Zoti juaj. Pra, vetëm Allahu zotëron bekimin që është Zoti i botëve!⁶

P.sh. ujin që pijmë, nëse e ftohim, molekulat e tij fillojnë të tkurren. Por me ftohjen e mëtejshme densiteti i tij nuk zvogëlohet, por për habi zmadhohet gradualisht dhe në pikën e shkrirjes uji ka densitet më të madh se në temperaturën + 4 °C. Kjo mundëson që në temperaturën +4 °C, një shtresë akulli formohet mbi liqene apo oqeanë, që e izolon ujin poshtë dhe kështu mbron gjallesat ujore, që ndryshe mund

të ishin zhdukur gjatë dimrit.⁷

Hazret Mesihu i Premtuar ^{a.s.} Shkruan:

“Allahu është *el-Khālik* që do të thotë se Ai është Krijuesi. Ai është *el-Bari'*, d.m.th. Ai i ka krijuar shpirtrat dhe qeniet nga një gjendje asgjëje. Ai është *el-Musav-vir*, d.m.th. Ai i ka dhënë çdo qenieje formën trupore dhe strukturën që u përgjigjet veçorive të llojit të saj. Në të vërtetë, të gjithë emrat e Tij të bukur manifestohen dukshëm, d.m.th. të gjitha atributet e Tij të përsosura, të cilat arsyeja njerëzore mund të përfytyrojë në bazë të përsosmërisë së natyrës, mishërohen në qenien e Tij”.⁸

Ky atribut na nxit të reflektojmë mbi forma të ndryshme që na rrethojnë dhe të kënaqemi nga mrekullia e Zotit, sepse ai i krijoi bimët, lulet, frutat, kafshët, zogjtë dhe çdo gjë në formën më të përsosur. Ne duhet të jemi gjithmonë mirënjohës ndaj Tij, të fokusohemi në aftësinë tonë, të përmirësohemi çdo ditë dhe t'u sjellim dobi të tjerëve. Sepse bukuria e jashtme nuk ka vlerë, nëse i mungon bukuria e karakterit të brendshëm. Prandaj edhe i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} lutej:

اللَّهُمَّ كَمَا أَحْسَنْتَ خَلْقِي، فَحَسِّنْ خُلُقِي

“O Allah! Ashtu siç më ke krijuar në mënyrën më të përsosur, bëji që edhe cilësitë e mia morale të jenë më të mirat”.⁹

Ne duhet të përdorim aftësitë tona për qëllime të duhura dhe ta adhurojmë vetëm Atë. Gjurmët e këtij autori janë gdhendur në çdo grimcë të universit.

I Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} shpeshherë bënte këtë lutje në sexhden e recitimit:

اللَّهُمَّ لَكَ سَعَدْتُ وَبِكَ أَمِنْتُ وَلَكَ أَسْلَمْتُ وَأَنْتَ رَبِّي سَجَدَ وَجْهِي لِلْأَيْدِي خَلَقَهُ وَصَوَّرَهُ وَشَقَّ سَمْعَهُ وَبَصَرَهُ تَبَارَكَ اللَّهُ أَحْسَنُ الْخَالِقِينَ “

O Allahu im! Për Ty kam rënë në sexhde, Ty të kam besuar, Ty të jam nënshtuar dhe Ti je Zoti im. Fytyra ime po i bën sexhde Atij që e krijoi, i dha formën, i dhuroi veshët dhe sytë përmes mrekullisë dhe fuqisë së Tij. Vetëm Allahu zotëron bekimin, Krijuesi më i përsosur.¹⁰

SHËNIME

1. *Kurani Famëlartë* 59:24.
2. *Kurani Famëlartë* 3:7.
3. *Mesnevi*, 1-2383.
4. <https://www.businessinsider.com/why-are-human-faces-so-complex-and-unique-2014-9>
5. <https://atlasbiomed.com/blog/five-scientific-reasons-why-you-are-totally-unique/>
6. *Kurani Famëlartë* 40:65.
7. Wiltse, Brendan, “*A Look Under The Ice: Winter Lake Ecology*”. Ausable River Association. Vizituar më 23 April 2020.
8. Hazret Mirza Ghulam Ahmed ^{a.s.}, “*Mektûbâte Ahmed*”, vëll. 1, f. 12-13.
9. *Bulûgh el-Merâm*, libri numër 16, hadith numër 101.
10. *Sunen en-Nesâ’i*, Libri: et-Tatbik, kapitull: No’un Akharu, hadith numër: 1127.

LUTJE PËR TË PASUR SHËNDET DHE SIGURI

Hazret Ajshja ^{r.a.} tregon se i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} shpesh bënte këtë lutje:

لَلَّهِمَّ عَافِنِي فِي جَسَدِي وَعَافِنِي فِي بَصَرِي وَاجْعَلْهُ الْوَارِثَ مِنِّي لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ الْحَلِيمُ الْكَرِيمُ سُبْحَانَ اللَّهِ رَبِّ الْعَرْشِ الْعَظِيمِ وَالْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ

All-llāhumme ‘āfinī fī xhesedī, ve ‘āfinī fī sem’ī ve besarī vexh’alhumā el-vārithe minnī lā ilāhe il-lAll-llāh el-halimul-kerimu, subhānAll-llāhi rabbil-‘arshil-‘ādhim, vel-hamdu lil-lāhi rabbil-‘ālemin.

O Allah! Më dhuro shëndet në trup, shëndet në dëgjim, shëndet në shikim dhe këta dy të fundit bëji të jenë trashëgimtarë të mi. Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut, të Dhembshur dhe Bujar. I Shenjtë është Allahu, Zoti i arshit madhështor dhe lavdia është e Allahut, Zotit të botëve.

Xhāmi’u et-Tirmidhī, kitāb: “Ed-Da’vāt”, hadithi nr. 3480.

NJË ARGUMENT INTERESANT PËR VDEKJEN E HAZRET ISAIT ^{a.s.}

Themeluesi i Xhematit Musliman Ahmedia, Mesihu i Premtuar ^{a.s.} tha:

“Në një hadith fisnik përmendet se i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} ka thënë: “Kur të vijë Mesihu, jepini selam prej meje!”. Duhet të mendoni rreth kuptimit të këtij hadithi. Po të ishte i gjallë Isai ^{a.s.} në qiell, i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} e kishte takuar vetë në udhëtimin e Miraxhit dhe po ashtu edhe Hazret Xhibraili përditë prej atje i vinte, pse nuk i dërgoi selam Profeti ^{s.a.v.s.} përmes tij?! Veç kësaj, pasi ndërroi jetë, edhe i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} në qiell ka shkuar, aty ku gjendet edhe Hazret Isai ^{a.s.}. Kjo do të thotë se Mesihu do të zbritej në Tokë, pasi ta takonte të Dërguarin e Allahut ^{s.a.v.s.}. Atëherë, cili është kuptimi që banorët e Tokës t’ia përcjellin selamin e të Dërguarit të Allahut ^{s.a.v.s.}? Në këtë rast, Hazret Isai ^{a.s.} a nuk do t’u përgjigjet duke thënë: “Unë vetë po vij nga ai, çfarë selami po ma jepni ju?! Është njëlloj si të thuash: “Nga vendi vij unë, e lajme më jep ti!” Pra, kjo tregon se besimi i të Dërguarit të Allahut ^{s.a.v.s.} dhe i sehabëve të tij ^{r.a.} ishte se Hazret Isai ^{a.s.} ka ndërruar jetë dhe nuk do të kthehej në këtë botë dhe se Mesihu i ardhshëm do të ishte njëri prej këtij umeti, që do të ishte pasqyruar i tij”.

(Hazret Mirza Ghulam Ahmed ^{a.s.}, “*Melfuzat*”, vëll. 2, botuar 1985, Angli, f. 296)

Vepra të mira për të filluar Vitin e Ri

Kur përfundon një vit, njerëzit si gjithmonë kthejnë vëmendjen dhe varin shpresa të reja sërish te Viti i Ri. Për një pjesë të madhe të shoqërisë, ndërrimi i vitit nënkupton një organizim festiv, qëndrimin zgjuar pas mesnatës dhe nisjen e Vitit të Ri me një pije dehëse. Shfaqjet e fishekzjarrëve në vigjiljen e Vitit të Ri bëhen në të gjithë globin, dhe secili popull përpiqet të kalojë tjetrin duke bërë një spektakël gjithnjë më ekstravagant.

Përveç këtyre festimeve, shpesh njerëzit mendojnë edhe për rezolutat e Vitit të Ri, p.sh. të ushqyerit e shëndetshëm, të udhëtuarit drejt destinacioneve të reja, të frekuentuarit në palestër etj.

Pyetja ime është, a luan ndonjë rol ky organizim për të festuar Vitin e Ri në sjelljen tuaj në muajin qershor apo edhe shkurt? Studimi i kryer në vitin 2020 nga “Strava”, një aplikacion që regjistron aktivitetet sportive, zbuloi se 40% e përdoruesve që kishin bërë rezoluta për Vitin e Ri, kishin hequr dorë nga rezolutat e tyre afërsisht vetëm dy javë pas fillimit të vitit. Në realitet, shumica e rezolutave nuk i mbijetojnë as muajit janar.

Ideja e një “Viti të Ri” është të harrosh vitin e kaluar dhe të fillosh nga e para, çdo gabim e shkelje në sjellje të futet nën qilimin e harresës e të fshihet nga kujtesa për të mos folur më për të. Ndonjëherë, njerëzit i shohin festimet e Vitit të Ri gati

si një “kalim pa pagesë” nga e kaluara e tyre. Nën sloganin se “është Vit i Ri, nuk ka rëndësi”, ata angazhohen në veprime që normalisht nuk do t’i bënin kurrë në jetën e përditshme. Disa nga këto sjellje janë aq të papërshtatshme e të shfrenuara, që nuk mund të priten nga një njeri normal.

Ky slogan është thjesht një justifikim për t’u dëfryer e për t’u zbavitur derisa t’i afrohen cakut të “ndalesës”. A në të vërtetë ndalen këto shfaqje të shfrenuara apo slogani në fjalë është vetëm një justifikim tjetër? A do të pushojnë vërtet këto veprime të paligjshme, apo do të rishfaqen? Siç e kemi parë edhe në media, këto akte dhe sjellje të dëmshme sjellin pasoja që mbeten për disa muaj. Raportet e lajmeve më 1 janar shpesh tregojnë pamjet nga qendrat e qyteteve, të xhamave të thyer dhe të vendeve të vandalizuara. Këto veprime sabotimi në përgjithësi nxiten nga përdorimi i alkoolit dhe drogës (e cila mund të jetë shkaku kryesor i kësaj sjelljeje).

Numri i lartë i rasteve në urgjencë, arrestimet e policisë për vendosjen e rendit dhe aktet e dhunshme e të paligjshme u sjellin dëme të mëdha shërbimeve e burimeve që janë nevojat jetike për rastet e mirëfillta dhe urgjencat reale. Kur këto “festime” analizohen në tërësi, justifikimi përmes sloganit “është Viti i Ri” duket tërësisht i pakuptimtë.

Si muslimanë, qëllimi ynë në jetë është

shumë i qartë: ta adhurojmë Zotin, të bëjmë vepra të mira, t’u sjellim dobi të tjerëve dhe të përpiqemi të përmirësojmë veten tonë. Kur mbyllet një vit, ne inkurajohemi për të reflektuar mbi sjelljen tonë gjatë vitit që po e lëmë pas. A u kemi dhënë përparësi namazit dhe lutjeve mbi gjërat e kësaj bote? A kemi kontribuuar mjaftueshëm gjatë vitit sipas mundësisë për bamirësi? A kemi shtuar njohurinë tonë fetare?

Në këtë mënyrë, i identifikojmë aspektet në të cilat jemi përmirësuar dhe falënderojmë Allahun për të. Po ashtu, i dallojmë edhe dobësitë tona dhe i lutemi Allahut për falje dhe i kërkojmë ndihmë për të qenë më të mirë. Sidoqoftë, e falënderojmë Allahun dhe lutemi për forcë, mbështetje dhe udhëzim.

Ne inkurajohemi për të mbyllur vitin me veprat dashamirëse, p.sh. duke u uruar shëndet, mbarësi dhe mirësi miqve, fqinjëve dhe kolegëve tanë, duke dhuruar për të pastrehët, duke punuar për natyrën e mjedisin, duke kontribuuar për bamirësi dhe duke marrë pjesë vullnetarisht në aksionet e pastrimit për të mbledhur mbeturinat dhe fishekzjarrët nga pedonalet etj.. Veprat flasin më shumë se fjalët dhe këto veprime dashamirësie na mbushin me pozitivitet, shpresë dhe vendosmëri për t’i bërë ato më shpesh.

Në lidhje me mënyrën se si duhet të presim vitin e ardhshëm, na këshillohet që çastet e ndërrimit të vitit të kalojmë në lutje e meditim. Ne lutemi për veten tonë, lutemi

për të dashurit tanë (të gjallë apo të vdekurit), për atdheun tonë, për popullin tonë, për komunitetin në të cilin bëjmë pjesë dhe për të ardhmen e botës sonë.

Lutemi për një vit më të mbarë, të mbushur me mirësi, shëndet dhe bekime për të gjithë ne. Ne lexojmë Kuranin Famëlartë, i cili na qartëson qëllimin e jetës, na mëson për detyrat tona dhe na nxit për të dhënë sadaka (lëmoshë) për bamirësi. Kjo bën që Vitin e Ri ta fillojmë me një frymë sakrifice për një qëllim më të madh.

Sigurisht, edhe mua më pëlqejnë fishekzjarrët. Megjithatë lutjet, vetëreflektimi dhe veprimet sado të vogla bamirëse kanë një vlerë dhe kuptim më të madh në jetën time. Atëherë, pse të mos provojmë ndërrimin e vitit me një aktivitet bamirës, pozitiv dhe reflektues? Ndikimet frymëzuese të këtyre veprimeve përhapen gjithandej dhe bëhen shkëndijë për veprat madhore. Allahu thotë në Kuranin Famëlartë:

الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ طُوبَىٰ لَهُمْ وَحَسَنَ مَا أَجْرُ

“Ata që besuan dhe bënë vepra të mira kanë një vend të pastër dhe vendkthim të mbarë”. (Kurani Famëlartë 13:30)



Çlirimi i Aleksandrisë dhe shkatërrimi i bibliotekës

Hazret Mirza Masrur Ahmed (a.b.a.)

*Kalifi i Pestë i Mesihut të Premtuar,
Allahu e ndihmoftë fuqimisht*

S i ndodhi Çlirimi i Aleksandrisë? Në lidhje me këtë, historianët shkruajnë që pas fitores në Fustat, Hazret Omeri r.a. lejoi të bënin përpjekje edhe për çlirimin e Aleksandrisë.

Në Kirjun që ndodhet mes Aleksandrisë dhe Fustatit, pati një betejë e ashpër me bizantinët, në të cilën muslimanët fituan. Pas kësaj, bizantinët deri në Aleksandri nuk u përballën me muslimanët. Mukaukisi donte të bënte pajtimin duke paguar xhizjen, pavarësisht se bizantinët vijuan t'i bënin trysni për luftë. Përfundimisht, ai i dërgoi mesazh Hazret 'Amr bin el-'Asit që ai dhe populli kopt nuk po merrnin pjesë në këtë luftë, andaj, ata nuk duhet të dëmtoheshin.

Koptët u distancuan nga përballja me muslimanët, madje e ndihmuan ushtrinë muslimane, duke ua rregulluar rrugën dhe urët. Edhe në betejën e Aleksandrisë, koptët i furnizuan muslimanët me ushqime.

Për të kuptuar se sa e rëndësishme ishte fitorja mbi Aleksandrinë, mjafton vetëm një fakt që në kohën kur muslimanët e pushtuan Aleksandrinë, ajo shërbente si kryeqyteti i shtetit. Pas Kostandinopojës, ajo konsiderohej qyteti më i madh i Perandorisë Bizantine. Përveç kësaj, Aleksandria ishte qyteti i parë në botë për sa i përket tregtisë ndërkombëtare.

Bizantinët e dinin shumë mirë se nëse muslimanët do ta pushtonin edhe

Aleksandrinë, kjo do t'u sillte pasoja të rënda. Të shqetësuar nga këto rrethana, Herakliu një herë kishte pohuar deri këtu që nëse arabët do ta rrëzonin Aleksandrinë, do të shkatërroheshin bizantinët.

Në Aleksandri Herakliu personalisht kishte bërë përgatitje për të luftuar me muslimanët, por vdiq gjatë përgatitjeve. I biri mori fronin e Kostandinopojës. Për shkak të ledheve të saj të drejta dhe madhështore, dhe për shkak të vendndodhjes strategjike si dhe për numrin e madh të rojtarëve që kishte, Aleksandria zinte një vend unik në të gjitha kështjellat e tjera.

I shqetësuar nga rrethimi i gjatë i Aleksandrisë që vijoi deri në 9 muaj, Hazret Omeri r.a. i shkroi një letër [Hazret 'Amr bin el-'Asit r.a.] duke thënë:

– Ndoshta jeni bërë të prirë për qejf, se fitorja nuk duhej vonuar kaq gjatë. Nxitni muslimanët për xhihad duke ua lexuar mesazhin tim dhe bëni sulmin!

Pasi ua lexoi letrën, Hazret 'Amr bin el-'Asi r.a. thirri Hazret Ubade bin Samitin r.a. dhe ia dorëzoi flamurin. Më pas, muslimanët bënë një sulm të fuqishëm dhe e rrëzuan qytetin. Hazret 'Amri menjëherë dërgoi lajmëtar drejt Medinës duke porositur të shkonte sa më shpejt të ishte e mundur për t'i dhënë Emirit të Besimtarëve lajmin e madh të fitores.

“Si mund të mendoje që unë të flija gjatë ditës?!”

Lajmëtari hipi në deve dhe duke kaluar qytet pas qytetesh, në kohën e drekës mbërriti në Medinë. Mendoi se mund të ishte kohë pushimi për Kalifin e kohës. Andaj, në vend të shkonte në zyrën e Kalifit, iu drejtua xhamisë së Profetit. Rastësisht aty kaloi një shërbëtore e Hazret Omerit dhe e pyeti se kush ishte dhe prej nga vinte.

– Po vij nga Aleksandria, iu përgjigj lajmëtari.

Shërbëtorja shkoi dhe e njoftoi Hazret Omerin dhe, pa vonesë, u kthye dhe i tha

– Të kërkon Emiri i Besimtarëve.

Edhe vetë Hazret Omeri ^{r.a.} duke mos pritur po bëhej gati për të dalë, ndërkohë mbërriti lajmëtari. Sapo e dëgjoi lajmin e fitores, ra në sexhde për të falënderuar Allahun. Më pas, shkoi në xhami dhe bëri njoftimin:

– Es-salatu xhami’e!

E gjithë Medina u mblodh. Lajmëtari u dha të gjitha lajmet e fitores. Më pas, Hazret Omeri ^{r.a.} e mori lajmëtarin në shtëpinë e tij për të ngrënë bukë.

– Pse nuk erdhe direkt tek unë? E pyeti Hazret Omeri lajmëtarin.

– Mendova se jeni duke pushuar, iu përgjigj ai.

– Si mund të mendoje që unë të flija gjatë ditës, duke pasur barrën e Kalifatit mbi supe?! I tha Hazret Omeri ^{r.a.}

Liria fetare e vendosur në Aleksandri nga muslimanët

Çlirimi i Aleksandrisë shkaktoi fitoren e të gjithë Egjiptit. Në këto beteja një numër i madh të kundërshtarëve ranë rob. Hazret Omeri ^{r.a.} përmes një letre e porositi Hazret ‘Amrin:

– Thuajuni të gjithë të robëruarve në daç të pranojnë fenë islame, në daç të qëndrojnë në fenë e tyre. Nëse e pranojnë fenë islame, do të trajtohen njësoj si muslimanët e tjerë, nëse jo, do të japin xhizjen siç japin të tjerët.

Kur iu lexua ky udhëzim i Hazret Omerit të burgosurve, një pjesë e tyre e pranuan Islamin, dhe një pjesë tjetër qëndruan në fenë e tyre. Çdo herë kur dikush prej tyre shprehte dëshirën për të pranuar Islamin, muslimanët brohorisnin duke thënë – Allahu Ekber! Dhe çdo herë kur dikush shprehte dëshirën për të qenë i krishterë, të krishterët që të gjithë e përgëzonin, kurse muslimanët shprehnin keqardhje.¹

Shkatërrimi i Bibliotekës së Aleksandrisë

Incidenti i djegies së Bibliotekës së

Aleksandrisë përmendet shpesh me tone të ndezura nga orientalistë të ndryshëm. Cili është realiteti i kësaj ngjarjeje? Duke iu referuar fitores së muslimanëve mbi Aleksandrinë, kundërshtarët, sidomos historianë të krishterë ngrenë akuzën se gjoja Hazret Omeri ^{r.a.} urdhëroi të digjin një bibliotekë të madhe që gjendej në Aleksandri, duke krijuar përshtypjen se sa shumë armiq të dijes dhe të logjikës ishin muslimanët, *neudhubil-lah*.² Sipas tyre, muslimanët e kanë djegur Bibliotekën e Aleksandrisë, zjarri i së cilës vijoi të digjej për gjashtë muaj. Ndërkohë, edhe logjika, edhe argumentet historike tregojnë hapët se akuza në fjalë është tërësisht e sajuar, sepse muslimanët janë populli, të cilin Zoti dhe Udhëheqësi i tyre ^{s.a.v.s.} e kanë porositur:

طَلَبَ الْعِلْمَ فَرِيضَةً عَلَى كُلِّ مُسْلِمٍ

Kërkimi i dijes është i detyrueshëm për çdo musliman.³

Kurse Kurani i Shenjtë në dhjetëra ajete i ka urdhëruar të thellohen, të arsyetojnë, të logjikojnë, të mësojnë dhe të fitojnë dijen. Duhet të jesh tërësisht kundër logjikës të ngresh një akuzë të tillë ndaj muslimanëve.

Përveç kësaj, shumë nga historianët, ndër të cilët ka edhe të krishterë dhe evropianë, e hodhën poshtë këtë akuzë, duke dhënë prova që incidenti i djegies

së bibliotekës së Aleksandrisë është tërësisht i sajuar.

Një dijetar i Egjiptit, Muhammed Rada, në librin e tij “*Siretu Omer Faruk* ^{r.a.}”, duke e përmendur këtë ngjarje, shkruan:

Incidentin e djegies së bibliotekës së Aleksandrisë e përmend Ebul-Ferxh Mulettij, në një libër historie të titulluar “*Muhteserut-Duvel*”. Historiani në fjalë lindi në vitin 1226 dhe vdiq më 1286. Ai shkruan që në kohën kur muslimanët fituan Aleksandrinë, kishte një prift të quajtur Juhena en-Nehvi, të cilin muslimanët e quanin Jahja, që i përkiste sekti Jekubije të të krishterëve por që më vonë u tërhoq nga doktrina e trinitetit, një herë i kërkoi ‘Amr bin el-‘Asit librat e mjekësisë nga Khazainul-melukijje [Biblioteka e Aleksandrisë].

(Kjo histori është tërësisht e pavërtetë dhe e sajuar, megjithatë, për ta rrëzuar akuzën, po jua paraqes siç e tregojnë ata.)

Atëherë Hazret ‘Amr bin el-‘Asi ^{r.a.} iu përgjigj që mund të vepronte vetëm pasi të këshillohej me Hazret Omerin ^{r.a.}. Hazret Omeri ^{r.a.}, sipas tij, i shkroi: “Librat që ju keni përmendur, nëse dija e tyre përputhet me Librin e Allahut, neve na mjafton ajo që është e shkruar në Librin e Allahut. Dhe nëse ajo nuk përputhet me Librin e Allahut, nuk na duhen fare libra të tillë. Andaj, asgjësoni

librat e tillë.” Atëherë, sipas këtij rrëfimi, Hazret ‘Amr bin el-‘Asi filloi të seleksiononte librat në Aleksandri dhe i dogji në furrat e saj, dhe u deshën gjashtë muaj që të digjeshin të gjithë librat.

Ky rrëfim nuk përmendet as në Tarikh Tabari, as në Ibni Ethir, as në Ja’kubi e Kindi, as në Ibni ‘Abdil-Hakem, as në Biladheri dhe as në Ibni Kheldun. Atë e përmend vetëm Ebul-Ferxhi në mesin e shekullit XIII e.s. ose në fillim të shekullit VII h., pa dhënë asnjë burim.

Profesor Butler bëri hulumtime rreth Juhenna Nehviut dhe shkroi që në vitin 642 ku pretendohet që të ketë ndodhur incidenti i djegies së bibliotekës, Juhenna Nehviu nuk ishte i gjallë fare.

Enciklopedia Britannica pohon që Juhenna jetoj në periudhën mes fundit të shek. V dhe fillimit të shek. VI, kurse pushtimi i Egjiptit ndodhi në fillim të shekullit VII. Bazuar në këtë fakt, Prof. Butler thotë me të drejtë që deri atëherë Juhenna kishte vdekur.

Pra, të dhënat historike tregojnë hapët që personi kyç që përmendet në këtë incident të sajuar, kishte vdekur përpara pushtimit të Egjiptit.

Po kështu, Dr. Hassan Ibrahim Hassan me referencën e Prof. Ismailit, në librin e tij “Historia e ‘Amr bin el-‘Asit” shkruan ‘Biblioteka e Aleksandrisë as

nuk ekzistonte në atë kohë, sepse njëres prej dy pjesëve kryesore të saj, ushtarët e Julius Cezarit në vitin 47 p.e.s., i kishin vënë zjarr pa arsye. Jo shumë vonë, edhe pjesa e dytë e saj ishte asgjësuar. Kjo ndodhi me urdhër të peshkopit Theophlius në shekullin IV e.s..

“Historia e djegies së Bibliotekës së Aleksandrisë është krejtësisht e pabazë dhe qesharake”

Profesor Butler shkruan:

Historia e Ebul-Ferxhit është krejtësisht e pabazë dhe qesharake. Nëse do t’u duhej të digjnin librat, ata mund t’i digjnin në një kohë të shkurtër. Nëse do t’i kishin djegur për gjashtë muaj, shumë prej tyre edhe mund të vidheshin. Gjithashtu, arabët nuk shquhen për shkatërrimin e sendeve të ndonjë vendi.

Gibboni shkruan: Mësimet islame e kundërshtojnë një histori të tillë, sepse mësimet e tij janë që muslimanët nuk duhet të djegin librat e hebrenjve e të krishterëve në luftë. Për sa i përket përfitimit nga shkenca, filozofia, poezia dhe mësimet e tjera fetare, Islami ua lejon muslimanëve. Në zonat e pushtuara, muslimanët ndaluan shembjen e kishave dhe dëmtimin e sendeve të tyre, madje ata u jepnin lirinë fetare jo-muslimanëve. Atëherë, a mund të pranojë një që ka logjikë të shëndoshë që Kalifi i muslimanëve të mund të ketë urdhëruar

djegien e bibliotekës së Aleksandrisë?!⁴

Në librin e tij “*Tesdik Berahin-e-Ahmedia*”, Hazret Kalifi i Parë i Mesihut të Premtuar ^{r.a.} i përgjigjet kësaj akuze. Ai thotë:

“[Pretendohet se] me kërkesën e mjekut Philoponus dhe Fazil Exhelit, Komandanti i përgjithshëm musliman, ‘Amri bin el-‘Asi pyeti Hazret Omerin, Emirin e Besimtarëve, Kalifin e Dytë të Islamit, se çfarë të bënte me bibliotekën, dhe që Kalifi iu përgjigj që ajo duhet të digjej menjëherë dhe për këtë arsye, furrat u ngrohën vazhdimisht për gjashtë muaj. Ky pretendim i priftërinjve është si rezultat i inatit dhe që nuk ka asnjë të vërtetë.

Mendoni pak, nëse kjo do të ishte praktikë e Islamit, Kalifi i tij, pra Hazret Omeri ^{r.a.}, më së pari do të digjte librat e shenjtë të hebrenjve dhe të krishterëve, pasi ata ishin popujt e parë të cilëve u drejtohet Islami. Më pas, do të digjnin edhe librat e magistëve, sepse muslimanët patën sundim të plotë mbi ta, por asnjë historian nuk tregon qoftë një ngjarje të vogël që muslimanët t’ua kenë djegur librat. Nëse kjo praktikë do të ishte pjesë e Islamit, Islami patjetër do të kishte ndonjë udhëzim konkret në lidhje me këtë, pasi asgjë nuk e pengonte fenë Islame nga një gjë e tillë.

Së dyti, djegia e librave të shenjtë po të

ishte praktikë e mbretërve muslimanë ose qoftë edhe e popullit musliman, kurrë nuk do të gjendeshin përkthimet në arabisht të librave të filozofisë dhe të mjekësisë greke dhe të shkencave të tjera.

Së treti, [e thotë duke iu drejtuar akuzuesit që pretendonte ta hidhte poshtë librin “*Berahin-e-Ahmedia*”] nëse djegia e librave do të ishte praktikë te muslimanët, autori i “*Tekdhib Berahin-e-Ahmedia*” duhet të sillte qoftë një shembull nga vetë vendi i tij, dhe nuk kishte nevojë të shkonte matanë detit deri në Aleksandri. Pra, muslimanët a kanë djegur libra në Indi?!

Së katërti, muslimanët sunduan në Indi për më shumë se 700 vjet. Dhe hindutë kanë librat e tyre të shenjtë si Bhagavad Gita, Ramajana, Mahabharata dhe libra të tjerë të njohur fetarë si Linga Puran



dhe Markandeja, të cilët ekzistojnë edhe sot e gjithë ditën dhe konsiderohen si shkrimet e shenjta të hinduve. A ka dëgjuar dikush ndonjëherë që ndonjë musliman të ketë djegur ndonjë libër të tyre?! Përkundrazi, muslimanët kanë përkthyer disa prej këtyre librave. Prandaj, është për t'u habitur, pra, se hindutë si mund të supozuan se muslimanët ua kanë djegur librat? Mendoni për këtë me drejtësi.”⁵

Hazret Mevlana Abdul-Kerim^{r.a.} gjithashtu në librin “*Tesdik Berahin-e-Ahmedia*” ka lënë një shënim duke iu përgjigjur pikërisht akuzës në fjalë. Ai thotë:

Ndonëse deri në kohën kur kjo ngjarje nuk ishte hulumtuar në dritën e fakteve, muslimanët akuzoheshin për djegien e bibliotekës së Aleksandrisë, por tani ka shumë pak studiues që edhe të përkrahin drejtësinë dhe të vërtetën, edhe akuzën ndaj muslimanëve. Akuza në fjalë u ngrit për shkak të mërisë dhe disa herë për shkak të padijenisë.

Madje, për herë të parë kjo akuzë u ngrit 580 vjet pas “incidentit”, dhe dy historianë që përmendën këtë ngjarje, nuk kanë dhënë asnjë referencë autentike. Saint Croix që është autor i shumë librave për hulumtimin e Bibliotekës së Aleksandrisë, e hedh poshtë këtë rrëfim.

Është zbuluar që këta libra u dogjën

gjatë luftës së Julius Cezarit. Kështu që, Plutarch shkruan në “*Life of Caesar*” që Julius Cezari dogji anijet e veta nga frika që ato do të binin në duart e armikut, dhe pikërisht ky zjarr duke u përhapur përpiu edhe bibliotekën e famshme dhe madhështore të Aleksandrisë.

Në librin e tij “*Dictionary of Dates Relating to all Ages*” Haydn pasi e citoi këtë rrëfim të rremë, arsyetoi që “kjo histori është shumë e dyshimtë. Muslimanët nuk e pranuan transmetimin, në të cilin raportohet Omeri (r.a.) ka urdhëruar djegien e librave që ishin në kundërshtim me Islamin. Disa ia atribuojnë këtë ngjarje Theophilusit të Aleksandrisë, i cili jetoi rreth vitit 391 të e.s., dhe të tjerë ia atribuojnë kardinalit Jimenez, i cili jetoi rreth shekullit XV e.s..”

Haydn më tej shkruan: “Personaliteti ynë i shquar, Dr. Leitner e ka përmendur këtë rrëfim të gabuar në librin e tij “*Sinnin El-Islam*”, dhe për fat të keq, mjeku i nderuar ka gabuar në kërkimet e tij.”

Në librin e tij të famshëm, John William Draper e ka përmendur këtë incident me transmetuesit e rremë, por më vonë pranon se kjo ngjarje ishte e sajuar. Ai shkruan:

“Në të vërtetë, këta libra u dogjën gjatë një beteje të Jul Cezarit. Tanimë mund të thuhet me bindje të plotë se ky

incident [që e kanë djegur muslimanët bibliotekën] është i pabazë dhe vetëm përrallë. Nëse ka një incident për të cilin ia vlen të qajmë, ai është kur kardinali fanatik Jimenez dogji 80,000 dorëshkrime arabe në fushat e Granadës”.

Kur të krishterët morën kontrollin e Spanjës nga muslimanët, ata dogjën 80,000 libra nga Biblioteka e Granadës. Kjo është diçka për të cilën me të vërtetë duhet të pikëllohesh, në krahasim me akuzën e rreme kundër Islamit.

“Shih “*Conflict Between Religion and Science*””.⁶

Kjo pra ishte historia e djegies së bibliotekës së Aleksandrisë, që ua atribuojnë rrejshëm muslimanëve.

SHËNIME

[1] Shibli Nu'mani, “El-Faruk”, botues: “Darul-isha'at”, Karaçi 1991, fq. 162-165. Dr. 'Ali Muhammed Sal-labi, “Sejjiduna 'Umer bin Khattab shakhsijet aur kar namaj”, përkthimi në urdu, botues: “El-Furkan Trust”, Khangarh, fq. 760-764.

[2] Neudhubil-lah ose me'adhaAllah do të thotë “Kërkojmë mbrojtjen e Allahut nga ky mendim!”

[3] Ibn Maxheh, “Sunen”, kitab: “El-Mukaddime”, bab: “Fadlul-'ulemai vel-hath-thi 'ala talebil-'ilmi”, hadithi nr. 224.

[4] Muhammed Rida, “Siret 'Umer Faruk r.a.”, botues: “Mektebe Islamiye”, Lahore 2010, fq. 294-297.

[5] Hazret Maulana Hakim Nuruddin r.a., “Tasdik Berahin-e-Ahmedijja”, vëllimi I, fq. 203-204.

[6] Hazret Maulana Hakim Nuruddin r.a., “Tasdik Berahin-e-Ahmedijja”, vëllimi I, fq. 203, fusnota.

Biblioteka e Aleksandrisë (godina moderne)



Lajme

nga Gjermania dhe Kosova



Përmbytjet në Gjermani dhe shërbimet e xhematit

Në verën 2021, e konkretisht në mesin e muajit korrik, Europa Perëndimore dhe Qëndrore u përballën me përmbytje të rënda. Në këtë katastrofë natyrore



një shpejtësi shkatërruese, rrënoi çdo gjë që i dilte përpara. Po ashtu fuqia e erozionit shkatërroi rrugët, urët, godinat etj dhe në një kohë shumë të shkurtër solli dëme të mëdha. Ushtria, ekipet e zjarrfikësve, personelet e urgjencës etj. shkuan në zona të përmbytura për të



humbën jetën më shumë se 220 njerëz, nga të cilët së paku 184 viktima ishin në Gjermani. Më 14 korrik, në disa vende të Gjermanisë, kishte rënë më shumë se 150 litra shi për një metër katror dhe si rrjedhojë shtetet federale si Rheinland-Pfalz dhe Nordrhein-Westfalen pësuan dëme të mëdha jete dhe materiale. Forca e ujit bashkë me

evikuar njerëzit nga vendet e rrezikuara. Xhemati Musliman Ahmedia gjithashtu bashkë me organizatën e tij humanitare “Humanity First” dhe organizatën e të rinjve “Khuddamul Ahmadiyya” me qindra vullnetarët u erdhi në ndihmë bashkëqytetarëve në nevojë.

Në fillim sfida më e madhe ka qenë



pastrimi i rrugëve, shtëpive, bodrumeve etj. nga balta e lluca si dhe nxjerrja e sendeve të dëmtuara nga banesat. Për t'i përgjigjur nevojës urgjente, qindra të rinj nga anembanë Gjermanisë morën pjesë në këto aksione që vijuan pandërprerë për disa javë. Disa i quajtën “engjëjt” që punuan me vetëmohim e përkushtim, pa asnjë shpërblim.

Me fanellat e bardha që mbanin sloganin “Wir sind alle Deutschland” (ne jemi Gjermani), këto aksione ndihmuan gjithashtu për të thyer stereotipin dhe pargjykimin që lidhen në përgjithësi ndaj të huajve.

Për shkak të shkatërrimit të infrastrukturës dhe mungesës së energjisë elektrike, banorët e luginës Ahrstal, në shtetin Rheinland-Pfalz, nuk kishin mundësinë tjetër, përveç ushqimeve të konservuara. Për t'u ardhur në ndihmë banorëve, Xhemati ngriti menjëherë një mensë popullore në bashkësinë Mayschoß dhe nisi gatimin dhe shpërndarjen e vakteve të nxehta.

Jo vetëm banorët, madje edhe ushtarët, ekipet e urgjencës dhe vullnetarët e tjerë përfituan nga kjo mensë. Çdo ditë afërsisht 200 vullnetarë udhëtonin drejt



bashkësisë Mayschoß dhe pastaj në grupe të vogla shpërndanin pako vaktesh derë më derë. Kjo mensë popullore shërbeu për tre muaj, derisa furnizimi elektrik u kthye në vend, dhe sipas një përlllogaritje, xhemati shpërndau rreth 170,000 vakte të nxehta për banorët në më shumë se 100 lokalitete të ndryshme. Përveç kësaj, shoqata bamirëse e xhematit “An-Nusrat e.V.” grumbulloi ndihmat për të prekurit nga përmbytja, duke organizuar aksionet në qytete të ndryshme. Me këtë aksion, ata arritën të transportonin 20 kamiona me ndihmë drejt vendeve të prekura.

Xhelsa Salana e 45-të e Gjermanisë

Më 8 e 9 tetor 2021, u zhvillua Xhelsa Salana e 45-të e Gjermanisë, në Mai Markt, Mannheim. Për shkak të masave të rrepta kundër Covid-19, administrata shtetërore kishte lejuar një numër të vogël pjesëmarrësish, të cilët duhet të ishin të vaksinuar. Pjesëmarrësit ishin zgjedhur nga kompjuteri, të cilëve u ishin dërguar ftesa personale. Gjatë dy ditëve, gjithsej 9369 mysafirë morën pjesë në xhelsa. Ndërsa anembanë Gjermanisë, anëtarët ndoqën programin e Xhelsës nëpër Xhamitë apo shtëpitë e tyre.

Në këtë xhelse, u mbajtën 8 fjalime në gjuhën urdu dhe gjermane. Në seancën mbyllëse Hazret Kalifatul Masih i Pestë (Allahu e ndihmoftë fuqimisht) iu drejtua pjesëmarrësve të Xhelsës përmes lidhjes satelitore.



Këndi i lodrave në Podujevë

Investimi në edukimin fizik dhe shëndetësor të fëmijëve është investim i sigurt në ardhmërinë e ndritur të tyre. Organizata humanitare “Humanity First” realizoi një projekt të tillë, dhe financoi ndërtimin e këndit të lojërave në Institucionin Parashkollor “Armela” në Podujevë.



Më 14 tetor 2021, u zhvillua ceremonia e përmirimit të këtij këndi lojrash, në të cilën morën pjesë: kryetari i Podujevës Z. Shpejtim Bulliqi, drejtori i Drejtorisë së Arsimit të Podujevës Z. Avni Fetahu dhe drejtoresha e Institucionit Znj. Taibe Nishefci, përfaqësuesi i “Humanity First” dhe disa vullnetarë të kësaj organizate.



Shpërndarja e dhuratave për fëmijët në Prishtinë

Më 22 dhjetor 2021, organizata “Humanity First” shpërndau rreth njëqind dhurata për fëmijët që gjenden në situatë rruge dhe frekuentojnë “Qendrën e Qëndrimit Ditor” në Prishtinë.

Më shumë se dhurata vlen solidariteti, barazia dhe përkujdesja që kjo qendër ka për këta fëmijë.



Takime kushtuar jetës së Profetit Muhammed ^{s.a.v.s.}

Në dhjetor 2021, Xhemati Musliman Ahmedia i Kosovës organizoi takime të veçanta kushtuar jetës së Profetit Muhammed ^{s.a.v.s.}. Në këto takime që u zhvilluan më 19, 25 e 26 dhjetor 2021 përkatësisht në qytetet Mitrovicë, Pejë e Prishtinë u diskutuan virtytet, mësimet dhe shembujt nga jeta e të Dërguarit të Allahut ^{s.a.v.s.}.



“Dita e Flamurit” në Kosovë

Data 28 nëntor kremtohet si “Dita e Flamurit” në Shqipëri e Kosovë. Si çdo herë, edhe këtë vit Xhemati i Kosovës

organizoi një takim të veçantë, ku morën pjesë 45 mysafirë nga 8 qytete të Kosovës. Presidenti i Xhematit, Z. Xhinahudin Sejfi mbajti një ligjëratë mbi temën “*Rendi i ri botëror i Islamit*”, e cila u ndoq nga një seancë pyetje-përgjigjesh.



Viti i ri fillon me namazin e tehexhudit

Falja e namazit të tehexhudit është një prej porosive të Allahut, të cilën e ka praktikuar i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} gjatë gjithë jetës. Fillimi i vitit me namazin e tehexhudit është kthyer në një traditë të bukur në xhemat tashmë prej shumë vitesh. Edhe kësaj here anëtarët e xhematit në Prishtinë, Pejë dhe Mitrovicë filluan vitin e ri me adhurimin e Allahut dhe bënë lutje për paqe, dashuri dhe shëndet për mbarë njerëzimin. Pas namazit të sabahut, anëtarët hëngrën mëngjesin dhe diskutuan rëndësinë e namazit në përgjithësi dhe të tehexhudit në veçanti.

INDEX IN ENGLISH

10 Four Spiritual and Secular Ranks

Scaling the heights in this world and the next

HAZRAT MIRZA GHULAM AHMAD ^{A.S.}
PROMISED MESSIAH & IMAM MAHDI

18 God created Man to have Mercy on him

HAZRAT MIRZA GHULAM AHMAD ^{A.S.}
PROMISED MESSIAH & IMAM MAHDI

20 Which are the Means to attain Knowledge & Understanding of God?

HAZRAT MIRZA GHULAM AHMAD ^{A.S.}
PROMISED MESSIAH & IMAM MAHDI

26 What is Success for our land?

What we identify as success and those what we call our goals in life, in reality are the obstacles in our path towards success.

HAZRAT MIRZA BASHIRUDDIN MAHMOOD AHMAD ^{R.A.}
SECOND SUCCESSOR TO PROMISED MESSIAH

30 The most Comprehensive Study on Alcohol Consumption

TAHIR NASER

34 The Identity and Image of a Muslim

AHMAD KAMAL

46 The Qur'an and Extraterrestrial Life

Quran revealed the existence of Aliens at a time when cosmology as a science had not yet been born.

HAZRAT MIRZA TAHIR AHMAD ^{R.A.}
THE FOURTH SUCCESSOR OF THE PROMISED MESSIAH

52 Why do Muslim women wear the headscarf?

According to Islam, a pious woman should appear in public with high moral values ..

HADAYATULLAH HÜBSCH

60 The Role of Khilafat in establishing World Peace

Speech delivered at the 5th Jalsa Salana of the Ahmadiyya Muslim Jamaat. Kosovo

ABDULLAH UWE WAGISHAUSER

70 Method of Reading and Studying the Holy Qur'an

HAZRAT HAKIM MAULVI NOORUDDIN ^{R.A.}
FIRST SUCCESSOR TO PROMISED MESSIAH

76 Attributes of Allah

This series delves deeper into each of God's Attributes to gain a better understanding of His Being.

86 Liberation of Alexandria and Destruction of the Library

An excerpt from the History of Islam

HAZRAT MIRZA MASROOR AHMAD ^{A.B.A.}
THE FIFTH SUCCESSOR OF THE PROMISED MESSIAH

94 News from Kosovo and Germany

A summary of activities carried out by Ahmadiyya Muslim Jamaat and its humanitarian organization “Humanity First”